



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 4 MARS 2010

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
4 MARTA 2010. GODINE

MARS – MART
2010

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Konstatoj në sallë janë të pranishëm 87 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit i ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotshme plenare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

- **Debat sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë për zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe për praninë e strukturave të pushtetit të Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës**

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës së Kuvendit ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që në seancë plenare të debatohet lidhur me zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe praninë e strukturave të pushtetit të Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës.

Kërkesa e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, së bashku me mocionin përmbajtjesor, si dhe Informata me shkrim e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me Strategjinë për veriun e Kosovës, u janë shpërndarë deputetëve.

Të nderuar deputetë,

Ju e dini që ky debat ka një rëndësi të madhe, që Kuvendi i Kosovës, institucionet e Kosovës, partitë politike në Kosovë dhe qytetarët e Kosovës ta ndërtojnë një qëndrim unik dhe të përbashkët për të ofruar një zgjidhje të pranueshme që është në interes të të gjithë qytetarëve të Kosovës, të çdo pjese të saj dhe qëllimi i Kuvendit, qëllimi i institucioneve të Kosovës është për t'i trajtuar të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, qytetarët tanë që kanë nevojë për një jetë më të mirë, kanë nevojë për kushte jete dhe pune më të mirë dhe ne, si Kuvend dhe si institucione, u kemi ofruar dhe do t'u ofrojmë ofertën tonë për t'i tejkaluar problemet që i ka krijuar e kaluara dhe jo koha jonë dhe se ne këto problemi që na vinë nga e kaluara do t'i zgjedhim me rrugë demokratike, duke pasur mbështetjen edhe të vendeve të Bashkimit Evropian dhe të Botës Euroatlantike, në përgjithësi, dhe jemi të bindur se vetëm duke krijuar hapësirë të përbashkët për të gjithë qytetarët e Kosovës, jo vetëm qytetarët e Kosovës, por edhe qytetarët e rajonit tonë do të kenë lehtësi për t'u integruar në shoqërinë euroatlantike.

Prandaj, unë si kryetar i Kuvendit ftoj që debati të jetë në këtë frymë, në frymën e zgjidhjes së problemeve, të cilat nuk janë tonat, por të cilat duhet t'i zgjidhim ne.

Tani ftoj propozuesin e mocionit, deputetin e Lidhjes Demokratike të Dardanisë dhe kryetarin e kësaj partie, Nexhat Dacin, ta marrë fjalën.

NEXHAT DACI: Zoti kryetar i Parlamentit,

Deputetë të respektuar,

Zoti kryeministër dhe ministra,

Unë besoj që është bindje e thellë e përfaqësuesve të popullit të Kosovës në Parlament, që Kosova është në momentet të atilla të zhvillimit të saj që kërkohet një debat parlamentar, një qasje serioze politike, e përgjegjshme për momentin historik. Do të thosha, t'i përkujtoj deputetët e rinj, Parlamenti i Kosovës në 10 vitet të punës së tij vetëm 2 herë ka debatuar në çështjet kritike për pozitën e Kosovës. Ishte fillimi i qeverisjes në Kosovë, si protektorat, me një mundim të madh dhe të gjatë, në një parlament prej 17 – 18 partish politike, arriti unitet të plotë veprues dhe nxori Rezolutën për mbrojtjen e kufijve të Kosovës. Hera e dytë që u parashtrua një nevojë, ishte në vitin 2005, Parlamenti prapë gjeti forcë në një rrugë të gjatë të punës pozitive – opozitë që të krijojë përsëri unitet absolut në nxjerrjen e një rezolute për hartën e rrugës për pavarësimin e Kosovës në Vjenë. Dhe, tani LDD vlerëson se është pikërisht një moment i tillë, kur duhet të gjendet forcë politike që përfaqësuesit e popullit ta thonë fjalën e vetë, të bindur se e kanë obligim.

Dhe, më lejoni t'ju them që në të dyja rastet e përmendura, bashkësia ndërkombëtare ishte e brengosur për seriozitetin e parlamentarëve për nivelin e debatit. Koha e vërtetoi që deputetët dhe Parlamenti kishin të drejtë në të dy rastet.

Viti 2010, me kërkesën e LDD-së për debat mbi kushtetutshmërinë dhe strukturat paralele në Kosovë, është moment i kohës kritike për Republikën e Kosovës dhe kërkon qasje politikisht serioze, vizionare dhe të përgjegjshme ndaj shtetasve të Kosovës dhe miqve ndërkombëtarë. Pra, kërkohet unitet veprues në rolin kushtetues të Parlamentit të Kosovës.

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Përse të bëhet kjo sot? Janë dy arsye madhore. E para, Kosova po zvogëlohet nga aspekti territorial. Në një pjesë të madhe të territorit të Kosovës shteti im fqinj ushtron të vetmin rol të pushtetit në Kosovë, në praninë e të gjitha dikastereve të Qeverisë së Serbisë.

Dhe, e dyta, Kosova po zvogëlohet nga brenda që është edhe më e dhembshme. Përsëri ka filluar migrimi i rinisë së Kosovës. Rinia, e cila nuk po gjen hapësirë të krijojë shpresë se një ditë mund të punësohet dhe të krijojë familje. Bile, bile, ikja edhe e familjeve të tëra dhe e katastrofave në atë ikje, ishte katastrofa në Lumin Tisa dhe, tani kjo e dyta, në Vjenë. Dhe, krejt këto janë të përcjella me arsyen e dytë - varfërimi, papunësia, krimi ekonomik, si pasojë e mos respektimit të Kushtetutës për sovranitet dhe integritet territorial, me dogana të hapura në veri.

Deputetë dhe qytetarë të Republikës së Kosovës,

Parlamenti ynë në dy vitet e pavarësisë nuk ka debatuar asnjëherë, përse rritet papunësia? Pse ka rritje të varfërisë dhe të varfërisë së skajshme? Përse mbyllen në vitin 2009 afro 1000 ndërmarrje të vogla apo të mesme? Përse humben qindra miliona euro në vit nga ekonomia kriminale e kufirit të hapur dhe ajo informale? Parlamenti ynë, në dy vite pavarësie nuk ka debatuar rolin e vetë kushtetues në mbikëqyrje të qeverisjes në vend. A po e ushtron përgjegjësinë e vet qeverisja në vend duke ju përmbajtur betimit të vet të dhënë në këtë Parlament. Parlamenti ynë nuk debaton çështjet më vitale të zhvillimit të shtetit të Kosovës, si shtet demokratik, çështjet e ekzistencës së qytetarëve dhe të zhvillimit, si autostrada, privatizimi i pasurive kryesore të vendit: energjetika, post-telekomi, aeroporti, apo ndoshta një ditë, deputetë të nderuar, kur të jetë qiraxhinj në

shtëpinë e vetë, qeverisja do të lypë debat, por atëherë duke e fajësuar Parlamentin që nuk e ka ushtruar detyrën e vet parësore, kërkesën për llogaridhënie në Parlament të qeverisjes së Republikës së Kosovës.

Zonja dhe zotëri deputetë dhe qytetarë të nderuar,

Po bashkësia civile ndërkombëtare në Kosovë, a është këtu për të qeverisur vendin, apo e ka rolin e mbikëqyrjes së pavarësisë dhe të ndihmës institucioneve të Kosovës pas futjes në veprim të Kushtetutës së Republikës së Kosovës?

Deputetë të nderuar,

Perceptimi politik i qytetarëve është se nuk ka dallim të hetueshëm në këtë. Kjo ka prodhuar sterilitet idesh, koncepti, vizioni dhe strategjie për respektimin e obligimeve kushtetuese të qeverisjes në Kosovë.

Dhe, krejt në fund, për të mos e zgjatur shumë, LDD mendon që debati i sotëm ka për qëllim që të japë përgjigje të qartë në pyetjet dhe dilemat e parashtruara në fjalën hyrëse, duke nxjerrë një dokument serioz. Ne mendojmë se duhet të jetë rezolutë, me të cilën e obligon qeverisjen e vendit t'i ushtrojë obligimet e veta kushtetuese në shtetin e Kosovës, me integritet dhe sovranitet të pranuar sot nga 65 shtete të globit tokësor dhe duke e konsultuar ekspertizën e bollshme ndërkombëtare në Kosovë për të përpiluar për këtë qëllim plan cilësor të veprimit në etapa dhe kohë të caktuar.

Dhe, për përfundim, LDD nuk ka bërë presion në asnjë deputetë, në asnjë grup parlamentar dhe nuk mendon që dokumentet serioze mund të ndërtohen dhe të nxirren pa debat të qartë, pa konsultim të ekspertizës në grupet tjera parlamentare. Pra, kërkon një qasje serioze të këtij Parlamenti dhe, më në fund, të shoh populli i Kosovës që nuk jemi deputetë vetëm që flemë, por kemi edhe obligime. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Radha është e përfaqësuesve të Qeverisë, nëse e donë fjalën. Fjalën e ka kryeministri, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar kryetar i Parlamentit, zoti Jakup Krasniqi, Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra, zëvendësministra, Të nderuar deputetë,

Unë falënderoj Grupin Parlamentar të LDD-së, të mbështetur edhe prej tjerëve për këtë mundësi që të zhvillohet një debat për këto zhvillime. Prandaj, dua të potencoj që në fillim se kam kënaqësinë që para jush dhe para të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës ta bëjë edhe paraqitjen e Strategjisë për integrimin e veriut të Kosovës.

Të gjithë ne kemi kërkuar prej kohësh zgjidhje për këtë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës dhe shpresoj që me diskutimin tonë sot dhe me angazhimin e të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës, të autoriteteve qendrore dhe lokale dhe të atyre ndërkombëtare, mbështetëse, përfundimisht do të vazhdojmë të lëvizim drejt kësaj zgjidhjeje.

Të nderuar deputetë,

Veç sa po shënuam dy vjet të shtetësisë sonë, shënuam përparim në shumë fusha, por dua të them shumë hapur dhe në mënyrë të sqartë dhe të përgjegjshme se kemi edhe shumë për të bërë. Përveç sfidave që i kemi për integritet evropian dhe euroatlantik, zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e gjendjes sociale të qytetarëve tanë, ne duhet të

arrijmë funksionimin e shtetit tonë unik, si një shtet i integruar, si një shtet që i del zot vetvetes dhe qytetarëve në gjithë territorin e vet.

Realisht, është e vërtetë se nuk është debatuar shumë për veriun e Mitrovicës, po është hera e parë që është vepruar shumë për integritet, edhe territoriale, edhe qytetare.

Strategjia për integrimin e veriut është baza për përpjekje tona të përbashkëta për Kosovën unike. Sot e kemi kohën më të përshtatshme dhe më të duhur për të filluar me zbatimin e kësaj strategjie. Qeveria është gati. Ne përfitojmë nga dinamika shumë e favorshme, që u krijua gjatë vitit që shkoi, me mbajtjen e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike dhe me fillimin e mbarë të procesit të reformimit të pushtetit lokal apo të decentralizimit.

Vitin e kaluar qytetarët e Kosovës votuan dhe zgjodhën përfaqësuesit e tyre legjitim dhe si rezultat i kësaj u krijuan edhe komunat e reja me shumicë të komunitetit serb, si komuna e Graçanicës, Klllokotit, Ranillugut dhe komuna e zgjeruar e Artanës, por gjithmonë duke pasur parasysh edhe suksesin e madh për komunën e Shtërpçës. Këto komuna, së bashku me komunën e Shtërpçës tani po e fillojnë funksionimin e tyre dhe kanë mbështetjen e plotë të Qeverisë së Kosovës dhe bashkëpunimi është shumë i ngushtë, i kam vizituar dhe kam biseduar me liderët e rinj legjitim, të zgjedhur në mënyrë demokratike, janë të gatshëm t'i marrin përgjegjësitë e tyre për implementimin e të gjitha prioritetëve dhe realizimin e kërkesave të qytetarëve të komunave të tyre përkatëse. Qeveria e Kosovës do të jetë në mbështetje të plotë me gjithë mekanizmat ndërkombëtarë në këtë drejtim.

Ju të gjithë e dini se nuk ka qenë e lehtë të krijohet ajo rrethanë favorizuese, ajo rrethanë e përshtatshme për pjesëmarrjen në zgjedhje dhe, para së gjithash, suksesin në këto zgjedhje edhe në këto komuna të reja të Republikës së Kosovës, që tanimë janë edhe multietnike. Pra, procesi i integrimit të komunitetit serb në jetën politike dhe institucionale e qytetare ka shënuar një progres të jashtëzakonshëm në pjesën jugore të Kosovës. Tashmë ne të gjithë në mënyrë të koordinuar dhe të vendosur duhet të bëjmë hapat e sigurt dhe vendosjen e rendit dhe të ligjit edhe në veri të Kosovës.

Përkushtimi ynë, si Qeveri e Republikës së Kosovës, është për zbatimin e plotë dhe rigoroz, të vendosur e të shpejtë të Strategjisë për integrimin e veriut dhe për zhvillimin socio – ekonomik edhe në këtë pjesë të Republikës së Kosovës.

Si kryeministër i Kosovës dua të theksoj se Qeveria është përfundimisht e vendosur për shtrirje institucionale dhe kujdes institucional në veri, duke respektuar gjithmonë Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjet e Kosovës, si dhe planin e presidentit Ahtisaari, në tërësi.

Të nderuar deputetë,

Strategjia për veriun është e bazuar në katër fusha kryesore: fuqizimi i sundimit të ligjit, decentralizimi apo reformimi i pushtetit lokal, edhe themelimi i komunës së Mitrovicës së veriut, adresimi i qeverisjes në tri komuna të veriut, Zubin Potok, Leposaviq edhe Zveçan dhe përmirësimi i situatës socio – ekonomike në këtë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës.

Fuqizimi i sundimit të ligjit është synim parësor i Qeverisë së Kosovës dhe i institucioneve ndërkombëtare për gjithë territorin e vendit tonë. Ky synim, si pjesë

kryesore e strategjisë për veriun, nënkupton rritjen e pranisë së Bashkimit Evropian, EULEX-it në veri, krahas fuqizimit të Policisë së Kosovës në atë pjesë.

Më lejoni të ndalem dhe të siguroj qytetarët e Kosovës në veri dhe të atyre ku do në Kosovë se fuqizimi dhe shtrirja e institucioneve të sigurisë nuk nënkupton në asnjë rrethanë përdorimin e dhunës. Natyrisht, gjithë ata që nuk e respektojnë ligjin, do të kenë ballafaqim me ligjin.

Ky proces, pra, Strategjia për veriun është një strategji e shpresës, e besimit, të mirëkuptimit, multietnicitetit dhe e angazhimeve të gjithanshme vendore dhe ndërkombëtare.

Mospërdorimi i dhunës nuk do të thotë se strukturat kriminale që veprojnë atje dhe grupet e ndryshme të kontrabanduesve nuk do të ballafaqohen seriozisht me forcën demokratike të ligjit.

Kaosi 10-vjeçar duhet të marrë fund, sepse nuk guxojmë të lejojmë që kjo situatë e nder në veri të vendit të mbajë peng të ardhmen tonë evropiane, pra të ardhmen e shtetit tonë.

Sundimi i ligjit në veri dhe funksionimi i sistemimit të drejtësisë ofron siguri dhe jo kërcënim për qytetarët tanë. Gjithashtu, vënia në funksion efektiv të doganave në veri, pra, të kontrollit të plotë doganor nënkupton mbledhje të të hyrave në mënyrë legjitime dhe derdhja e këtyre mjeteve në institucione legjitime dhe jo në adresë të qarqeve të korruptuara apo të interesave të ngushta.

Të nderuar dhe të respektuar deputetë,

Reformimi i pushtetit lokal apo decentralizimi do të vazhdojë në veri, qytetarët e Kosovës atje dhe posaçërisht qytetarët serbë, do të votojnë për udhëheqësit e tyre legjitimë për të qeverisur vetveten. Do të krijohet komuna veriore, e cila do të jetë në shërbim të gjithë qytetarëve që jetojnë atje. Si Qeveria e Kosovës, ne do të angazhohemi për themelimin e një zyre lokale për komunitete në Mitrovicë Veriore dhe kjo zyrë do të jetë një urë komunikimi për një kanal legjitim për investime nga qeveria qendrore në këtë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës. Të rikujtoj që për kundër mungesës së shtrirjes së mirëfilltë të institucioneve tona në veri, Qeveria ka bërë investime për më shumë se 8 milionë euro në periudhën 2008 – 2009.

Kjo ka përfshirë kryesisht investime në infrastrukturën publike, në ndërtimin e rrugëve të reja, në ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit, ndërtimin e shtëpive dhe të shkollave e të ambulancave. Dua t'i siguroj të gjithë qytetarët në këtë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës, se Qeveria e Kosovës do të jetë në mbështetje të tyre të gjithanshme për të siguruar kushte e siguri që çdo qytetarë të kthehet në pronën e vet, në shtëpinë e vet, në banesën e vet. Aty ku nuk ka shtëpi, do të investojmë drejtpërdrejtë edhe financiarisht, siç kemi investuar në dy vitet e kaluara. Pra, asnjë qytetarë i Mitrovicës së veriut që dëshiron të kthehet në pronën e vet, në shtëpinë e vet, nuk do t'i mungojë mbështetja shtetërore.

Të nderuar deputetë, edhe Leposaviqi, Zubin Potoku dhe Zveçani do të përfitojnë një qasje edhe më të afërt, më të drejtpërdrejtë të institucioneve të Kosovës.

Themelimi i suksesshëm i komunës së Mitrovicës së veriut do ta përmirësojë klimën e bashkëpunimit në mes të Qeverisë sonë dhe banorëve të atjeshëm, duke ruajtur gjithmonë pronësinë dhe kontrollin lokal të atyre qytetarëve. Kjo do të thotë se serbët, qytetarët e

Kosovës në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës do të kenë mbështetje për planin e infrastrukturën publike, në mirëqenien sociale dhe në sundim të ligjit.

Unë sot zotohem për qytetarët e Kosovës në veri që kjo strategji, pra synimi ynë është për pikërisht për përmirësimin e jetës së përditshme sociale dhe ekonomike.

Strategjia e përbashkët e Qeverisë së Kosovës dhe e Bashkësisë ndërkombëtare ka për qëllim shtrirjen e rendit dhe të ligjit, pajtimin ndëretnik, përmirësimin e Qeverisë dhe forcimin e autoritetit të qytetarëve atje së bashku me forcimin e perspektivës së përgjithshme evropiane dhe euroatlantike.

Të nderuar deputetë,

Ne tashmë kemi edhe udhërrëfyesin, më në fund, shtetëror për veri dhe me të do të kërkojmë edhe mbështetjen e qytetarëve në veri për një jetë apo punë të përbashkët për një jetë më të mirë, për rend dhe ligj, për siguri dhe perspektivë për një jetë të re në Kosovë dhe perspektivë evropiane. Qeveria e Kosovës tashmë ka filluar zbatimin e kësaj strategjie duke emëruar edhe këshilltarin për koordinimin për çështjen e veriut, i cili do të koordinojë angazhimin në kuadër të Qeverisë së Kosovës dhe do të bashkëpunojë ngushtë me mekanizmat ndërkombëtarë të involvuar në këtë proces.

Shumë shpejt do të krijojmë grupe të caktuara të përbashkëta, të cilat presin të luajnë një rolë aktiv të përfaqësuesve, do të thotë, të shtetit të Kosovës, ne u kemi bërë edhe ftesë të gjitha partive opozitare, të gjithë njerëzve që me të vërtetë mund të japin kontributin e tyre në mënyrë që strategjia të jetë çështje nacionale, jo e një partie apo partive të caktuara, jo e ndarjeve pozitive – opozitive, por strategjia të jetë gjithëpërfshirëse, integruese, bashkëpërgjegjëse dhe bashkërisht ta implementojmë. Në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës do të jetë shumë e interesuar dhe do të fokusohet për një bashkëpunim jashtë partiak në kuptimin e qasjes së përbashkët gjithë kosovare, gjithë politike dhe gjithë etnike.

Pra, përveç kësaj, do të krijojmë edhe fond të veçantë për investime në pjesën veriore të vendit, nga i cili do të përfitojnë të gjitha komunitetet që jetojnë atje.

Të nderuar deputetë,

Natyrisht, janë duke ndodhur zhvillime dramatike që ofrojnë vendet e rajonit tonë për integrim në struktura veri-atlantike, edhe Kosova do të jetë pjesë edhe e NATO-s, edhe e Bashkimit Evropian dhe ne duhet të përfitojmë nga ky moment për të ecur përpara të bashkuar, duke implementuar reformat demokratike edhe në Republikën e Kosovës.

Prandaj, të nderuar deputetë, e kërkoj mbështetjen tuaj për këtë strategji të përbashkët të Qeverisë së Kosovës dhe të bashkësisë ndërkombëtare. Para së gjithash është në interesin e shtetit të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës, është dokumenti i parë i përbashkët kosovar dhe ndërkombëtar që mund të vazhdohet për t'u implementuar. Prandaj, edhe duhet të jetë një dokument i cili na afron, i cili na bashkon, i cili shikohet dhe punohet për interes nacional, para së gjithash, për të ndërtuar vendin tonë të bashkuar, për të ndërtuar vendin tonë si atdhe të të gjithë qytetarëve të saj.

Ndërsa, sa u përket, të nderuar deputetë, çështjeve që u ngritën fillimisht këtu, që u ndërlidhën do të thotë, se tema e debatit, aq sa jam unë i informuar dhe Qeveria aq sa është e informuar, është për veriun e Mitrovicës, ndërsa hapen edhe çështje të tjera, qoftë të autostradës, qoftë të privatizimeve të aeroportit dhe koncesionimit të aeroportit dhe të

privatizimit të PTK-së, fillimit të zhvillimit të projektit “Kosova e re”, distribuimit të KEK-ut, zhvillimit ekonomik. Ju e dini, ne kemi paraqitur kërkesën për debat sa i përket punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2009 në Parlamentin e Kosovës dhe kjo do të vihet në rend nga Kryesia e Parlamentit në njërën nga seancat e ardhshme dhe do të jemi këtu në mesin tuaj për të prezantuar punën e Qeverisë dhe për të zhvilluar debat. Unë besoj që në këtë drejtim do të kontribuoni, ndërsa për të gjitha çështjet u ngritën këtu, edhe për autostradë, e cila është në procesin final të arritjes së marrëveshjes për fillimin e punimeve, edhe sa i përket koncesionimit të aeroportit, edhe PTK-së, edhe “Kosovës së re”, edhe distribuimit të KEK-ut, në çdo moment jemi të gatshëm për të zhvilluar debat dhe llogaridhënie para Kuvendit dhe qytetarëve të Kosovës.

Dhe, në fund krejt, në emër të Qeverisë, të nderuar deputetë, Kabinet qeveritar, ju ftoj që pas një debati korrekt, konstruktiv, të mos zhvillohet një debat i ballafaqimeve qeveri – opozitë, se veriu duhet të na bashkojë të gjithëve në përpjekje tona, se nuk është problem njëvjeçar, por është problem dhjetëvjeçar, që secili nga ne kemi kontribuar gjithashtu që të ndodhin përmirësimet e mjaftueshme, mund të ndodhin përmirësime edhe më të mëdha dhe do të ndodhin, ju siguroj. Prandaj, mendoj se edhe konkluzioni i këtij debati duhet të jetë një deklaratë mbështetëse për strategjinë për integrimin e veriut nga Kuvendi i Kosovës, pra strategjisë së Qeverisë së Kosovës, të shtetit të Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare. Është si strategji e unifikimit tonë. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!

Tani është radha e shefave ose e kryetarëve të grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputeti Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

Zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, Kabinet qeveritar,

Të respektuar deputetë,

Unë do ta reduktoj fjalën time për arsye që nuk dua të përsëris zotin kryeministër. Dua të them vetëm qëndrimin e Grupit Parlamentar për debatin. Dhe, fillimisht, gjithsesi duhet bartur ato përshëndetje të Grupit Parlamentar për inicuesin e debatit dhe t’ju them se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është i gatshëm të debatojë me shumë disponim për gjërat e shtruar në mocionin nga LDD-ja dhe, natyrisht, konsiderojmë si grup se vërtet është i dobishëm një debat i tillë. Kemi pasur dilema a është bash koha tash, kur fillon zbatimi dhe implementimi i Strategjisë për veriun, por megjithatë unë besoj që një debat i kulturuar, konstruktiv, përmbajtjesor dhe integruar nuk dëmton gjë këtë çështje.

Dhe, unë jam shumë i bindur që qëllimi edhe i nismës, edhe i vazhdimësisë i të gjithë grupeve parlamentare pozitive – opozitive është i mirë, pa asnjë dyshim.

Çështja e zbatimit të kushtetutshmërisë në vendin tonë, unë besoj të gjithë pajtohemi, po kështu, që lë për të dëshiruar. Dhe, kur themi kështu, nuk themi asgjë të re. Unë do të kisha qenë shumë mirënjohës, falënderues edhe si deputet i Parlamentit të Kosovës, edhe si studiues i lëmisë së politologjisë, që të thotë dikush se ku në botë kushtetutshmëria gjen zbatueshmëri qind për qind. Unë s’e kam gjetur. Do të ishte tepër pretenduese të themi se Kushtetuta do të zbatohet ose është zbatuar qind për qind në Republikën e Kosovës që ka jo më pak ose jo më shumë se 2 vjet jetë. Por, po kështu, besoj, pajtohemi që kjo gjë duhet avancuar me insistim, këmbëngulje dhe pa lënë shtigje, shtigje që i mbush dikush tjetër. Dhe, e dimë që shkathtësia për t’i mbushur shtigjet që i lëmë hapur,

e atyre që na sfidojnë, është shumë e madhe, kemi përvojën me ta dhe është shumë e kuptueshme.

Çështja e veriut apo çështja edhe e brendësisë së Kosovës, është një çështje edhe e strukturave paralele e tjera, e tjera. Janë gjëra që na shqetësojnë të gjithëve bashkë dhe, natyrisht, përgjegjësia më e madhe u bie atyre që janë –ekzekutivi, por gjithsesi mbështetja është e jona dhe duhet të jetë e vazhdueshme. Dhe unë i besoj këtij debati, kulturës debutuese të këtij Kuvendi, që do të jetë aq përmbajtjesor, sa në fund të dalim duke përmbyllur me shumë logjikë dhe me shumë sukses këtë debat për të kontribuar në integrim dhe në qetësim të situatës.

Ne e dimë bashkë si janë punët dhe si mund të kontribuojë ky debat, mund t'i ndihmojmë dhe mund ta bëjmë të kundërtën, që nuk dua ta them.

Jemi shumë të qartë dhe e kuptojmë mirë që kohën e fundit ka nisur shumë çka për marrë, e veçanërisht dy vitet e fundit po se po, por veçanërisht pas zgjedhjeve të fundit lokale, kështu që t'i kontribuojmë kësaj gjëje.

Propozuesi i mocionit propozon një gjë plus, që ju e keni pasur në dorë një rezolutë që duhet ta përmbyll debatin. Ne si Grup Parlamentar e kemi analizuar këtë përmbajtje të kësaj rezolute, përmbajtjen dhe kuptimin e rezolutës dhe të esencës së saj dhe e dimë çka nënkupton rezoluta. Ajo di të jetë edhe obligative dhe joobligative. Ne po kështu e dimë të gjithë bashkë se Qeverinë e Republikës së Kosovës e të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës i obligon në radhë të parë Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Nëse ne do të nxjerrim një rezolutë që do të riobligonte, e kemi analizuar që nuk është mjaftë e nevojshme. Një rezolutë e tillë, ku do të rikujtonte dhe riobligonte Qeverinë, nxirret në rrethana të jashtëzakonshme. Unë, besoj, jemi të gjithë të bindur që rrethanat nuk janë më të mira të mundshme, por megjithatë nuk janë të jashtëzakonshme. Dhe, ne si Grup Parlamentar, kemi menduar që në fund të debatit, kryetari i Kuvendit të propozojë një grup që do ta bëjë një deklaratë përmbledhëse, përmbyllëse dhe përmbajtjesore për ta përmbyllur logjikshëm dhe suksesshëm debatin e këtij Kuvendi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Zoti kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra të Kabinetit qeveritar, Deputetë të nderuar,

Sot, sipas rendit të punës, deputetët janë ftuar në një seancë plenare me kërkesën apo mocionin e Grupit Parlamentar të kolegëve tonë nga LDD-ja për të diskutuar zbatimin e Kushtetutës dhe rolin e institucioneve apo të strukturave paralele të Republikës së Serbisë në Kosovës. Dhe ne, si Grup Parlamentar, e mirëkuptojmë qasjen e Qeverisë që në kuadër të këtij debati të paraqet angazhimet konkrete që kanë të bëjë edhe me strategjinë, si dokument, tash së fundit i paraqitur edhe në publik, por për ne nuk është pjesë e debatit, nuk është pjesë e debatit të sotshëm, qasja jonë në dokumentin final, por qasja jonë është në zbatimin e Kushtetutës dhe rolin e institucioneve paralele.

Për Grupin Parlamentar të LDK-së qëndrimet tona, angazhimet tona konkrete kanë të bëjnë me shtyllat kur strukturat paralele prekin, cenojnë dhe lëndojnë funksionimin e

kushtetutës dhe e lëndojnë funksionimin e jetës në Kosovë. Ditët e fundit kanë dalë në sipërfaqe ide për bisedime shtesë me Serbinë rreth statusit, mënyrës së përfaqësimit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, strategjinë për verium, çështje të tjera lidhur me policinë, gjyqësinë dhe doganat. Edhe pse Kosova nuk është kundër dialogut me gjithë shtetet fqinje, përkundrazi, ajo afirmon angazhimet konkrete që dialogu ndërregjional të zhvillohet, të normalizohet jeta dhe të normalizohen bisedimet, me Serbinë ekzistojnë vija të kuqe të qarta që duhet të dinë gjithë institucionet, partnerët tanë ndërkombëtarë dhe qytetarët e Republikës, pa dallim etnie në Kosovë.

Së pari, Kosova ka integritet territorial sipas formulës së saj kushtetuese dhe për një arsye, dhe jo vetëm për një arsye, nuk mund të bisedohet më apo nuk mund të riciklohen bisedimet shtesë për statusin final. Serbia, që luan tash rolin e një “partneri evropian”, sot na kujton se është po ajo Serbi, e cila në angazhimet konkrete për përmbylljen e procesit të statusit final nuk është larguar asnjëherë nga mentaliteti i saj i vjetër, që të luftojë për territore e jo për të drejtat e qytetarëve.

Së dyti, Kosova është juridiksion unik dhe hapësirë unike ligjore dhe nuk mund të lejojë dy sisteme juridike të ekzistojnë në vendin tonë. EULEX-i si organizatë e mandatuar dhe e pranuar nga ne në Kosovë, është këtu që të ndihmojë, të monitorojë aty ku duhet dhe assesi të marrë rolin e përfaqësimit të Kosovës në këto interesa.

Së treti, Kosova ka një polici, një uniformë dhe një zinxhir komandues. Institucionet e Kosovës nuk guxojnë të lejojnë në asnjë mënyrë që në emër të një uniforme, të një policie të jenë dy zinxhirë komandues dhe të kenë ndërhyrje në këtë sistem.

Dhe, katër, vetëqeverisja lokale është mjet i cili është vendosur në mënyrë afirmative në Kosovë në parimin e subsidiaritetit, që i integron të gjitha grupet, i integron të gjitha komunitetet dhe në veçanti komunitetet etnike pakicë në Kosovë. Vetëqeverisja lokale në parimin e subsidiaritetit është mundësi që qytetarët në kuadër të sistemit tonë unik kushtetues të marrin përgjegjësi konkrete për të përmirësuar jetën e qytetarëve, e nuk është autonomi territoriale dhe nuk është tendencë që të krijohen korridore dhe të krijohen kontrole territoriale.

Andaj, gjithë këto na bëjnë që të angazhohemi sinqerisht në zbatimin e Kushtetutës, duke e njohur mandatin tonë të ndarë sipas autorizimit dhe sipas autoritetit kushtetues dhe ligjor.

Ne propozojmë që Kuvendi të kërkojë nga Qeveria hartimin e dokumentit, angazhimet konkrete, planet e punës që përfshijnë parimin kryesor i cili tash është obligim kushtetues. Parimi i pakos gjithëpërfshirëse të presidentit Ahtisari për zgjedhjen e çështjes së Kosovës është formula e vetme reale e cila e ruan Kosovën të mos shkel vinë e kuqe dhe të mos e rrëshqet në atë që quhet autonomi territoriale.

Shpërbërja e plotë e të gjitha institucioneve paralele në këto shtylla që i paraqita në emër të Grupit Parlamentar, është punë e mundimshme. Nuk është akt i cili mund të përfundojë shpejt, kërkohet durim, kërkohet lidhësi i fortë, kërkohet ndarje e drejtë e angazhimeve dhe e detyrave, kërkohet maturi, kërkohet dituri, kërkohet buxhet. Andaj, ne besojmë se nën udhëheqjen e organit ekzekutiv dhe nën mbikëqyrjen e plotë të Parlamentit të Kosovës këto masa mund të bëhen konkrete, këto masa mund të bëhen realitet dhe, e fundit, duhet një angazhim konkret për një konsensus të përbashkët, ku roli ynë si partner koalicioni, ku roli i opozitës, ku roli shoqërisë civile, ku roli i komunës dhe i të gjithë

atyre që mund të ndikojnë në implementimin e këtyre angazhimeve, gradualisht Kosovën e siguron në shpërbërjen e plotë të institucioneve paralele, që për ne ... nënkupton vetëm pjesën veriore të Kosovës, por struktura paralele dhe funksionim të strukturave paralele kemi gjithkund aty, ku kemi organizimin, ku kemi jetën e komuniteteve etnike, në veçanti nga grupi etnik serb. Andaj, nuk guxojmë të lejojmë që edhe më tutje të vazhdojmë kështu.

Grupi ynë Parlamentar – LDK, si parti politike do ta ketë rolin e vet mbështetës në mënyrë që deklarimi ynë sot, deklarata e sotshme të jetë dokument bazë, të jetë mjaft i mirë politik për Qeverinë, për Kuvendin, për Presidentin e Republikës që bashkërisht të hymë në fazën e dëshirueshme që veprimet tona politike të garantojmë qytetarët për tërësinë territoriale dhe funksionimin e plotë kushtetues. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kryeministër,

Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës,

Pakëz është çuditshëm, të gjithë ne dhe të gjithë ata që e përcjellin Kuvendin, kanë pritur pak më ndryshe që ka për të filluar ky debat sot, gjithë ato pritje të përfundojnë, të flitet në një sistem e të mos thuhej asgjë, është pakëz e çuditshme.

Sidoqoftë, unë po e përcjell mbështetjen e Aleancës edhe njëherë përmes kësaj foltore, por po e përcjell mbështetjen për strategjinë dhe çfarë deklarate kishte për të shkuar në dobi të strategjisë. Prapë e thashë fjalën e fundit të parën, por nuk ka lidhje. Lidhur me këtë duhet thënë disa fjalë, realisht, ka shumë çka të thuhet për situatën në të cilën jemi, për të mos ndodhur që po flasim e s'po themi asgjë, se është keq për Kuvendin ashtu.

Me siguri ju kujtohet juve maji i vitit 2008, kur prej Aleancës ka shkuar një letër te kryeministri dhe te presidenti i Kosovës, me siguri presidenti po na sheh, duhet të na pa çka shohë çka po flasim këtu. Letër në të cilën kemi kërkuar për të pasur plan për rajonin e Kosovës, ka qenë vetëm 2 ose 3 muaj pas pavarësisë dhe në atë kohë kryeministri i Kosovës ka thënë – Plani i Kosovës për veriun është Kushtetuta e Kosovës, që e kam sjellë me veti, dhe ligjet, po ligjet s'kam mund t'i sjell, se janë shumë. Tash kemi ardhur në pozitë ta bëjmë një strategji dhe një plan, më vjen mirë dhe kjo është arsyeja pse e mbështesim, se e kemi lypur, mirëpo dikur është thënë – Kushtetuta. Tani, nëse ju kujtohet, në atë kohë, ekzakt në atë kohë, disa muaj më vonë ka ardhur Raporti i progresit për atë vit, Raporti i progresit i cili tha thënë se Qeveria e Kosovës e ka shkelë Kushtetutën gjatë procesit të buxhetimit. Mund ta nxirrni dhe i shihni Raportin e progresit, i saktë është. Qeveria e ka shkelë Kushtetutën gjatë procesit të buxhetimit, jeni duke e ditur për çka, për Rilindjen e kam fjalën.

Çështje tjetër që është tepër me interes të flitet këtu dhe nuk guxojmë të dalim ne prej këtu pa folur, është çështja e strategjisë për se, vetë strategjisë. Shikoni ju, në një debat të një NGJO-je në Kosovë, të gjithë pjesëmarrësit në tubim e kanë marrë strategjinë e plotë, ju ka shpërndarë kokë për kokë, në tavolinë, nuk ka institucion ndërkombëtar që nuk e ka strategjinë, nuk ka as struktura paralele në veri të Kosovës që nuk e kanë strategjinë. A e dini kush nuk e ka strategjinë? Vetëm Kuvendi i Kosovës nuk e ka strategjinë, vetëm deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk e kanë strategjinë. A ju vjen inat juve?! Unë për veti nuk mund të pajtohem me këtë situatë, në të cilën vetëm deputetëve të Kuvendit të

Kosovës nuk ju ka shpërndarë strategjia. Kujt iu ka shpërndarë, atëherë mund të them që është edhe një shkelje e Kushtetutës nëse dikujt i shpërndahet, dikujt jo, se dikë po e ndiej që po thotë e kemi, e kemi. A i ka shkuar në kuti ndonjë deputeti Kuvendit të Kosovës strategjia? Nëse po, është shkel Kushtetuta edhe një herë. Unë nuk e di që i ka shkuar, mua s'më ka ardhur. Realisht, nuk më ka ardhur se jam, aq më tepër kur jam kryetar i grupit parlamentar më të madh në opozitë, paramendoni ju çfarë shkelje e Kushtetutës. Tani, unë nuk e di a ka për të përfunduar edhe strategjia se 2 milionë fidanë, që kanë pas nisur të mbillen, nuk e di, ndoshta edhe ajo përfundon ashtu. Nuk e di a janë mbjellë 2 milionë fidanë, po marr shembuj, kryetar, se nuk jam aq elokuent sa mos të marrë shembuj për ilustrim.

Çështje e tretë, për të cilën dua të flas, është realisht çka po bën Kuvendi sot. Që prej prezantuesit e deri te unë, çka po bëjmë ne. Po flasim për një çështje, sa për të mos thënë kurrgjë. Ç'është edhe më keq për Kuvendin, më mirë të mos kishim folur hiq, sesa të thyhet Kuvendi kështu. Më së pari, veç na nuk e kemi strategjinë, tash flasim, e bëjmë një dokument palindromik. Palindrom janë fjalët që lexohen njësoj mbarë e mbrapshtë, si njëren anë, si në tjetren. Bëjmë dokument palindromik që e lexo qysh të duash, kurrgjë hiq nuk ka në të. Dhe dikush ne, si Kuvend, na thotë – keni kujdes mos thoni ndonjë send, a dini, mos të thuhet kurrgjë, se Kuvendi këtu është veç mos të bëjë sherr, se mirë nuk mund të bëjë, kështu ashtu, në çfarëdo varianti, mbasi s'mund të bëjë mirë, kujdesuni të gjithë që të mos bëjmë sherr rastësisht, se sherr mund të bëjmë ne si Kuvend.

Tani, në fund, në fakt nuk është krejt në fund, po si kërkesë kish për të qenë e Kuvendit, normale, sot të dalë që të gjithë deputetëve brenda një ore të na sillen strategjia nëpër kuti. Kishim treguar që jeni Kuvend, që ka peshë Kuvendi, që është institucioni më i rëndësishëm në vend dhe që di t'i thotë dikujt – nuk mund të punosh në emër tonin dhe të dështosh në emër tonin pa e ditur ne, ose edhe të kesh sukses, tek e fundit.

Në fund të fundit, e dëgjuam kërkesën gjeneroze të kryeministrit për të marrë pjesë në implementimin e strategjisë. Seriozisht, është gjeneroze shumë, ka qenë dashur të jetë gjeneroz kryeministri edhe në tema të tjera që kanë të bëjnë me opozitën, për shembull, të na thotë – hajde të bisedojmë kah po i bien autostrada, se edhe ajo është çështje tepër jetike për vendin. Qysh po e privatizojmë PTK-në, çka po bëjmë me aeroportin, krejt këto janë çështje tepër të rëndësishme dhe ka qenë dash edhe në atë kohë t'i thuhet opozitës – të bisedojmë, se janë çështje që kanë të bëjnë me një kohë shumë të gjatë, kohë që ndoshta shkon edhe përtej jetës sonë, jo vetëm mandatit tonë. Mirëpo, për ato për t'i pasur meritat, nuk ka nevojë kryeministri të bisedojë me ne, ndërsa për ta ndarë përgjegjësinë kur tutet që po dështon, ka nevojë edhe për ne. E tash, po ju them unë juve, mbështetja jonë për strategjinë është këtu kjo që e thamë. Po nuk e kemi në plan të marrim barrë, nuk kemi plan të marrim barrë kur nuk udhëheqim as Ministri të Punëve të Brendshme, as të Drejtësisë, as nuk udhëheqim me buxhet, me asnjë send tjetër, do me thanë, ta keni të qartë, nuk e kemi në plan të marrë këso farë barrësh dhe shumë e falënderoj kryeministrin për thirrjen që na bëri. Në fund të fundit, ne prapë do të vazhdojmë të kërkojmë plan veprimi. Çka ka për të bërë Kosova nesër në mëngjes, çka ka për të bërë pas dy vjetësh, pas 3, 4, 5, çka kemi për të bërë ne, kush e di çka ka për të bërë nesër në mëngjes kur shkon në zyrë? Qeveritë, realisht, kështu punojnë. Nëse kemi për të pasur strategji dhe aq më tepër nëse Kuvendit të Kosovës i bien këso farë dokumentesh që i shkruajnë numrat me dorë, këqyrni këtu, a e dini pse i kanë shkruar, se e kanë rritur fontin në 16 për t'u dukur më i gjatë. Nëse bëhen në fontin 12, qysh janë dokumentet zyrtare, 2 faqe dalin. Kjo është informata që na vjen neve.

Edhe një herë po them, është mbështetja për strategjinë, nuk duam të marrim barrë, mendoj se Kuvendi nuk guxon të lejojë të thyhet kështu, mendoj se, në fund të fundit, përpos deklaratës duhet të kërkohet që sot brenda një ore të na e sjellin strategjinë, se unë e ndiej veten shumë keq dhe nëse ka deputet që nuk e ndien vetën keq, mua seriozisht nuk më vjen mirë, nuk guxoj të jem, do me thanë, aq i lumtur nëse kjo ka për të qenë situata e vazhdueshme në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, i nderuari zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Unë do të shfrytëzoj rastin, zoti kryeministër, që të reagoj ndaj keqtrajtimit të djeshëm të gazetarit të “Kohës Ditore” nga pjesëtarët e sigurimit të Qeverisë dhe konsideroj se ka ikën koha e kërcënimeve dhe e futjeve nëpër bodrume. Kërcënimet e tilla kanë filluar që të bëhen praktikë në institucionet e vendit. Prandaj, do të duhej të ndërmerreshin masa.

Të nderuara kolegë,

Pas shumë përpjekjeve të pasuksesshme të opozitës, që prej 17 shkurtit të vitit 2008, për të debatuar për një nga çështjet më të rëndësishme, edhe atëherë, edhe tash, për vendin, pra për zbatimin e Kushtetutës në gjithë territorin e vendit dhe për funksionimin e strukturave të Serbisë në Kosovë, sot për herë të parë po e trajtojmë këtë çështje shumë të rëndësishme, jo vetëm për të tashmen, por edhe për të ardhmen e vendit në përgjithësi.

Shpallja e pavarësisë së vendit nga Kuvendi i Kosovës ishte e ditur se do të përcillej me pakënaqësi të një pjese të qytetarëve të Kosovës dhe se priteshin reagime jo vetëm brenda Kosovës, por edhe përreth kufirit të saj me Serbinë. Megjithatë, institucionet, konkretisht Qeveria e Kosovës nuk kishte përgatitur një strategji për të mos lejuar dhunimin e institucioneve dhe për të garantuar sigurinë jo vetëm fizike për qytetarët dhe për të garantuar funksionimin e institucioneve. Kjo fliste mjaftë se koalicioni qeverisës nuk e kishte marrë me seriozitet drejtimin e vendit dhe se nuk ishte i përgatitur për sfidat që do të vinin pas shpalljes së pavarësisë.

Sikurse dihet, grupe ekstremiste serbe, të involvuara edhe në aktivitete të ndryshme kriminale në Kosovë, duke përfshirë edhe krimin e organizuar, të shtyrë drejtpërdrejt nga politika e Beogradit – shkatërruan pikat doganore 1 edhe 31 në veri të Kosovës, sikurse edhe uzurpuan objektet e institucioneve në atë pjesë të vendit. Edhe në pjesë tjera në kufij me Serbinë kishte tentativa dhe përpjekje të grupeve ekstremiste për të cenuar tërësinë territoriale të vendit, por që u penguan nga pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës, të cilët ato ditë patën mbetur edhe pa mbështetje politike.

Ekzekutivi i vendit u tregua tërësisht i paafte për të menaxhuar me situatën e krijuar dhe kështu pika doganore dhe kufiri në pjesën veriore zhvendosi disa dhjetëra kilometra në brendësi të territorit të vendit, duke lënë rreth 20% të territorit të vendit nën ligjin e bandave kriminale, të cilat për çdo ditë rrezikonin banorët e paktë të mbetur në atë pjesë të Kosovës.

Gjendje përafërsitë e njëjtë në atë pjesë të vendit vazhdon të mbretërojë edhe dy vjet pas pavarësisë së vendit. Ndërkaq, nga Prishtina bëhet sehir dhe inkurajohen banorët shqiptarë të asaj pjese që të mos lëshojnë shtëpitë e tyre. Qeveritarët nuk ju erdhën në

ndihmë banorëve të asaj pjese as atëherë kur ata sulmoheshin dhe dëboheshin nga shtëpitë e tyre nga bandat e organizuara, as atëherë kur bënë përpjekje për t'u kthyer në vendin e vet dhe për të rindërtuar shtëpitë e veta, as atëherë kur nën presion të Serbisë detyroheshin që t'i shesin pronat. Qeveritarët mjaftoheshin me deklaratat nga zyrtarët luksoze në Prishtinë, ndërkaq askush nga ata nuk e merrte mundin për t'i vizituar në atë pjesë dhe së paku për të qëndruar me ta në ato momente kritike.

Të nderuar kolegë,

Jam i vetëdijshëm se kjo qeveri, sikurse edhe qeveritë e kaluara nuk e kanë krijuar këtë gjendjen në pjesën e vendit, por jam shumë i bindur se me mos veprimet e veta i kanë kontribuar përkeqësimit të gjendjes atje dhe i kanë shtuar apetitet e grupeve kriminale për veprim të lirshëm, duke rrezikuar kështu rendin kushtetues.

Pothuaj se për çdo ditë na bie të dëgjojmë për veprimin e strukturave paralele të Serbisë në Kosovë, por unë po e shtoj një pyetje të nderuar kolegë: - Kujt i bëjnë paralelizëm ato, cilave institucione?

Strukturat paralele në pjesën veriore të Kosovës janë të vetmet institucione që veprojnë në atë pjesë, sepse Kosova nuk ka arritur të krijojë institucione të saja asnjëherë, madje as që ka pasur përpjekje për një gjë të tillë.

Ne, kolegë të nderuar, kemi ardhur në pozitë kur duhet t'i lusim për kthimin e gjykatave në veri të vendit, ashtu sikurse një kohë lusim Serbinë për të na liruar ndonjë shkollë diku.

Edhe pjesëtarët e Policisë së Kosovës në veri as nuk komunikojnë me komandën e policisë në Prishtinë, as nuk marrin detyra nga ata, as nuk iu përgjigjen atyre. Pra, nuk e njohin zinxhirin komandues. Edhe në pjesë të tjera të vendit pa pendueshëm veprojnë institucionet e Serbisë, madje ato në disa vende bashkëjetojnë në të njëjtat objekte me institucionet e shtetit të Kosovës.

Të nderuar kolegë,

Qeveria e Republikës së Kosovës është treguar e paaftë për të garantuar funksionimin e Kushtetutës në tërë territorin. Është treguar e paaftë në sundimin e ligjit, është treguar e paaftë në luftimin e bandave kriminale në ato pjesë të vendit, është treguar e paaftë për të garantuar sigurinë e qytetarëve në pjesën veriore, është treguar e paaftë për të garantuar kthim në pronën e vetë të të dëbuarve nga ajo pjesë, me një fjalë, Qeveria e Republikës së Kosovës një pjesë të territorit të vet e ka lënë në administrimin e bandave kriminale, të cilat po i terrorizojnë për çdo ditë banorët e paktë të mbetur në atë pjesë.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka toleruar dhe po toleron lulëzimin e krimit të organizuar në rreth 20% të territorit të saj.

Qeveria e Republikës së Kosovës në kohën kur çështjet e veriut të Kosovës diskutoheshin në kancelaritë e ndryshme botërore, ajo përpiqej që ta minimizonte, madje edhe duke i kritikuar zërat kritikë që kërkonin vendosje të rendit dhe të ligjit në atë pjesë, i cilësonte si thirrje për dhunë.

Të nderuar kolegë,

Paaftësinë e vet për t'u përballur me realitetin në veriun e Kosovës kjo Qeveri është përpjekur ta arsyetojë me fraza ose duke akuzuar të tjerët për kërkesat e tyre ose duke dhënë deklarata se situata është nën kontroll dhe nuk duhet të shqetësoheni për asgjë.

Jemi përpjekur me dhjetëra herë që të ngrehim këtë çështje në këtë organ, por për fat të keq nuk kemi hasur në mirëkuptim asnjëherë. Tashmë jemi në një fazë kohore kur veprimet duhet të jenë shumë të matura, por edhe këmbëngulëse për të vendosur rend dhe ligj në secilin pjesë të vendit, veçanërisht në pjesën e veriut të Kosovës. Para një viti ka qenë shumë më lehtë se sot, por sot është shumë më lehtë se sa që do të jetë pas një viti.

E ashtu quajtura Strategji e përbashkët e Qeverisë dhe ICO-s për vendosjen e rendit dhe të ligjit në pjesën veriore të Kosovës është dashur të jetë e gatshme para dy vjetësh, por nuk ndodhi ashtu sepse u desh të vinte dikush në Kosovë e t'ju thoshte institucioneve tona se kjo gjendje nuk mund të tolerohet më, andaj duhet të ndërmerrni diçka. E kemi thënë dhe po e përsërisim se jemi të vendosur dhe të përkushtuar për të përkrahur çdo iniciativë që çon në drejtim të vendosjes së autoritetit kushtetues në secilën pjesë të territorit të Kosovës. Por, më duhet të them se po të kishte përkushtim nga ana e Qeverisë për një gjë të tillë, atëherë jo vetëm opozita, por edhe pjesë të tjera të shoqërisë në Kosovë do të duhej të ishin të përfshira në këtë proces, sepse këto janë shqetësime të të gjithë neve dhe jo vetëm të një krahu politik. Po të kishte seriozitet për veprim, kjo strategji do të duhej të hartohej dhe debatohej pikërisht në këtë institucion ku jemi, sepse kështu do të ishte një pajtim dhe përkrahje e të gjithë spektrit politik në Kosovës. Jo që nuk ka ndodhur kjo, por neve si deputetë të Kuvendit na është sjellë vetëm një përmbledhje e strategjisë dhe jo e gjithë strategjia. Kështu trajtohet Kuvendi i Kosovës.

Këtë strategji e përcjellin një mori të metash dhe ka rrezik ta bëjnë të pazbatueshëm në praktikë. Strategjisë i mungon një prej çështjeve kryesore që do të duhej ta përmbante – eliminimi i strukturave të Serbisë, të cilat me çdo kusht do t'i bëjnë rezistencë çfarëdo lloj përpjekjeve për të vendosur rend dhe ligj.

Eliminimi i strukturave të Serbisë dhe luftimi i krimit të organizuar përmes zbatimit të ligjit, së bashku me zhvillimin ekonomik dhe social, do të ndikojë në integrimin e të gjitha komuniteteve në shoqëri pasi që praqet një perspektivë të qartë për të gjithë qytetarët e pjesës veriore. Jemi shumë të bindur se edhe qytetarët serbë janë lodhur nën hijen e atyre strukturave dhe të krimit që është legalizuar në atë pjesë. Megjithatë, sikur e thashë, ne jemi të përkushtuar për të përkrahur çdo përpjekje të institucioneve të vendit, që duke i shfrytëzuar të gjitha instrumentet ligjore në dispozicion, të garantojnë jo vetëm tërësinë territoriale të vendit dhe vendosjen e rendit dhe të ligjit, por edhe të ofrojnë një perspektivë të qartë ekonomike dhe sociale për të gjithë qytetarët e vendit. Duke pasur parasysh se vetëm një strategji gjithëpërfshirëse do t'i merrte në konsideratë si vendosjen e rendit dhe të ligjit, po ashtu edhe shqetësimet ekonomike, sociale dhe politike të qytetarëve dhe do të ndikonte në eliminimin e ekstremizmit dhe në zhvillimin e një perspektive të re. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Pasi foltorja po shfrytëzohet për propagandë për opinion, unë dua të them se të gjitha seancat nga 9 janari i vitit 2008 e kënde, janë arritur me konsensus të plotë dhe gjatë gjithë kësaj kohe nuk është refuzuar për debat asnjë kërkesë e grupeve parlamentare në Kuvendin e Kosovës. Po e saktësoj, asnjë kërkesë e grupeve parlamentare në Kuvendin e Kosovës. Vazhdojmë me debatin.

Fjalën e ka kryeministri.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Unë e kuptova shumë drejt edhe iniciuesin e këtij debati që duhet të na çojë drejt një qëndrimi unifikues shtetëror dhe jo të shfrytëzohet për propagandë, të shfrytëzohet për marketing ditor politik apo të marrë kahun e një debati ndërpartiak apo qeveri – opozitë. Të gjitha përpjekjet tona vazhdimisht, vazhdimisht e theksoj, kanë qenë që çojnë drejt një procesi të përbashkët unifikues dhe bashkëveprues, prandaj së pari dëshiroj të theksoj se të gjithë këtu që po flasim, e kanë pasur mundësinë, një kohë edhe pushtetare, të tregohen për veriun e Mitrovicës, i kanë pasur përgjegjësitë dhe kanë qenë në dy qeveritë e kaluara, njërën prej tyre edhe e kanë udhëhequr për tri vite. Prandaj, duhet tentuar sinqerisht dhe ju ftoj të largoheni nga arkaizmat pseudo – patriotike. Tentativave të ndryshme për të treguar patriotizëm në emër të veriut, unë besoj se të gjithëve u ka kaluar koha. Secili nga ne ka pasur mundësi të tregojë veten në kohë më të vështira se sa në këtë proces. Në emër të patriotizmit askush nuk mund të mbulojë mos idetë dhe mos vizionin e tij.

Sa i përket folësit të fundit, nuk dëshiroj të shpreh opinionet e mia kësaj radhe, por do të flas në një moment, se edhe ju e dini se nuk është ashtu, por dëshiroj të theksoj se ka pasur, por edhe të sqaroj para së gjithash, para juve, deputetë të nderuar, para Kabinetit qeveritar dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe partnerëve ndërkombëtarë.

E di se ka pasur shkrime të ndryshme në mediat serbe, të cilat janë prezantuar pastaj dhe janë bërë tema të politikës kosovare padrejtësisht, duke i torturuar qytetarët e Kosovës me dezinformata krejt të panevojshme, të qëllimshme dhe reaguese në kuptimin e gjërave që nuk mund të ndodhin kurrë në Republikën e Kosovës. Kosova është shtet i pavarur, është unik, e ka territorin e vet, prandaj edhe çështjeve të ngritura në mediumet serbe e të bartura për debate këtu në skenën politike, u japim përgjigjen që e meritojnë se nuk do të ketë në asnjë rrethanë as Dejtton të ri, as model gjermano-gjerman, sepse Kosova dhe Serbia janë dy vende dhe dy popuj dhe janë shtete të pavarura, thotë – modelet që po i prezantojnë aty-këtu, nuk do të ketë as shtet brenda shtetit, sepse Kosova është një shtet dhe do të funksionojë si unik. Nuk do të ketë as autonomi të zgjeruar, por respektim të plotë të dokumentit të presidentit Ahtisari. Nuk do të ketë as ndryshim të kufijve, nuk do të ketë as bisedime për status, por fqinjësi të mirë me çdo shtet të rajonit. Do të ketë vetëm respektim të plotë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të ligjeve të Kosovës, respektim të plotë të dokumentit të presidentit Ahtisari. Tash po e potencoj se mbi 85% është zvogëluar kontrabanda në atë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës, për dallim më herët. E di se ka pasur edhe ide që vetëm të vihen postblloqe policie, por kam qenë dhe jam dhe do të jem vazhdimisht kundër përdorimit të dhunës. Ka pasur edhe ide që të blihet vullneti i qytetarëve në veri me nga 5000 euro për një qytetar serb. Vullneti i qytetarëve nuk blihet, respektohet vullneti i qytetarëve në procesin demokratik, prandaj edhe është i përfshirë në strategjinë për integrimin, strategji e cila i ka pikat e veta, strategji e cila përsëri kërkoj të mbështetet në angazhimet tona të gjithanshme dhe ky debat të mos politizohet, të mos shikohet në kuptimin e ngushtë të kornizave partiake apo të patriotizmit në emër të mos ideve apo mos vizionit. Kosova e ka vizionin bashkë me bashkësinë ndërkombëtare. Ju faleminderit, shumë!

Përndryshe, sa iu përket investimeve dhe jo investimeve që u cekën këtu, unë dëshiroj të theksoj se për 8 vite zero euro është investuar në veri, ndërsa vetëm për vitin 2008-2009, janë investuar mbi 8 milionë euro dhe investimet do të vazhdojnë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, kryeministër!

Grupi Parlamentar i LDD-së e ka kryer kohën e vet, tani është radha e Grupit Parlamentar "7+". Kush e donë fjalën? Xhezair Murati e ka fjalën.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, predsedniče!

Poštovani premijeru, zameniče

Ministri, kolege i gosti,

U ime Parlamentarne grupe „7+“, pozdravljam angažovanje i pokretanje ove inicijative Parlamentarne grupe LDD-a, ali i napore Vlade i međunarodne zajednice na institucionalan početak razmatranja ove tako osjetljive, ali izuzetno značajne teme za sve građane Kosova. Jednom je moralo početi. Bilo je mnogo bolje da je ovo bilo pre 5 godina, ali je i sada mnogo bolje nego da smo ovo pokrenuli kroz 5 godina. Možemo da polemishmo oko toga kako nakon današnje rasprave nazvati dokumenat koji treba da obavezuje i Vladu i institucije Kosova, ali i pomoć međunarodne zajednice, dali rezoluciju ili deklaraciju.

U ovom momentu, svakako da više odgovara i možda je primerenije nazvati je deklaracijom, bez obzira na to što sam i u pripremi za ovu debatu, u više navrata bio u dilemi, s obzirom na to da deklaracija ima više informativni nego obavezujući karakter. Ovo je prilika da kažem da treba nekako ubaciti formulaciju paralelnih struktura s obzirom na to da ove reči, ovi termini se pominju i u Ahtisarijevom dokumentu. Takodje je prilika da zahvalim građanima moje zajednice koji žive na severu Kosova, koji su i pored ogromnih poteškoća sa kojima se suočavaju, prihvatili kosovsku realnost dajući joj pečat i izlaskom na izbore i prihvatajući sve izazove sa kojima se suočavaju. Ovo je prilika da pozovem i Vladu da se više setimo njih i da u znak zahvalnosti njima pomognemo u svakodnevnom životu, jer su zaista suočeni sa posebnim poteškoćama u svom svakodnevnom životu.

Danas ću pomenuti da i proces decentralizacije koji se pominje u oba pomenuta, malopre navedena dokumenta, do sada je prema nekim zajednicama bio jako izdašan, a prema nekima nije uopšte ni pokrenut. Sve u svemu, naša Parlamentarna grupa je uverena da će današnja debata u Parlamentu pokazati našu zrelost i punu spremnost na rešavanju problema građana, ali iz svih zajednica. Ovo je konkretan doprinos naporima ka većoj regionalnoj stabilnosti, jer je Kosovo prihvatilo ovaj izazov svojim konstruktivnim primerom i zalaganjem, te mi iz Parlamentarne grupe „7+“, koja predstavlja tri integrisane manje brojne zajednice, potvrđujemo da je ovo najbolji putokaz brige za sve građane, ali i poziv okruženju na zajedničke napore, na miran demokratski i diplomatski način da rešavamo nasleđene probleme. Pozitivni primeri drugih u Evropi su i najbolji primer da ih mi sledimo, jedino ćemo tako budućim generacijama omogućiti ono što je nama nedostajalo.

Gospodo, sudbina malih naroda i država je jedino moguća i predodređena da mogu napred samo politikom korak po korak. Te prve korake, ali uspešne, već smo počeli da pravimo. Jedino tako možemo i nastaviti. To je najbolja preporuka da ne ponovimo negativan bosanski primer. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit, Xhezair, hvala!

Vazhdojmë, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Slobodan Petroviq e ka fjalën.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, predsedniče!

Uvaženi premijeru,

Zameniće premijera,

Ministri,

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Ono što sam imao nameru da kažem, jednostavno možda i gubi malo težinu pošto vidim da i u samoj Vladi nema puno interesovanja, jer nekako je više u hodniku nego ovde, ali dobro. Ono što je za nas, pre svega kao predstavnika Srpske zajednice, koji su u svakom slučaju odgovorni kao ljudi, je obaveza da budemo danas na ovoj debati, pre svega ne samo zbog debate uopšte, nego uopšte zbog interesa onih ljudi koji su dali poverenje nama da budemo u ovom visokom domu ovde.

Koliko god bila osetljiva ova tema, ona je neophodna da bude na dnevnom redu i neophodno je da mi kao odgovorni ljudi uzmemo učešće u tome. Što se tiče Samostalne liberalne stranke, kao predstavnika Srpske zajednice, je pokazalo u periodu koji je iza nas kako i na koji način želi da artikuliše te probleme i kako da ih rešava.

Na naše zadovoljstvo, imali smo vidljive rezultate koji nisu bili mogući i bez vaše podrške, pre svega podrške Vlade, a samim tim želim da se zahvalim kako poziciji, tako i opoziciji i ujedno i našim prijateljima iz međunarodne zajednice. Ono što sam mogao da prepoznam u izlaganju premijera, jeste da smo mi prepoznali da ima tu dosta stvari koje su od interesa Srpske zajednice, i svakako, kako i kaže jedna izreka: „ne može niti jednom brodu na moru pomoći vetar i jedra ukoliko on ne zna gde mu je luka“. Znači, ukoliko mi ne znamo šta je naš cilj, šta je naš interes, možemo se vrteti u krug. Ono što je prepoznatljivo sa stanovništva Samostalne liberalne stranke, jeste da mi znamo apsolutno naš cilj i znamo našu odgovornost. Pre svega, ja sam odgovoran kao poslanik i to je mandat svih nas ovde da obezbeđujemo prosperitet ovih ljudi koji su na glasali i ujedno bolji život. Iako trebam da reskiram svoju popularnost, za radi toga ja ću uvek reskirati, ja ne želim da budem popularan, želim da budem od koristi ovih ljudi i, apsolutno, ono što je svakako prepoznatljivo, što je i sam premijer u izlaganju rekao, to je prepoznala i sama međunarodna zajednica.

Ja sam imao prilike i privilegiju da dva dana budem u Briselu, jutros sam se vratio, reći ću vam samo da smo imali privilegiju da budemo govornici u Parlamentu Evrope, upravo na temu lokalnih izbora, odnosno na koji je način uspela Srpska zajednica da probije blokadu. Znači, ukoliko imate strategiju, ukoliko imate volju i želju sve je moguće rešiti. Iz tog razloga smo mi dobrovoljno uzeli učešće u ovoj debati, pre svega zbog interesa tih ljudi.

Ono što isto želim jasno naglasim da mi ne želimo da uzimamo učešće za rad samo neke političke demagogije, zato imam jasnu potvrdu u našim angažovanjima koja su bila iza nas, reći ću vam samo u procesu decentralizacije, gde spo bili gotovo usamljeni u našem stavu da će Srpska zajednica prepoznati svoje predstavnike jer smo, naime, u poslednje dve godine uspeali da im na konkretan način pokažemo da i ove institucije mogu da budu njihov interes. Znači, to kažem iz jednog razloga da ukoliko želimo da pravimo situaciju i na severu Kosova, onda je neophodno da ovde, gde već imamo postojeće opštine, napravimo zajednički rezultat. Apsolutno sam siguran i svestan da, to je čak šta više i prepoznatljivo u našim aktivnostima, dali je neophodno učešće u integracijama, dali je neophodno učešće Srpske zajednice. Apsolutno, i naše učešće ovde to jasno

pokazuje. Sigurno da to nije popularno, ali to je interes, dugoročni interes Srpske zajednice. I ja ohrabrujem i zahvaljujem se premijeru na rečima koji je iskazao i našim prijateljima iz međunarodne zajednice koji su rekli da će se to raditi u obostranom interesu i sve ono što ne izaziva tenzije, teror, nasilje, to će biti podržano. Svakako ne morate da budete poznavalac kosovskih prilika da vidite da na Kosovu nije situacija kako bi svi želeli da bude, ali to je još jedna obaveza da mi svi zajedno pravimo bolje uslove, i apsolutno mi kao odgovorni ljudi, bez obzira koju težinu imamo za sve to i koju odgovornost, želimo da budemo deo rešenja a ne da budemo deo problema. I to je nešto što zaista trebate na takav način da prihvatite. Još jednom želim da kažem da sve ono što je u interesu ovih ljudi koji žive ovde, pre svega mi imamo ne samo političku, nego i moralnu obavezu jer smo dugi niz godina zajednički prevazilazili mnogih problema. Znači, mi imamo obavezu da tim ljudima bar obezbedimo bolju i sigurniju perspektivu. Iz tog razloga, još jednom kažem da smo mi deo svih onih procesa koji će ići u tom pravcu. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Ju faleminderit, Petroviq, hvala!

Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, fjalën e ka deputeti Numan Baliq.

NUMAN BALIĆ: Ju faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Selam svima zastupnicima koji su prisutni u sali i onima kojima nas gledaju i slušaju.

Želim da kažem nekoliko riječi i u ime Grupe i u svoje ime, da bi smo malo doprineli ovom zajedničkom razgovoru o jednom vrlo važnom pitanju koje se tiče sadašnjeg trenutka na Kosovu, ali i budućnosti koja je pred nama i koja je još važnija od ovoga što danas govorimo.

Podsetiću vas da govorimo o pitanju primene Ustava i zakona na Kosovu na Kosovu, a ranije Ustavnog okvira koji je postojao do prije dve godine, i podsetiću vas takođe da govorimo o strukturama, paralelnim strukturama, a ustvari se ne radi o paralelnim strukturama, nego se radi o strukturama države Srbije, da budemo potpuno otvoreni, na sjeveru Kosova i što jeste veliki problem, veliki problem za jedinstveno funkcioniranje Kosova kao države, koji smo videli od 99-te godine naovamo. Dakle, taj problem postoji punih 10. godina, i on je novi i pomalo je zakašnjelo ili otužno da sada uzvikujemo revoltirani, pa šta se to dešava i zašto imamo te strukture i zašto se ne sprovodi Ustav, a to stanje već postoji 10. godina. No, bitno je da identifikujemo da taj problem postoji i da imamo spremnost za njegovo rešavanje, ali takođe važno da ustanovimo da mi u tom rješavanju nismo sami i da ne zaboravimo da se ovim pitanjem prije mesec dana ili nešto malo manje, 8 februara, bavio naš premijer, koga možemo još uvek nazvati mladim, i međunarodna upravljačka grupa i da su tada donele neke vrlo važne stavove, a te stavove svakako moram uzeti u obzir, i ja sam ih pomno proučio, odnosno potrudio se da ih proučim, pa mi je prvo palo u oči da se radi o međunarodnoj upravljačkoj grupi za Kosovo. Dakle, Kosovom još uvek postoji neka grupa koja njime upravlja, koja nas obavezuje, tu su evropske zemlje, zapadno-evropske, Amerika, oni koji smo do skoro nazivali sponzorima nezavisnosti i oni koji su nas jako puno pomogli i mi ne možemo biti, i da hoćemo samostalni, potpuno samostalni da rješavamo ova vrlo važna pitanja.

Obavezujući se tim dogovorom, najpre i tim dokumentom, da tako kažem, koji je tamo prihvaćen, a koji je vrlo važan, mi na jednoj strani imamo, moramo identifikovati da je Kosovo u međuvremenu jako napredovalo, da su ostvarene značajne stvari, da imamo napretke vezano za razvoj svih zajednica, podvlačim svih zajednica, da se ne radi samo o srpskoj zajednici, nego da se radi o većinskoj albanskoj zajednici, ali se radi i o drugim zajednicama: Bošnjacima, Romima, Aškalijama, Egipćanima i svima ostalima

koji žive na Kosovu. Dakle, o svim zajednicama, međunarodnoj zajednici, većinskim Albancima i dakle mnogo je faktora u igri, činilaca u igri koji moraju biti prisutni i, naravno, da pomenem i to da u dokumentima koji su u pitanju i u Strategiji za sjever, i u dokumentu Međunarodne upravljačke grupe spominje se Republika Srbija kao partner, kao oni sa kojima moramo sarađivati zato što nismo sami, zato što moramo zajedno sa drugima graditi novo Kosovo i uspostaviti cijenu za ono što hoćemo uraditi. Ako hoćemo jedinstveno Kosovo u njegovim granicama i obezbediti suverenitet ne cijelom Kosovu, onda moramo omogućiti svim zajednicama da imaju sva svoja prava. Znači, prema dokumentu koji je predložen, moramo osnažiti lokalne Srbe i pružiti im mogućnost u Sjevernom Mitrovici i u tri druge tri opštine da dobiju sve ono što im po pravu pripada, ali ovdje imamo jedan dobitak, ja imam na umu ono što je za nas bitno, za sve nas, za Albance, Bošnjake i one koji su manjina na sjeveru.

Molim vas, ja sam više puta bio u Bošnjačkoj mahali na sjeveru Mitrovice, s one strane Ibra, a ne verujem da je baš mnogo poslanika ovdje spremno tako olako da pole tih riječi punih revolta da ode tamo ili ne daj bože da puca, dakle mi možemo govoriti o tome, ali treba to uraditi, treba zasukati pantalone ili da ne kažem ono što je ispod, pa krenuti tamo. Dakle, govorimo o vrlo važnim stvarima, a da se vratim na dobitak. Počev od Bošnjačke mahale koja je u tampon zoni i koja, kao što ime kaže, tamo desetinama godina ima Bošnjačku većinu ali tamo žive i Albanci, i Srbi, i svi ostali, ali kojih je sve manje i manje, možda je već više od 60% tih ljudi prodalo.

Ovim dokumentima Vlada će moći da interveniše direktno tamo, u sjevernom Mitrovici ćemo imati lokalnu kancelariju za zajednice i moćićemo da utičemo da se rješava pitanje Bošnjaka u mahali, Bošnjaka i Albanaca u sjevernoj Mitrovici, Bošnjaka i Albanaca u Leposaviću, u Rvatskoj, u onim selima u kojima oni žive i koja gotovo da smo zaboravili, pa iako neki govori da su tamo dobili izbore sa 5-6 glasova. I jedan naš subjekat kaže je dobio glasove u Leposaviću, ali treba otići tamo i ući u tu izvršnu vlast koja je tamo i, naravno, pitanje Košuta i ostalih sela. Ovo je konkretan dobitak koji se tiče toga dela Kosova i ove zajednice o kojoj govorimo, ali mi ovde imamo i jedno drugo pitanje koja se tiče, kao što sam prije u uvodu rekao, integracije svih zajednica. Dakle, nije riječ samo o pitanju Srpske zajednice zato što to radimo, zato što nas je neko pritiskao, a realno je da je postojao taj pritisak i da je najveći dio ovih stvari i urađen zbog tog pritiska, ali je činjenica da se ovdje rešava pitanje svih zajednica, činjenica je da ovim moramo avansirati konačno prava svih zajednica, da moramo pojačati napore za razvoj lokalne samouprave, ne samo sjevernog Kosova, nego lokalne samouprave i ispraviti one stvari koje se tiču svih zajednica.

Konkretno, ako mislim za Bošnjake, Aškalije, Rome, Egipćane i druge, pošto sam dovoljno govorio o Srbima, a možda o Srbima nisam ni trebao toliko, onda moram reći da ne samo da trebamo govoriti o ravnopravnosti, nego da trebamo govoriti, oprostite, ne samo trebamo govoriti o integraciji, jer se radi o ljudima koji žive tu. Dakle, nije riječ o Koreancima koji su se doselili na Kosovo i koji se trebaju integrirati u Kosovo. Riječ je o zajednicama koji žive stotinama godina i bolje je mnogo govoriti o njihovoj ravnopravnosti i ostvarivanju njihovih prava koja se tiču zapošljavanja, jer su i dalje neravnopravni u tom smislu. Neke zajednice, kao što su Aškalije, Romi, Egipćani, izrazito su neravnopravni i to moramo uočiti kao problem, a ne negirati problem i zabijati glavu u pijesak. Potom, trebamo raditi na razvoju sredine u kojima žive ove zajednice, i Bošnjaci, i Romi, i Aškalije i Goranci i svi ostali. Zatim, obrazovanje na svim nivoima omogućiti za sve ove zajednice, učešće u opštinskim vlastima na svim nivoima i promeniti onaj uzus od 10%, jer je jako visok. U nekim opštinama nije moguće

postići tih 10%, i naravno, omogućiti da zakone koje smo doneli, da se primenjuju a ne da u nekim stvarima, naravno u mnogim stvarima jesu primenjeni, ali u drugim stvarima trebamo dosljedno primijeniti i raditi na njihovom oživotvorenju u interesu svih zajednica i cijeloga Kosova.

Ovdje bih napomenuo još jednu stvar, nadam se da ću imati vremena, Sveobuhvatni prijedlog o rješenju statusa Kosova. On govori takođe o decentralizaciji, ali mi nismo dosljedno pristupili ostvarenju toga dokumenta. Član 12.3 jasno kaže da druge zajednice koje ispunjavaju potrebne uslove, mogu stupiti u dogovore, trebaju stupiti. Vlada je dužna da stupi u dogovore sa njima radi formiranja novih opština. Ja ću izričito izrijetkom spomenuti da su Bošnjaci i Goranci zatražili još prije 4. godine u okviru decentralizacije nove opštine: Vitimiricu, Rečane i Dragaš i ova je prilika da podsjetim i novog premijera, a to je bilo predmet razgovora i sa prethodnim premijerima i znamo svi šta je bilo. Dakle, nije dovoljno samo da sve istrešemo na ovu Vladu, nego imamo jedan kontinuitet događaja koji nisu riješeni, to je breme koje je preneto od ranije i Vlada je u najmanju ruku dužna, časno je da kaže – ove prijedloge koje ste dali, hoćemo da vam damo te opštine ili vam nećemo dati i zbog čega nećemo dati. Dakle, mi tražimo odgovor da u duhu sveobuhvatnog prijedloga rešenja statusa, osim 5 albanskih, sjeverne Mitrovice, oprostite, 5 srpskih opština sjeverne Mitrovice, koja se takođe računa kao srpska, ali koja će biti i multietnička, zatim dvije albanske i jedne turske, a znamo svi koje su, da se razgovara oko toga, da se Bošnjacima i Gorancima omoguće nove oštine: Vitimirica, Rečane i Dragaš, jer će to popraviti njihov život, jer će to omogućiti njihov opstanak na Kosovu, jer će to omogućiti razvoj Vitimirice, Rečana i Gore i omogućićće da ti građani Kosova ostanu na Kosovu. To je jedini način da pravo i zdravo prihvatimo brige svih naših građana i svih zajednica, ponavljam. Ovo je pitanje svih građana i svih zajednica i u tom smislu moramo biti puno obazriviji.

Sa ovim bih završio, ne znam koliko sam ovo blizu kraja sa vremenom i poručio bih da je vrlo važno da budemo trezveni, da usvojimo dokumenat koji je najbolji i da rezolucija koja je predložena je suviše oštra i da treba težiti jednoj zajedničkoj deklaraciji koja bi obuhvatila mišljenja i stavove svih parlamentarnih grupa i svih zajednica i, naravno, ovde da ne zaboravim, evo jedan moj kolega iz grupe klima glavom jer i u našoj grupi neki imaju rezerve oko ovog i moramo uzeti u obzir sve rezerve vezano i za rezoluciju ili novu deklaraciju za koju bismo mi bili i koju bismo bez rezervno podržali, naravno, ako bi ona podržala sve zajednice i sve nas i Kosovo...

KRYETARI: Ju faleminderit, hvala!

Para se ta vazhdojmë debatin me deputetë, propozoj formimin e një grupi të punës, të përbërë nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare për hartimin dokumentit të përbashkët lidhur me debatin që do të zhvillohet sot, i cili në fund do të miratohet nga Kuvendi, apo po shkojmë me shefat e grupeve parlamentare. Ju faleminderit.

Me shefat e grupeve parlamentare kemi ra në dakord, megjithatë Kuvendi duhet të vendos, që diskutimet të zgjasin 5 minuta. Megjithatë, ne po e qesim në votim, se është kërkesë e shefave të grupeve parlamentare.

Kush është “për”? Ju faleminderit!

Kush është “kundër”? Ju faleminderit! Me shumicën e votave, diskutimet zgjasin 5 minuta. Ju faleminderit shumë! Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit,

Zoti kryeministër,

Zotërinj dhe zonja deputetë,

Tema është shumë e rëndësishme dhe ne edhe Kryesi, rreth përgatitjes, jemi kujdesur që tema të trajtohet në nivelin që e kërkon dhe në këtë kuptim unë mbështes fuqimisht sikur atje, edhe këtu, iniciativën e deputetëve të LDD-së.

Tema si është formuar dhe si e kemi ne në diskutim, i ka dy pjesë: një pjesë e ka zbatimin i Kushtetutës, që nënkupton të gjitha veprimtaritë, jo vetëm të pakicave, por kryesisht të shumicës dhe trajtimi i institucioneve të një shteti të huaj në Kosovë. Pse po e them këtë? Duhet t'i sqaroj këto dy probleme. Së pari, zbatimin i Kushtetutës së tillë, që e kemi ne fuqi, i ka dy pjesë: ajo që prek fuqinë ekzekutive të Qeverisë, të Kuvendit dhe të të gjitha organeve që i ka Kosova sot, dhe atë pjesë që është e rezervuar edhe sot e kësaj dite, nga ajo që quhet sot ICO, i cili organizim ka edhe fuqi ekzekutive dhe duhet t'i kemi parasysh të dyja këto probleme kur diskutojmë, qoftë edhe problemin e dytë, të cilin ne e kemi në fokus tash.

Çështja e atyre që janë quajtur me emra të ndryshëm, struktura paralele, dikush i quan struktura kriminale e tjera, e tjera, jo kushtetore e tjera, unë mendoj se nuk janë as struktura normale, as nuk janë struktura paralele, po thjeshtë janë struktura të paguara, të dirigjuara dhe të strukturuar nga pushteti i Serbisë dhe njëherë e përgjithmonë duhet të bëhet ky përkufizim i saktë, në mënyrë që mos të zbresim në figura. Normalisht që një Kushtetutë e Kosovës së pavarur nuk ka çka të bëjë tjetër në zbatimin e vet, veç se të gjejë rrugët dhe mënyrat më të shpejta që këto të shpërbëhen, të depushtetohen. Problemi i veriut sidomos është me histori mbi 10 vjeçare dhe ne sot, në kuptimin historik nuk kemi nevojë t'i gjuajmë fjalë asnjë qeverie, asnjë individi, sepse është njësoj prej fillimi dhe që prej fillimi sa herë shfaqet në Kuvend, shfaqet edhe ajo pjesa ndërkombëtare që nuk ka mbaruar, atëherë, nëse ju kujtohet deputetëve të vjetër këtu, me disa pika të Shtajnerit, sot i kemi disa pika të Piter Feitit. Me një fjalë, ekziston krahu i ashtuquajtur i detyrimit ndërkombëtar dhe krahu i ashtuquajtur i përgjegjësisë politike dhe institucionale të Kosovës. Po them që sot nuk duhet të bisedoj për strategjinë, sepse strategji në kuptimin e zgjidhjes së këtyre problemeve ne në Kuvend nuk kemi pasur. Unë vetë jam interesuar, mua më kanë thënë lexo gazeta. Unë gazeta lexoj, por këtu janë përfaqësuesit legjitim dhe ky është organ ku duhet të bisedohet. Mendoj që duhet të bisedohet patjetër në Kuvend, në nivelin që e kërkojmë në kohën kur atë strategji ta kemi në dorë, duke pasur prapë parasysh që nëse ajo strategji është e ICO-s dhe e Qeverisë, qysh është deklaruar publikisht, ta dini që nuk është veç në fuqinë dhe në mandatin e këtij Kuvendi dhe mos ta luajmë lojën që nuk mund ta luajmë. Prandaj, unë mendoj që sot ne nuk duhet të bisedojmë për atë punë, por sot të bisedojmë për zbatimin e Kushtetutës, natyrisht, në fuqinë përgjegjëse për problemin e caktuar. Këtu unë mendoj që të gjithë deputetët janë të gatshëm dhe të zotët të bisedojnë, në mënyrë që në fund të nxjerrim përfundimin e dobishëm të domosdoshëm për momentin, për Kuvendin dhe për Qeverinë. Ju faleminderit, se nuk dua të më ndërpritet fjala.

Drejtimitin e mbledhjes e merr anëtarin e Kryesisë, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hamiti! Fjalën e merr deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar Qeveri,

Duke u bazuar në fjalën e kryetarit të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, që me aq seriozitet dhe profesionalizëm hapi këtë debat, kisha pasur dëshirë që vërtet të qëndrojmë në këtë pikë të rendit të ditës edhe opozita, por më shumë, të jetë më serioze Qeveria.

Unë nuk mendoj dhe nuk duhet sot të kthehet këtu në replikë dhe kundër replikë kjo temë kaq e ndjeshme dhe kaq e rëndësishme. Tashmë kemi hyrë në vitin e tretë që vendi ynë është shpallur shtet i pavarur dhe sovran dhe është i njohur ndërkombëtarisht nga 65 vende apo shtete të botës demokratike. Por, edhe pas dy viteve pavarësie, shtrohet pyetja – vërtet Kosova a funksion si shtet i pavarur dhe sovran dhe përgjigja është – jo. Kosovës çdo ditë i nëpërkëmbet sovraniteti, Kosova çdo ditë fyhet e poshtërohet nga kushdo që ka këtë dëshirë, sepse institucionet tona nuk kanë aftësi as vullnet që Kosova vërtet të funksionojë si shtet me kushtetutshmëri dhe sovranitet të plotë. Çfarë po ndodhë me Kosovën? Në çerekun e territorit të Kosovës funksionojnë institucionet e Serbisë, të financuara drejtpërdrejt nga Serbia dhe krejtësisht në mënyrë transparente pa i penguar askush apo pa u penguar nga institucionet e vendit.

xx

Kosova nuk i kontrollon kufijtë e vet, Kosova nuk ka qasje në doganat e veriut. Kur flasim për veriun e Kosovës, atje janë emëruar edhe gjykatës dhe prokurorë nga shteti fqinj serb. Atje faturohet energjia elektrike nga shteti serb, atje funksionon post-telekomi i Serbisë, atje hekurudhat i kontrollon Serbia, atje qarkullojnë automjetet dhe regjistrohen me targat e Serbisë, atje janë të pajisur me dokumentet e identifikimit nga Serbia. Në këtë pjesë të Kosovës, shqiptarët dhe pakicat joserbe nuk kanë të drejtë të kthehen në pronat e veta dhe në vendet e punës. Me një fjalë, në këtë pjesë janë të vendosura të gjitha ministritë e shtetit fqinj serb, që nën kontrollin e tyre bëhet kontrabanda dhe krimi i çdo natyre dhe krejtësisht në formën më komode veprojnë duke e dëmtuar çdo ditë shtetin e Kosovës politikisht, ekonomikisht me miliona euro brenda ditës.

Cenimi i sovranitetit më brutal është edhe nga kryetari Tadiq, kryetar i Serbisë. Mënyra e ardhjes së tij në Kosovë, pa i pyetur institucionet e vendit, për popullin shqiptarë është e papranueshme. Ai në mes të Kosovës me përcjellje dhe armatim nga Serbia deklaroi para mediave – jam në Kosovën e Serbisë. Një gjë e tillë nuk është e vërtetë dhe duhet t'i themi dhe duhet të pengohet mënyra e ardhjes së tij dhe e deklarimit të tij.

Vizitat institucionale në mes të dy vendeve të pavarura duhet të jenë reciproke dhe gjithmonë të kushtëzuara. Ju përfaqësues të institucioneve të shtetit të Kosovës – a keni kërkuar ndonjëherë që t'i vizitoni shqiptarët e Preshevës, të Medvegjes dhe të Bujanovicit? Ju përfaqësues të institucioneve të Kosovës – a kërkonin ndonjëherë që shqiptarët e Preshevës, të Medvegjes dhe të Bujanovcit të trajtohen krejtësisht njëjtë si trajtohen serbët në Kosovë. Së paku ne, kurrë nuk e kemi dëgjuar një kërkesë të tillë nga ju.

Ju, me sjelljen tuaj keni filluar të vëni në dëshpërim dhe dyshim mbi 65 vende të botës që e njohën pavarësinë e Kosovës dhe po e ndihmojnë këtë shtet të ri. Kosova ka Kushtetutën më të avancuar në botë për minoritetet që ka, ani pse Kushtetuta është një Kushtetutë e kompromisit të dhimbshëm, që është vërtet në kurrizin e shumicës shqiptare, por ju fatkeqësisht as këtë Kushtetutë nuk keni aftësi as vullnet ta zbatoni.

Ju keni dështuar, fatkeqësisht. Përgjegjësia për dështime politike, ekonomike integruese bien edhe mbi faktorin ndërkombëtar, siç ICO dhe EULEX. ICO dhe EULEX duhet menjëherë t'i marrin përgjegjësitë e veta. Pavarësia e Kosovës nuk mund të vihet në

dysim nga askush. Kosovës nuk mund t'i thuhet se po i ndihmohet në qoftë se nuk i respektohet sovraniteti i saj. Në qoftë se nuk punohet shpejt apo urgjent që në Kosovë të funksionojë ligji, në Kosovë duhet të luftohet krimi, korrupsioni, pastrimi i parasë. Kosova ka nevojë për zhvillim ekonomik urgjent, sepse i ka të gjitha mundësitë dhe të gjitha resurset.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Fatmir Limaj.

FATMIR LIMAJ: I nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të mundohem që fjalën time rreth bisedës për veriun dhe strategjinë ta ndajë në dy pjesë, në dy kapituj. E para, problemi i veriut të Kosovës, si problem kushtetues, dhe pjesa e dytë, si problem integruës, problemi i sigurisë dhe problemi integruës brendapërbrenda territorit të Kosovës. Pse them problemi kushtetues? E thanë edhe parafolësit e mi, për faktin që kemi ndërhyrje, kemi ndërhyrje nga një shtet fqinj, i cili drejtpërdrejt ndërhyr në territorin, sovranitetin e Republikës së Kosovës dhe ky është veprim i organeve të paligjshme të institucioneve tjera të një vendi tjetër, praktikisht nënkupton thyerje të Kushtetutës, dhe besoj që institucionet e këtij vendi, Parlamenti, institucioni tjetër do ta trajtojnë në këtë mënyrë në karshi me komunitetin ndërkombëtar. Duhet të vihet në agjendë dhe karshi komunitetit ndërkombëtar dhe gjëja të lexohet ashtu siç po veprohet dhe të shkohet mesazhi i qartë në drejtim të Serbisë dhe njëkohësisht drejt bashkësisë ndërkombëtare që nuk do të lejohet një shtet fqinjë të bëjë ndërhyrje të tilla.

Në kuptimin e brendshëm integruës, për faktin që ne e kemi, qytetarët e vendit tonë në atë pjesë të Kosovës dhe kjo strategji, për mendimin tim orientohet pikërisht atje, të ndërtohen marrëdhëniet brenda për brenda qytetarëve të vendit tonë, brenda për brenda territorit të Kosovës dhe fokusi ynë duhet të jetë këtu.

Vet programi i strategjisë tregon qartë orientimet se kah duhet të shkohet. Vënia e institucioneve vendore, kushtetutshmëria në atë pjesë, zhvillimi ekonomik dhe social, këto janë çështje të cilat ... sot për sot, mënyra imediate e veriut të Kosovës, me qëllim që qytetarët e vendit tonë të fillojnë të integrohen në jetën institucionale, ekonomike, sociale dhe shoqërore të Kosovës.

Ajo çka dua të them unë, besoj që këtu do të flasim edhe shumë kolegë, është që duhet ta japim një mesazh të qartë. Nuk shkon Kosova, nuk duhet të shkojë Kosova ta marrë veriun. Te ajo krijohet përshtypja që ne po shkojmë ta marrim veriun. Jo, e kundërta duhet të bëhet. Pjesën veriore të Kosovës ta integrojmë në Kosovë dhe kjo duhet të krijohet duke krijuar një distancë, një diferencë ekonomike të fuqishme në pjesën jugore të Kosovës, nga zhvillimi ekonomik e Kosovës, krijimi i lehtësirave për komunën dhe rrethin e Mitrovicës dhe pjesën veriore të Kosovës, do të krijonte parakushte të fuqishme që qytetarët e asaj pjese të Kosovës të shohin perspektivën e zhvillimit ekonomik dhe të ndërtimit të jetës së tyre brenda për brenda territorit të Kosovës. Në qoftë se të gjithë do të angazhohemi për të krijuar një stimulim të tillë, një paketë ekonomike të fuqishme, jam i bindur që njerëzit do të përcaktohen për të jetuar aty ku i kanë interesat e tyre, për t'i integruar në institucionet ekonomike e politike të vendit tonë, por për këtë flet një nga pikat e strategjisë, që besoj do të dalë shumë shpejtë paketa ekonomike e Qeverisë së Kosovës, e mbështetur nga komuniteti ndërkombëtar me fondet që do të caktohen për përmirësimin e jetës së qytetarëve të asaj pjese të Kosovës, që nënkupton jo vetëm pjesën veriore, por edhe pjesën jugore deri në pikën e fundit të kufirit.

Njëkohësisht, instalimi i sistemit shtetëror dhe të organeve shtetërore, duke filluar nga doganat, policia, gjykatat dhe të gjitha ato që u thanë nga parafolësit, do të thotë, tani për tani nuk funksionojnë. Angazhimi ynë permanent për funksionalizimin e institucioneve tona, duhet të jetë një nga çështjet kryesore dhe permanente, por jo të shikohet si diçka e dhunshme, por duhet të jetë diçka permanente, e vazhdueshme, e pandërprerë, që dalëngadalë njerëzit të fillojnë të mësohen të jetojnë. E njëjta gjë ka qenë përpara edhe në pjesën qendrore të Kosovës, por me angazhimin permanent, me qasjen e drejtë, me mesazhin e drejtë të kuptuar, sot problemet në pjesën qendrore po vijnë duke u zgjidhur, kështu që jam i bindur që me një angazhim permanent do të zgjidhen edhe në pjesën veriore. Ajo që dua të them, të nderuar kolegë deputetë, është që ne sot e kemi për detyrë të pasurojmë strategjinë, ta ndihmojmë Qeverinë, t'i ndihmojmë institucionet për të dhënë ide, vizion për të shkuar më tutje. Nuk mendoj se këtu duhet të shfrytëzohet ky fjalim për arena debatesh se kush ka bërë e çka ka bërë dhe njëkohësisht të mos largohet debati nga veriu i Kosovës.

Unë dua të them, për ta mbyllur diskutimin tim dua të them se u përmendën edhe dy-tri projekte tjera të cilat, po flitet – s'po flitet. Edhe një herë dua ta konfirmoj atë që tha kryeministri, ne jemi të gatshëm të flasim për autostradën, të flasim për aeroportin, të flasim për çdo gjë që ju intereson. Nuk ka devijim të trasesë, ka trajtim, jemi të gatshëm ta bisedojmë në Parlament. Ju lutem, mos spekuloni...

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës është deputetja Gjylnaze Syla. Unë ua jep fjalën dhe unë e kam të drejtën t'i klasifikoj diskutuesit sipas subjekteve politike, me Rregullore. Nëse doni, nuk zihet rendi...

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryeministër, qeveri,

Deputetë të nderuar,

Sot po shqyrtojmë një çështje shumë të rëndësishme, siç është çështja e veriut dhe që ka një rëndësi nacionale, por edhe rajonale dhe evropiane. Megjithatë, është dashur Qeveria ta sjellë dokumentin e tërësishëm dhe jo një përmbledhje, në mënyrë që debati të jetë serioz dhe të na bindë se edhe përkushtimi dhe vendosmëria e Qeverisë është serioze. Pse po e them këtë? Sepse sa herë e kam pyetur kryeministrin e Kosovës, ka thënë që nuk ka struktura paralele apo si doni t'i quani strukturat e Serbisë në Kosovë, por ka vetëm disa ekstremistë. Me këtë e ka mohuar ekzistimin e problemit dhe, për më shumë, ballafaqimin e këtij problemi. Por, mohimi apo deklaratat nuk i kanë zhdukur këto struktura.

Po ashtu, dokumenti është dashur të ishte burimor nga vetë Qeveria dhe jo nga faktori ndërkombëtar në Kosovë dhe pronësia të ishte vendore dhe jo të vijmë në pozitën ta hartojnë ndërkombëtarët dhe pastaj ne të jemi mbështetës dhe ndihmës të atij dokumenti. E kemi mirëpritur Strategjinë për veriun, por është e vonuar. Urgjenca rrjedh nga faktet me rëndësi, të cilat do t'i përmbledh në 6:

1. Po afrohet marrja e vendimit nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë;
2. KFOR-i ka zvogëluar trupat;
3. Serbia ka rritur përfshirjen e vet në Kosovë,
4. Status-kuoja nuk mund të lejohet,

5. Nevoja urgjente për t'i mbrojtur qytetarët e veriut të Kosovës nga terrori i grupeve kriminale dhe mungesa e ligjit, dhe
6. Veriu nuk duhet të bëhet pengesë e synimeve tona evropiane dhe euroatlantike.

Nga kjo konkludojmë se politika e riintegritit duhet të jetë proaktive, qasja multilaterale, kurse veprimet e koordinuara mirë.

Megjithatë, kjo strategji ka sfida në zbatimin e saj dhe po i shquaj tri vështirësi kryesore në zbatimin e saj:

E para, është krimi i kushteve për zbatim, sidomos të kushteve të sigurisë dhe të mirëbesimit;

E dyta, përfshirja e gjithë akterëve të involvuar, si vendorë dhe ndërkombëtarë, sidomos të qytetarëve të veriut, konkretisht të serbëve, dhe

E treta, është koordinimi dhe bashkëveprimi në mes mekanizmave vendorë dhe ndërkombëtarë.

Po përqendrohem në krijimin e kushteve të sigurisë. Për të pasur strategjia sukses, së pari duhet larguar ata të cilët e kanë shkaktuar këtë gjendje dhe sidomos elementet e sigurisë së Serbisë. Në këtë aspekt po përmendi pjesëmarrësit e MUP-it, pjesëtarët e MUP-it serb dhe të inteligjencës së Serbisë. Pra, nuk mjaftojnë veprimet të cilat janë bërë deri më tani që të merren në bisedë ekstremistët dhe pastaj me këtë në një mënyrë të lavdërohem se është kryer puna. Gjykatat, gjithashtu, duhet të funksionalizohen. Përgjegjësinë për këtë, natyrisht, e ka edhe bashkësia ndërkombëtare, KFOR-i, NATO dhe Policia e Kosovës për të krijuar një ambient dhe për të mundësuar që qytetarët e Kosovës, sidomos ata serbë, të kenë perspektivën e tyre të kthyer kah Prishtina.

Shpërbërja e strukturave tjera të Serbisë, siç janë ato për shërbimet publike, të ujit, pastaj të energjisë elektrike, të arsimit, të shëndetësisë, është gjithashtu me rëndësi, meqë Serbia po intensifikon ndikimin.

Sa i përket momentit të dytë, të involvimit të akterëve që janë përgjegjës drejtpërdrejt të strategjisë, do të jetë e vështirë në qoftë se nuk ka një trysni diplomatike ndërkombëtare mbi Serbinë për ndaljen e politikës së ndarjes së Kosovës. SHBA, NATO dhe BE duhet të bëjnë presion diplomatik mbi Serbinë që të mos pengojë zbatimin e Strategjisë për veriun, në të kundërtën do të bëhet përgjegjëse për çdo lloj tensionimi apo dhune në kufi apo në Kosovë dhe do të vihet në pikëpyetje perspektiva e saj evropiane.

Serbia përmes veriut shantazhon faktorin ndërkombëtar për faktorizimin e vet politik, prandaj në veri do të bëjë pengesa për zgjerimin e pushtetit të institucioneve të Kosovës dhe të EULEX-it. Pa këtë kusht nuk mund të bëhet promovimi i perspektivës evropiane për qytetarët dhe aq më pak që qytetarët e veriut, sidomos serbët, të marrin ose të vendosin për vetveten.

Sa i përket koordinimit dhe bashkëveprimit në mes të gjithë mekanizmave ndërkombëtarë e vendorë, kjo është kyç për suksesin e strategjisë. Marrja e përgjegjësi veç e veç dhe koordinimi si tërësi duhet të bëhet nga kryeministri, në bashkëpunim me liderët e institucioneve ndërkombëtare në Kosovës. Prandaj, misioni i EULEX-it dhe i KFOR-it nuk do të mohojnë se janë pjesë përbërëse e këtij dokumenti, por duhet të identifikohen

me strategjinë. Që të sigurohemi se me të vërtetë strategjia do të ketë sukses, duhet hartuar plani i veprimit, i cili përbën masat dhe veprimet konkrete, në radhë të parë prioritare, afatet kohore, bartësit e veprimeve dhe monitorimi i nivelit të zbatimit. Sipas bindjes sime, jo deklaratat dhe rezolutat, por planet

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë dëshiroj që edhe një herë t'u bëj ftesë për një bashkëpunim dhe një bashkë angazhim sa i përket implementimit të strategjisë dhe formimit të grupeve punuese. Tjetër, me shqetësim e them se disa zëra që po dëgjohen nga individë të caktuar këtu për realitetin e Kosovës së pavarur, paraqiten më keq sot në Kosovë e pavarur dhe kanë folur për më shumë demokraci për vitet 1990 – 1999. Për më shumë demokraci kanë folur në atë periudhë se sa për rendin demokratik në shtetin e pavarur sot. Dhe kjo është shqetësuese.

Prandaj, dëshiroj të potencoj se nuk është punë këtu tash e tutje se kush do të udhëheq këtë proces. Natyrisht se Qeveria bashkë me bashkësinë ndërkombëtare e ka aprovuar këtë strategji. Nuk dëshiroj që kjo strategji të jetë ajo e cila do të kalojë në një debat në kuptimin e ndërkamcave politike, por të mbështetjes së plotë dhe unifikuese politike e qytetare. U përmend këtu se është strategji e vonuar, mirëpo është strategjia e vetme për integrimin e veriut në këto dhjetë vitet e fundit nga institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare. Prandaj, do t'u kisha ftuar që, sidomos ju në fund atje, individë të caktuar, singërisht të mos luani në kuptimin e patriotizmit, mos luani me emocionet dhe ndjenjat e qytetarëve as të Mitrovicës, as të veriut, në emër të patriotizmit, mos u bëni nervoz, mos u bëni as agresivë dhe nuk keni fare – fare nuk keni nevojë, kur gjërat po i lëvizim bashkërisht institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare, mos u bëni nervoz kur edhe Beogradi është bërë nervoz dhe nuk dëshiroj dhe askush, askush nuk do të dëshironte që tonet e fjalimeve poshtë e lartë të Jeremiqit të dëgjohen këtu.

Keni të drejtë që Qeveria ime duhet të bëjë edhe më tepër për të ushtruar të gjithë autoritetin bashkërisht me bashkësinë ndërkombëtare në veri. Për këtë arsye është edhe strategjia, por dëshiroj të theksoj se ju e dini shumë mirë – a mund të imagjinohej vetëm para një viti, një viti e gjysmë kthimi i shqiptarëve në pronat, shtëpitë dhe banesat e tyre. Dhe kjo po ndodh tani.

Çështja e Mitrovicës nuk është punë vetëm për të shkuar kur është koha e zgjedhjeve, por e përgjegjësisë edhe kombëtare, edhe shtetërore.

E di që ka pasur propozime edhe më herët. E theksoj përsëri për të ushtruar autoritetin qoftë përmes dhunës për 90 ditë, ajo është e patolerueshme nga lideri i juaj, apo dhënia e nga 5.000 euro për një qytetar... Unë nuk kam para as për serbë, as për shqiptarë, as për asnjë nacionalitet tjetër të jepen nga 5.000 euro për një individ të blihet vullneti... në kuptimin - nuk kam para si buxhet i Kosovës, prandaj çështja në veri të Mitrovicës nuk zgjidhet as me dhunë, as me blerjen e vullnetit të tyre. Faleminderit shumë dhe mos u bëni nervoz. Kontrabanda do të ndalet edhe më tepër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë Gjylnaze Sylja, dy minuta.

GJYLNAZE SYLA: Kam të drejtë, se tekstit iu ka referuar. E para, kryeministër, që 2 vjet janë djegur pikat doganore. E dyta, që 2 vjet nuk ke njerëz në gjykata. E treta, nuk është e vërtetë, po e rrenë publikun kur po thua 5.000 euro dhe insinuata tjera, se ia kam dhënë kryetarit të Kuvendit letrën, pse s'po e tregon të vërtetën. E katërta, je i paaftë për ta zgjidhur problemin. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju lutem, zonja deputete, kurseni fjalët dhe mos ofendoni. Nuk është mikrofoni i Parlamentit për të ofenduar askënd, në këtë rast as kryeministrin dhe askënd. Faleminderit! Zoti kryeministër, e ke fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë nuk përmenda as emër, as mbiemër, as deputet me emër. Është çështje e kryesuesit të mbledhjes se a dëshiron të ngjallë debat këtu krejt të panevojshëm apo jo. Por dëshiroj të theksoj se sundim të ligjit do të ketë në veri. Do të ketë implementim të strategjisë, do të ketë luftë të pa kompromis ndaj kontrabandës, prandaj mos u nervozoni. Do të ketë luftë më pa kompromis edhe më tutje. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Naim Rrustemi. Unë në përputhje me Rregulloren ia kam dhënë fjalën për replikë, zotit kryeministër. Faleminderit!

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit! Unë para se të filloj të flas për miratimin apo jo, do të ndalem në përdorimin e termit i cili është përdorur edhe në Strategjinë për veriun e Kosovës. Kërkoj që të bëhet e qartë edhe për popullin e Kosovës se ku i bie ky veriu. Ku është kufiri. Pra ku fillon veriu i Kosovës. Vetë fjala veri tregon tendencën – disa prej bartësve të krimit të organizuar se është një punë e kryer edhe ndarja e Kosovës.

Kosova është një dhe nuk mund të ndahet. Ky është qëndrimi i aleatëve që larguan regjimin serb nga Kosova, edhe pse unë po u besoj dhe as që kanë nevojë që ta përsërisin atë shpesh, sepse me të vërtetë i besoj qëndrimit të tyre.

Organizatorët e krimit të organizuar janë ata që po kontribuojnë që ndarja e një pjese të Kosovës, që Qeveria me zell e quan veriu i Kosovës, janë ata që unë i quaj fajtorë kryesorë që po tentojnë ta sjellin një situatë ku komuniteti serb të ndihet se nuk është pjesë e Kosovës, të ndihet se ata kanë një kufi, pra kanë veriun e Kosovës, kanë krijimin e një entiteti, pra, veriu i Kosovës.

Duhet të qartësohet se kush janë bartësit e krimit, se ata janë dora e zgjatur e Serbisë në Kosovë. Pra, nuk ka nevojë që Serbia të paguajë njerëz dhe logjistikë, sepse me këta persona që kanë lidhje apo janë njerëz vendimmarrës në politikën e Kosovës, i kryejnë të gjitha manovrimet që i duhen që Kosova të paraqitet si oazë e krimit dhe e korrupsionit. Pra, kujt i ka interesuar që të mbajë gjendjen e tillë?

Nën një, i ka interesuar Serbisë dhe argatëve të saj në Kosovë, politikës zyrtare e Serbisë që të mbajë gjendjen kaotike dhe të vazhdojë me politikën e vet zyrtare.

Dhe, nën dy, krimit të organizuar, që realisht po del se është dorë e zgjatur e Serbisë.

Në kuadër të kësaj mund të themi se të gjithë ata që marrin veprime, që çojnë drejt mos funksionalizimit të institucioneve në tërë territorin e Kosovës, realisht janë dorë e zgjatur e Serbisë.

Rasti më i freskët është rasti i futjes së EPS-së në sektorin energjetik, por as kjo nuk është befasuese, sepse ne e blejmë rrymën nga kompanitë serbe të pa licencuara në Kosovë, pra ne vetëm sa po bëjmë pazare dhe po krijojmë situatën e faktit të kryer. Shumë pikëpyetje dhe me çmim do ta paguajmë vendosjen e një pjese të Kosovës në sistemin elektro-energjetik të Kosovës. Po të vazhdojmë me këtë logjikë, por edhe nëse i pyesim disa politik bërës, ata do ta vendosnin kufirin e Kosovës deri në Shipol, një fshat i Mitrovicës, ndoshta për shumë njerëz edhe i panjohur, por për ata që kanë qenë në politikë në qershor të vitit 1999, por edhe ndoshta në vitin 2003 dhe 2004 e dinë se nuk po flasim kot, por po ua projektojmë dëshirat dhe veprimet me të cilat janë të njohur dhe ndoshta edhe kanë punuar që një gjë e tillë edhe të ndodhë.

Kohët e fundit po paraqitet një situatë sikur Kosova është e atakuar prej njerëzve që potencialisht mund të jenë argatë të politikës serbe. Si një qytetar i Kosovës shumë lehtë mund ta kuptoj se Serbia përpaket të jetë prezent në krijimin e politikave në Kosovë. Normalisht, përderisa Serbia deklaron se kurrë nuk do ta pranojë pavarësinë e Kosovës, atëherë është e vetëkuptueshme se pandërprerë punon që të rrënohet gjithçka çka mund të jetë pozitive dhe progresive. Dhe, njëkohësisht të punojë deri në atë masë sa edhe të krijojë përçarje në mes politikës dhe politikanëve të Kosovës dhe komunitetit ndërkombëtar, që është vendimmarrës në shumë prej proceseve më të rëndësishme politike për të ardhmen e Kosovës.

Çështja që duhet pasur parasysh është – pse EULEX-i toleron krimin e organizuar, kur në detyrat e punës së EULEX-it është që të sigurojë që krimi i organizuar duhet të luftohet, sepse problemi në komunat problematike dhe integrimi i serbëve në institucionet e Kosovës, bëhet vetëm nëse fitohet lufta kundër krimit të organizuar, si në anën e komunitetit serb, ashtu edhe në anën e atij shqiptar. Pra, duhet që EULEX-i të mos portretizohet si organizatë që bën pazar në mes të sigurisë dhe lejimit të korrupsionit. Kush ka mundësi që të jetë faktor për ta futur korrupsionin në pazar, në sigurinë e Kosovës dhe të krijojnë pasuri në emër të sigurisë së Kosovës? Kushdo që mendon se me këtë formë pazari në mes mësheljes sysh dhe korrupsionit dhe kërcënimit ndaj stabilitetit, i kontribuon stabilitetit, gabon shumë rënd. Askush dhe asnjë grup nuk është adresë që mund të bëjë pazare. Kjo praktikë duhet të ndalet me veprime konkrete që mos të ushqejmë idenë se investimi në faktorë kërcënues ndaj sigurisë mund të jetë shumë fitimprurës, sot bën pazare me disa, nesër me të tjerë. Pra, toleranca ndaj korrupsionit është investim në destabilitet dhe paraqet kërcënim për sigurinë e Kosovës

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Branislav Gërbiq. A është këtu? Paska dal. Deputeti Zemaj, s'është. Deputetja Sanije Aliaj, a është këtu? Luteni që t'i përmbaheni kohës në mënyrë proporcionale.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Kërkesa për debat për moszbatimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, mos shtrirja e institucioneve të Kosovës në tërë territorin e saj për zbatimin e ligjeve të miratuara në Kuvendin e Kosovës, ka qenë dhe është çështje fundamentale për institucionet e Kosovës, që në atë pjesë të vendit të funksionojnë institucionet dhe jeta normale. Këtë gjendje të krijuar në veri të vendit e konsideroj si të imponuar nga të tjerët dhe jashtë vullnetit tonë, prandaj pas këtij debati që nuk është i pari, konsideroj se duhet të nxjerrim një dokument, që së bashku me strategjinë për veriuin e Kosovës, t'i obligojmë institucionet e Kosovës, që me përkrahjen e ndërkombëtarëve për të filluar bisedimet si

dy shtete të barabarta në të gjitha fushat me ekspertë për të biseduar, për të bërë marrëveshje për çështjet praktike. Qysh në fillim do të konstatoja se në bisedime përjashtohen bisedat për statusin e Kosovës. Vlerësoj se bisedimet duhet të fokusohen në këto fusha: lëvizjen e lirë të mallrave dhe të njerëzve, kodin telefonik, funksionalizimin e hekurudhave, për energjinë, për integrimin e komunitetit serb në institucionet e Kosovës, përmes procesit demokratik zgjedhor dhe procesit të decentralizimit të pushtetit. Pas shpalljes së pavarësisë, strukturat serbe janë radikalizuar dhe për agjendë kanë gjashtë pikëshin edhe në diplomacinë e jashtme. Kam përshtypje se ata e kuptojnë realitetin tonë si shtet i pavarur, por në anën tjetër propagandojnë se nëse shteti i Kosovës është realitet edhe pushteti ynë në këtë pjesë është realitet. Si kundërveprim deri më tani institucionet e Kosovës kanë nxjerrë dy rezoluta, kanë ofruar katër pikëshin, si kundërpërgjigje të gjashtë pikëshit dhe tani strategjinë për veriu – për Kosovën, të hartuar nga Qeveria e Kosovës dhe Zyra Civile Ndërkombëtare, si dhe dokumentit që do ta miratojmë pas këtij debati, obligon Qeverinë për të nxjerrë një plan veprimi për zbatimin e këtyre dokumenteve duke caktuar afate dhe mekanizmat për sanimin e gjendjes.

Ne të gjithë e kemi të qartë se strukturat legale në veri të vendit janë të rrezikshme për stabilitetin e vendit dhe realizimin e projekteve strategjike, kërkon kohë dhe përkushtim serioz, por me këtë rast mbështetja e KFOR-it dhe EULEX-it, me fuqinë e tyre ekzekutive, me kompetencat dhe instrumentet që kanë, ndihmojnë në sanimin e gjendjes duke na përkrahur, që Forca e Sigurisë së Kosovës, të jetë funksionale dhe efektive në atë pjesë të vendit, që Policia e Kosovës të ketë një uniformë dhe një sistem komandues, që Qeveria e Kosovës me kompetencat e veta të ndihmojë: zhvillimin ekonomik, sistemin e arsimit, funksionimin e rendit dhe ligjit dhe zhvillimin e proceseve demokratike, që të ndërtohen marrëdhëniet në mes qytetarëve të Kosovës, duke i ndihmuar qytetarëve serbë të integrohen dhe duke u bërë të ditur paraprakisht se e ardhmja e tyre është në Kosovë.

Qeveria e Kosovës duhet të bëjë një marrëveshje me EULEX-in për ta mbikëqyrur sa EULEX-i ushtron pushtetin ekzekutiv në zbatimin e ligjit, sa i bën funksionale gjykatat, sa e vënë kontrollin në doganat, në polici dhe zona të mbrojtura. Këto veprime të propozuara dhe dokumente të propozuara, pas këtij debati, do të jenë një nismë e mirë për ushtrimin e pushtetit në tërë tërësinë territoriale të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zoti Kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Unë nuk do të dua që edhe më shumë të konstatoj për pasojat dhe dëmet që po shkakton ekzistimi dhe funksionimi i strukturave të shtetit të Serbisë brenda territorit të shtetit të Kosovës, sepse këtu në mënyrë shumë të argumentuar nga shumë parafolës u konstatua kjo gjendje dhe natyrisht konstatimi nuk mjafton. Natyrisht, diagnostifikimi nuk nënkupton edhe shërimin, por diagnostifikimi nënkupton rrugën kah të ecet për ta shëruar dhe ne jemi pikërisht në këtë pikë tani. Unë do t'i shtoj edhe një dimension këtij konstatimi, sepse rrugët nuk po i dimë mirë askush se si do të ecet dhe natyrisht rrugëtimi për të zgjidhur këto probleme, pashmangshëm duhet të jetë i përbashkët sikurse edhe ka qenë rrugëtimi për krijimin e shtetit të Kosovës, i përbashkët me miqtë ndërkombëtarë. Por unë do të ndalem te konsekuencat që po prodhon ekzistimi dhe funksionimi i strukturave paralele në territorin e Kosovës, pra të shtetit të Serbisë, në krijimin e një imazhi për shtetin e ri të Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe për pasojë ose rrjedhimisht konsekuencat që po i prodhon në procesin e sigurimit të njohjeve të reja për

shtetin e Kosovës. Ne kemi plot një vit, pra vitin e kaluar, që kemi numëruar shumë pak njohje të reja. Ka qenë grupi i parë i shteteve që e kanë njohur Kosovën, që kanë qenë në një farë mënyre edhe sponzorizues edhe mbështetës të këtij procesi fuqimisht dhe pastaj kemi një ngecje të shtetet tjera, shtetet që kanë qenë më larg këtij procesi të cilat hezitojnë edhe më tutje për ta njohur shtetin e Kosovës edhe për shkak të funksionimit të strukturave paralele të shtetit të Serbisë në shtetin e Kosovës. Unë dua këtu veç t'i nënvizoj impresionet që unë i kam krijuar në disa dalje jashtë shtetit dhe disa kontakte me miq, me studiues të rajonit të Ballkanit dhe të Kosovës në universitetet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ka studiues atje që kanë ardhur dhe e kanë vizituar Kosovën, më se 7 herë prej vitit 2000 e këtej dhe e kanë krijuar impresionon në observimet e tyre dhe pastaj në shkrimet e tyre kanë dalë me opinione se çështja nuk është aq e thjeshtë, çështja nuk është lehtë e zgjidhshme dhe se duhet të gjendet një zgjidhje për çështjen serbe, përkatësisht do të duhej të gjendet një zgjidhje për veriun e Kosovës. Dhe, pak nga pak bashkohem edhe me parafolësin që tha terminologjia-veri e Kosovës, na çon në drejtim të asaj se veriu është një çështje e pazgjidhur për të cilën duhet menduar rishtas si ta zgjidhim. Kjo koinçidon edhe me nismat e Serbisë që i kemi tash për diskutimet, kërkesën për dialog, për diskutimet lidhur me zgjidhjen e problemit të Kosovës. Dhe, tash ne po themi se s'ka debat për statusin, por debati për veriun të çon të mendosh se do të jetë edhe debat për statusin. Prandaj, strategjia vjen në një kohë, zoti Kryeministër, s'është këtu, por e ka lancuar dhe vjen në një kohë të duhur, por strategjisë, aktualisht po i mungojnë shumë elemente. Po i mungon plani i veprimit, po i mungojnë aktivitetet dhe bartësit, po i mungon kostoja dhe nëse strategjia ka marrë një mbështetje nga grupi ndërkombëtar para disa ditësh në Vjenë, për Grupin Ndërkombëtar për Kosovën, unë konsideroj se është një momentum i mirë që duhet shfrytëzuar për të shpejtuar edhe me këto elemente që duhet t'i ketë strategjia për t'u bërë e implementuar. Pra, ky debat i sotëm do të jetë në funksion të krijimit të parakushteve për implementimin e kësaj strategjie, sepse në të kundërtën, Parlamenti s'mundet ndryshe të involvohet në zgjidhjen e veriut, por mundet ta komplementojë strategjinë dhe të kërkojë implementimin e saj. Dhe, ajo që kërkohet, pa dashur për ta akuzuar pse s'është bërë më shumë dhe a do të bëhet më shumë për ta vu në pikëpyetje, sepse ne e dimë që çështja është shumë komplekse dhe të kërkojë llogari prej dikujt pse s'është bërë dhe garanci se a do të bëhet më shumë, pa e përfshirë edhe veten, pjesë të kësaj çështjeje kaq komplekse, nuk është shumë korrekte. Por, çka duhet bërë Qeveria në këtë rast? Nëse hapi i parë i implementimit të strategjisë për veriun janë organizimi i zgjedhjeve në komunat veriore dhe krijimi i një legjitimiteti horizontal dhe vertikal të shtetit në atë pjesë dhe nxjerrjen e strukturave legale dhe legjitime që e njohin shtetin e Kosovës, por që mbrojnë interesat e komunitetit, që është e natyrshme atje, këtu duhet provuar si t' i krijojmë më ato përgatitje? Ne i kemi bërë thirrje prej vitit 2000 komunitetit serb në veri që të marrë pjesë në zgjedhjet e shtetit të Kosovës dhe ata s'kanë parë interes të marrin pjesë në këto zgjedhje dhe tash jemi

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč! Pozdravljam sve kolege poslanike, istovremeno Vladu i predsednika.

Danas imamo jako opipljivu temu koja definiše strategiju za sever Kosova, za severnu Mitrovicu, tako da kažemo. Jedino danas što me jako brine, debata je inicirana od strane Grupe LDD, pa danas pred sobom imamo isto pojam debate i pojam rezolucije za usvajanje, a istovremeno imamo i strategiju Vlade koja nije niti u tačci, niti na dnevnom

redu, ili ja mogu da kažem da se radi danas o dva dokumenta, jako važna dokumenta! Jedno što me zabrinjava, mi svi znamo kao poslanici, ja kao žena mogu da kažem da je ustav pravosnažan i da je ustav temelj jedne države. Ali kakvu kuću mi gradimo? Da li u toj kući hoće da žive svi? To treba da nas zabrinjava. Da li smo mi kao Vlada i kao poslanici, kao Skupština za 10 godina bili prisutni u svim poljima prepoznatljivi da se svakome živi sa nama. Ja moram ovo da kažem zato što se u severnoj Mitrovici, ja se puno danas ne brinem za srpsku zajednicu, ali me brine svoja zajednica – Goranska zajednica koja živi tamo i Bošnjačka zajednica, gde je gospodin Numan Balić znao dobro da drži predavanje i sve drugo, i gospodin Đezair Murati, tamo žive naše zajednice u tom delu. Ja pitam: zašto su te zajednice i dalje pod srpskim kišoborom? Da li zbog ekonomskih razloga, da li zbog boljeg uslova života i standarda, što je tačno, i isti problem standarda boljeg života, ekonomskih uslova ima i većinska zajednica. Nas treba da nas zabrinjava i zadnja migracija mladih sa Kosova. Zašto se zloupotrebljavaju biometrijski pasoši, da li ti isti mladi ljudi kada idu u inostranstvo pred vladama međunarodne zajednice i međunarodnih država pričaju o nama sve najbolje. Mi smo deset godine imali da smo svake godine, ja ne kažem Vlada, svi mi, da smo svake godine pravili po jedan pozitivan korak, danas bi mi bili država iz svih regija gde bi se slivali ljudi na Kosovu. Zašto ovo kažem? Mi moramo jako dobro da radimo sa statistikama. Ja bih se zadržala na jedan deo rezolucije koju imam danas pred sobom, zato što imamo jako malo vremena, gde se kaže da će biti korišćeno od strane međunarodne zajednice, EULEX-a i Vlade svi vidovi, svi vidovi za integraciju na Kosovu. Mi hoćemo da znamo koji su to, da li su politički vidovi, kakvi vidovi, kakva će situacija tamo biti i kako će biti obezbeđenje i ostalo za sve zajednice koje tamo žive.

Ako kažemo da jedna zajednica, ja kažem zašto Bošnjačka zajednica sedi pod srpskim kišoborom, uči na srpskom jeziku, prima srpske plate i srpske penzije, zašto naša Goranska zajednica isto to... Zašto ne dođe na šemu Kosova od 120 evra, zašto je to. Znači, ekonomska situacija mora da nas zabrine. Ova Vlada ne treba da žuri. Mi isto kao poslanici treba da napravimo dobru strategiju razvoja Kosova, sa razvojnim budžetom, sa ekonomijom, sa parametrima, sa policijom, sa svim parametrima gde ćemo biti primer barem gde ćemo kao pokazatelji da se pokrenemo u nacionalnom dohotku. Ja sam imala priliku da je bilo postavljeno pitanje ovde od strane radnika zdravstva, da su tražili plate u regiji, i žalosno je bilo da je gospodin ministar samo analizirao plate Albanije. Albanija nije regija, regija je Slovenija, Hrvatska, Bosna i Hercegovina. Regija je ona sofra na kojoj smo bili. Mi moramo da budemo hrabri i da kažemo gde grešimo, šta radimo. Zašto je naša socijalna šema tako mala, zašto je ovo sve tako.

Ja ću jedno da kažem. Gospodin premijer je danas rekao da ne smemo ovo da koristimo kao marketing i kao propagandu. Danas Kosovo je platilo 6 miliona firmi Sachi&Sachi da nas reklamira. Molim vas...

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit zotëri kryesues!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni t'ua përkujtoj në mënyrë integrale nenin 2.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku thuhet shprehimisht se sovraniteti dhe integriteti territorial i vendit është i pacenueshëm, është i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj. Dhe, ne sot, me keqardhje mund të themi se ky nen themeltar i Kushtetutës së Republikës së Kosovës nuk zbatohet. U thanë nga të gjithë parafolësit, po ajo çka është esenciale të theksohet se Republika e Serbisë nëpërmjet

mekanizmave të vet ka futur në veprim vijën vertikale të ndikimit në gjyqësi, arsim, shëndetësi, administratë, në degët e ekonomisë dhe me një fjalë në të gjitha segmentet që ky shtet i posedon. Dhe, sot e kësaj dite, atë çka e thanë edhe para folësit, kemi të bëjmë me 4 stacione të policisë të cilat nuk përfillin zinxhirin komandues dhe po ashtu, Policia e Kosovës në pikat doganore 1 dhe 31 u përgjigjet vetëm zyrtarëve të EULEX-it dhe jo sistemit komandues të Policisë së Kosovës. Situata duket edhe më e ndërlikuar kur kemi parasysh strukturat paralele serbe të sigurisë të cilat veprojnë në territorin e Kosovës. Për strukturat paralele serbe të sigurisë kanë folur të gjithë, përjashtojnë institucionet e vendit. Madje edhe vetë zyrtarët e Serbisë e kanë pranuar një fakt të tillë. Unë po e përmend vetëm raportin e OSBE-së për strukturat paralele në Kosovë në vitin 2006 – 2007, ku në mënyrë eksplicite flet se veprimet në veri të Kosovës, nxiten, sponsorizohen, organizohen dhe kryhen nga ekstremistët, militantët, zyrtarët, qeveritarë nga Beogradi.

Të nderuar deputetë,

Tash e sa vjet na është thënë se kjo është çështje politike dhe nuk është çështje as ushtarake as administrative, por as juridike. Kjo parullë, zotërinj deputetë, është servuar në sy të opinionit publik para qytetarëve të vendit vetëm për të larguar vëmendjen dhe për të fshehur paaftësinë qeverisëse të kësaj garniture, sepse në thelb kjo nuk ka asnjë çështje politike e cila qëndron mbi Kushtetutën e vendit, mbi rendin dhe mbi ligjet. Të gjitha shtetet të cilat e kanë njohur Kosovën, shtetet e mëdha dhe të vogla, të fuqishme dhe më pak të fuqishme e kanë njohur Kosovën pa kushte. E kanë njohur si shtet të pavarur me këtë Kushtetutë që kemi sot, me këtë rend ligjor dhe me të gjitha obligimet që dalin nga pakoja e Ahtisarit e që ne jemi zotuar se do t'i zbatojmë. Nuk ka asnjë shtet që na ka njohur deri më tash dhe na ka thënë se ne po ju njohim, por ju nuk guxonit të respektoni pikën – nenin 2 të Kushtetutës së Republikës së vendit. Ka dy vjet pas pavarësisë që institucionet tona thirren në rezultate dhe ka dy vjet në Kosovën e pavarur që qytetarëve të saj asnjëherë nuk u është dhënë përgjigja lidhur me zbatimin dhe respektimin e Kushtetutës. Por kemi edhe dy vjet në Kosovën e pavarur që asnjëherë nuk është marrë ndonjë qëndrim, ndonjë iniciativë me hapa konkret në zbatimin dhe respektimin e Kushtetutës.

Më duhet të them se institucionet tona, Presidenti, qeverisja në të gjitha nivelet, por edhe Parlamenti, ka dy vjet që vazhdojnë të mbeten nën logjikën e veprimeve edhe më të ulëta se sa që kishim në kohën e protektoratit ndërkombëtar.

Zotërinj deputetë,

Zoti Kouchner, gjatë vizitës së tij në Kosovë e përmendi një fakt: rreziku për pavarësinë e Kosovës nuk vjen nga jashtë, ai vjen nga brenda, nga korrupsioni. Dhe, unë s'kam se si të mos pajtohem me një konstatim të tillë, por e vërteta është se Kosovën po e gërryen korrupsioni, kanceri i quajtur, krimi i organizuar, sepse kufijtë e Kosovës nuk kontrollohen në tërësi, sepse kemi një qeverisje që më shumë shqetësohet për performanca televizive se sa për problemin e respektimit të rendit dhe ligjit. Në raportin e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit, botuar para 3 ditëve, Kosovën e rangon në vend- lider për transit të drogës dhe rruga e këtij qarkullimi të drogës arrin deri në Afganistan. Pra, rrjeti kontrabandues që kalon nëpër Kosovë i ka rrënjët deri në Afganistan. Kjo është fuqia e kontrabandës që shtohet dita-ditës, për deri sa ne kemi një gjendje të tillë. Në këtë raport thuhet decidivisht se çështja e kontrabandimit ende nuk është vënë në listën e prioritetëve të kësaj qeverie dhe se

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Kaqusha Jashari.

KAQUSHA JASHARI: Faleminderit! Pas shpalljes së pavarësisë dhe aprovimit të Kushtetutës dhe angazhimit tonë për pranimin e Kosovës si shtet, mendoj se është rendi dhe mirë që diskutohet për funksionimin e shtetit brenda kufijve. Prandaj, për mua obligim numër një është ky që a jemi në gjendje t'i bëjmë institucionet lokale në tërë territorin, prandaj a janë institucionet lokale të lidhura me vertikalen, me Qeverinë dhe me institucionet, me Kuvendin, prandaj në këtë drejtim mendoj se duhet të diskutohet. Unë nuk jam prej atyre që mendojnë se duhet vazhduar me diskutimin si zhurmashinj dhe për ta shprehur një patriotizëm verbal, por është një kohë për veprime konkrete dhe në këtë drejtim do t'i them disa fjalë.

Nuk e vlerësoj gjithashtu që është situata alarmante, pa marrë parasysh se në Mitrovicë ende kemi veprime të cilat janë shumë negative, por duhet të vlerësojmë a është klima për të vepruar më e volitshme se më përpara, më e volitshme shumë pas shpalljes së pavarësisë e shumë e keqe ka qenë para pavarësisë dhe kjo le të jetë për analizën pse s'kemi mund të bëjmë më shumë dhe aty me bë aq sa duhet? Pse po vlerësoj se është situata më e volitshme? Ne duhet t'i inkurajojmë pak edhe njerëzit e Mitrovicës të cilët nuk banojnë në shtëpinë e tyre, sepse është realiteti i ri dhe e kemi pranimin e realitetit të ri të shtetit tonë të Kosovës edhe nga të gjithë qytetarëve tjerë, jo vetëm nga shqiptarët. Prandaj, shtrirja institucionale e pushtetit lokal është bërë shumë më shumë se më përpara, janë zvogëluar veprimi, mundësitë e veprimit të strukturave paralele. Atë dua të them, por unë mendoj se është rendi, unë e them se ka qenë edhe veprimi shumë parimor, edhe i disa partive serbe që kanë pas guxim të hynë në kojë në zgjedhjet lokale se duhet ta dimë se ata edhe kanë presion edhe do të kenë presionin nga Beogradi edhe më tutje, po me siguri kanë menduar më shumë për qytetarët e vet, kanë menduar më shumë për zgjedhjen e problemeve lokale dhe në këtë drejtim unë mendoj se duhet të përhëndeten.

Gjithashtu mendoj se është situata më e volitshme edhe për shkak, jo vetëm deklaratave, - por edhe veprimeve të përbashkëta të Qeverisë, EULEX-it dhe ICO-s dhe mendoj se është për ta përhëndetur, unë këtu po them në emër të socialdemokratëve, këtë strategjinë e Qeverisë për Mitrovicën. Edhe unë po i iku fjalës veriut, sepse Mitrovica është në tërësi problem si në veri si në jug, se duhet të sigurohet qarkullimi i lirë. Prandaj, strategjia e cila nuk e di a është definitive apo jo, a është drafti, po me siguri këto katër orientime, prioritetet të cilat janë në këtë strategji, janë shumë të rëndësishme? Për sundimin e ligjit ne e kemi problem në tërësi në Kosovë, por qarkullimi i lirë, lëvizja e lirë e qytetarëve është prioritet, prandaj edhe përkrahim. Gjithashtu me decentralizimin, sidomos me organizimin e zgjedhjeve të lira lokale dhe formimin e institucioneve tona legjitime, gjithashtu mendojmë se është shumë e rëndësishme edhe vija vertikale, angazhimi i tyre dhe ligjshmëria e Qeverisë me komunat, në këto tri komuna.

Sa për zhvillimin ekonomik dhe kujdesjes sociale e cila është një prej katër prioritetet në strategji, mendoj se do të ketë probleme shumë serioze, sepse problemi i zhvillimit është në tërë territorin e Kosovës, por institucionet paralele dhe institucionet në Mitrovicë e tjera, të arsimit dhe struktura tjera, kanë qenë të financuara nga Beogradi, prandaj një pranim të gjendjes më të rëndë në veprimin tonë institucional do të ketë problem.

Edhe në fund, unë mendoj se strategjia...

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Branislav Gërbiq.

BRANISLAV GRBIĆ: Ja se zahvaljujem predsedavajući na datu reč!
Uvaženi zameniče premijera,

Ministri,

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Želeo bih da uzmem diskusiju u ovoj jako bitnoj stvari koja mislim da opterećuje kosovsku javnost i smatram da je od bitnog interesa i značaja za dalji razvoj kosovskog društva i jednostavno integracioni proces koji građani Kosova žele da ostvare na svojoj teritoriji, odnosno kroz jedan zajednički život koji smatram da je jedini model daljeg sprovođenja integracionog procesa kako unutar Kosova, tako i van Kosova. I ono što želim da istaknem to je da Mitrovica kao jedan od problema Kosova sigurno da je problem, međutim nije sada da ono znate kao pao šećer u vodi i moramo da ga rešimo preko noći sa izvesnim posledicama. Ovaj proces zaista zahteva jednu sveobuhvatnu analizu u kojoj mislim da je od velike važnosti i prvenstveno možda i vodeća uloga međunarodne zajednice u tom procesu rešavanja celokupnog prostora Kosova. I ono što tu smatram da je jako bitno da taj odnos između albanske zajednice i srpske zajednice ne preuzme neku ulogu koja neće biti adekvatna i u onom smislu opterećujuća za predstavnike zajednica na Kosovu u tom smislu jer ipak želimo da gradimo jedan pomirujući proces koji zahteva vreme i koji zahteva poverenje.

Ono što smo možda u ovom periodu, deset godina propustili i ono što sigurno možda nije lična odgovornost svih nas, ali kao neku objektivnu odgovornost želimo da prihvatimo to je da želimo da stvorimo to poverenje na račun onoga što želim da istaknem, a to je da stvaranje i promovisanje kadrova, znači kvalifikovanih ljudi, kako većinske albanske zajednice, tako i manjinske zajednice, uključujući i srpsku zajednicu. To je znači ono poverenje koje Vlada Kosova treba da gradi i da takve ljude pronalazi i da forsira takve ljude koji će omogućiti što lakši pristup u svojoj zajednici i što bezbolnije jedan integracioni proces koji će dati mir na Kosovu.

U tom svojstvu sigurno da i ova strategija i deklaracija koja je preuzeto od strane Skupštine ide u tom kontekstu jednog međunacionalnog pomirenja i stvaranja uslova za razvoj Kosova na celoj svojoj teritoriji. Sigurno da je Mitrovica kao takva tema daleko ozbiljnija jer radi se o jednom području koje je imalo znači neku svoju vlast, znači imalo je neki svoj život koji je bio van integracionih procesa Kosova i ono što želim da istaknem to je da podrška EULEX-a, podrška Američke ambasade, podrška svih međunarodnih faktora je jako bitna u ovom procesu.

Mi ćemo kao predstavnici srpske zajednice sigurno imati volje i želje da se uključimo u ovaj proces jer on se prvenstveno odnosi na rešavanje znači pitanja većinskog dela srpskog stanovništva u opštinama koje pripadaju severnom delu Kosova i kao takve želimo da damo doprinos da taj proces se zaokruži i da ima rezultata znači i da u budućem procesu svi građani Kosova budu podjednako tretirani i da podjednako znači imaju, uzmu učešća u razvojni i životni proces Kosova. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Gjithë opinionit i brendshëm në vazhdimësi ka kërkuar që të merren masa sa më të shpejta që në pjesët e Kosovës ku ende nuk sundon rendi dhe ligji që të bëhet kjo. Dy vjet pas pavarësisë së Kosovës, një afat relativisht i shkurtër, është përpiluar një strategji e cila sot na ka ofruar për mbështetje dhe këtë mbështetje sot po e japin të gjitha grupet parlamentare, të gjithë deputetët. Edhe unë si përfaqësues i Partisë Socialiste të Kosovës

e mbështes plotësisht dhe kërkojmë që sa më shpejt të zbatohet kjo. Është shumë e qartë, është për t'u gëzuar që ka ardhur sot në rend të punës kjo çështje, sepse zakonisht kur në Kuvendin e Kosovës vjen një çështje, ajo vetëkuptohet se qysh më parë është e planifikuar, e rregulluar dhe vjen për t'u kryer një punë që faktikisht është në kryerje e sipër. Domethënë, së paku në bazë të eksperiencës së deritashme si deputet, kjo është.

Ajo çka mendoj se presin të gjithë qytetarët e Kosovës dhe ne si parti politike, si deputetë është që nga kjo strategji të gjithë qytetarët e Kosovës që jetojnë në ato pjesë që ende nuk janë të integruara, të ndihen më mirë se sa që njihen sot si të gjithë qytetarët e tjerë që janë në pjesë tjera. Kjo një.

E dyta, mendoj se nga kjo strategji do të presim të gjithë që strukturat kriminale të zvogëlohen dhe të ndiqen e të zhduken, në ato pjesë ku janë shfaqur në veri dhe pjesë tjera dhe mendoj se bashkë me ato struktura, sigurisht nuk duhet të na dhimben edhe filialet e tyre që shesin mall kontrabandë nëpër pjesë tjera të Kosovës edhe këtu në Prishtinë.

Krejt në fund, unë si deputet do të përshëndes atë pjesë të komunitetit serb të Kosovës dhe ky është në rritje që është integruar në shtetin e Kosovës dhe po punon për një të ardhme më të mirë për komunitetin e vet. Në këtë drejtim rol të madh kanë luajtur partitë politike dhe deputetët në Kuvendin e Kosovës, të asambleve komunale dhe ministrat e zyrtarët e komunitetit serb të Kosovës, që u pa edhe sot këtu dhe më herët. Duhet të dimë se çështja e integritetit të asaj pakicës serbe që ende nuk ka pranuar realitetin e ri, çështja e sundimit të ligjit nuk është çështje e jashtme e Kosovës, këto janë çështje tona të brendshme për të cilat ne jemi përgjegjës dhe duhet të punohet me kujdes dhe përkushtim dhe ndjesi më të madhe. Ka kaluar koha që për çështje të brendshme të bëhet përgjegjës në vazhdimësi dikush nga jashtë ose ish- okupatori, Serbia. Pavarësisht se ajo i mban ato struktura, ne jemi përgjegjës që ato të mos funksionojnë më. Është fat i madh që për synimin tonë për të dhënë rend dhe ligj në gjithë territorin e Kosovës kemi mirëkuptim nga gjithë miqtë e Kosovës jashtë vendit dhe institucionet ndërkombëtare. Dhe, është detyrë që ata jo vetëm të jenë në rrjedhë të plotë të asaj çka po ndodh dhe çka do të ndodhë? Politika e jashtme e Kosovës është identifikuar si politikë paqësore, e fqinjësisë së mirë, e bashkëpunimit. Me sjelljet e veta Serbia është identifikuar si një shtet që po i pengon nismat rajonale, pjesëmarrja e barabartë e shteteve në aktivitete dhe po përzihet në punë të brendshme të shtetit tonë e besa edhe të shteteve tjera deri në aktet e veprimtarisë ilegjitime dhe agresive.

Këtu, me gjithë vështirësitë e mëdha që po përjeton Kosova nga këto ndërhyrje është e qartë se pretendimet e Serbisë në Kosovë...

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ali Lajçi.

ALI LAJÇI: I nderuar kryesues,
Ministra dhe deputetë kolegë,

Është një temë mjaft e rëndësishme dhe një akumulim mund të themi historik i saj, të cilës po duam t'i qasemi bash rrastë, kështu a në kuptim juridik e politik, do të duhej të nxjerrën shumë përbërës, faktorë e tjerë e tjerë që unë besoj se nuk do të kemi kohë për atë krejt. Objektivi i këtij diskutimi do të duhej të ishte – çka mund të bëjmë ne tash? Sigurisht duke përmendur këtu edhe rezoluta që është shtruar nga LDD, por edhe synimet e partive tjera politike e tjera, dhe aq më shumë strategjia e Qeverisë e paraqitur që në mënyra procedurale do të duhej të merreshin vesh dhe ne të kemi strategjinë

përpara, ne të përkrahim strategjinë, ta kompletim strategjinë me ndonjë sugjerim dhe në fund të jepim edhe dinamikën e realizimit të tyre dhe Qeveria të jetë e përcjell nga Kuvendi në një kohë relativisht të caktuar apo periodik të tyre, siç është tremujshi e tjera, e tjera, duke i raportuar Kuvendit secila ministri veç e veç për të arriturat dhe integritet atje. Mirëpo, duhet të kemi parasysh se atje nuk kemi struktura paralele, por kemi struktura serbe, prandaj po të thuhet, unë e pashë edhe në rezolutë atje, thuhet janë struktura paralele serbe në pjesën veriore të vendit tonë, janë struktura serbe, prandaj ne duhet të matim me këtë kut. Shiko çështja kjo e cila veç është grumbulluar dhe kanë marrë pjesën e participimit në neglizhim, së paku në neglizhim, unë e them që prej dhjetëvjetëshit e këtej me PDK, me AAK, me LDK, por edhe këtë pjesën e LDD-së që ka qenë e integruar në LDK, janë pjesë të neglizhimit që i kanë bërë dhjetë vjet dhe fajet në një masë janë po ashtu të gjitha qeverive tona. Prandaj, po të kemi parasysh dinamikën dhe përpjekjet që asnjëherë nuk kemi pasur një strategji të tillë dhe tash e bëjmë dhe këtë e pata thënë në momentin kur u konstitua Qeveria se duhet të bëhet një plan strategjik, politik, ligjor dhe integruar në Mitrovicë dhe mirë që kanë dalë këto. Edhe nga AAK-ja dhe nga grupet tjera është përmendur me të drejtë, por çka mund të bëjmë tash? Duhet t'i shtrojë ky Kuvend detyra Qeverisë dhe në mënyrë të veçantë ministrive t'u ndahen punët në pjesën administrative, në pjesën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, të ndahet buxheti po ashtu me një kosto e cila do të bëhet analizë. Pastaj të shikohet mënyra e integritetit civil atje, të funksionojë sistemi dhe të niset menjëherë me mbledhjen e targave të regjistrimit të cilat janë të shtetit tjetër dhe t'u jepet afat në ndërrimin e tyre, e tjera punë shumë pragmatike që do të mund t'i bënin ministrinë veç e veç. Kjo, ndryshe, atje Serbia de fakto e ka aneksuar atë pjesë, kurse bën përpjekje direkt juridike që ta përvetësojë tërësisht. Prandaj, duhet të bëjmë një ndeshje këtu, por jo kjo ndeshja që shpesh po thuhet e dhunshme dhe e pa dhunshme. Nuk ka nevojë, unë besoj, që të thuhet kështu apo ashtu. Ka nevojë që të ushtrohet ligji atje dhe të ushtrohet ligji atje – shteti ligjor, janë mjetet administrative, janë organet përcjellëse, është krejt vëllimi i punëve të cilin duhet ta bëjë secila ministri, prandaj nuk do të ushtrojmë dhunë ose do të ushtrojmë dhunë, këto janë do sloganet, apo shprehje togfjalësha që s'ka nevojë që s'ka nevojë për deri sa kemi masat administrative, integruar, ligjore e tjera të cilat duhet të jenë të zbatueshme, sepse ndryshe Mitrovica do të na pengojë në integritet e mëtejshme, sepse do të kemi një qasje tjetër. Ne do të na thuhet se ju nuk jeni të zot ta bëni shtetin ligjor, ju nuk mund ta preni kontrabandën e tjera, të cilën faktikisht pika e zezë e Mitrovicës i prodhon ato. Dhe, deri sa ne këtë e lëmë njëkohësisht, të mos mendohet shumë edhe për integritet në Europë e tjera, prandaj kjo duhet të jetë një obligim po ashtu shtesë dhe në këtë rast unë shoh se ajo strategji e Qeverisë duhet të ...

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Lajçi! Faleminderit, zoti Lajçi! Atëherë, a të shkojmë në pauzë për drekë? Deri në 14:30, pauzë për drekë.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI I KUVENDIT: Në sallë janë 41 deputetë, që do të thotë mund të fillojmë debatin. Vazhdojmë. Fjalën e ka deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinetit qeveritar,
Kolegë deputetë,

Dhjetë vjet pas luftës dhe dy vjet që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, Kuvendi i Kosovës po diskuton për herë të parë për veriun e saj për një pjesë të territorit të saj, që

është mbi 17% dhe nuk kontrollohet nga asnjë institucion legal politik i Prishtinës. Mungesa e këtij debati për veriun në Kuvend deri më tani ka krijuar hapësirë për plane destruktive.

Kolegë deputetë,

Unë para veti e kam një dokument të Qeverisë së Kosovës, i cili është hartuar në prag të shpalljes së pavarësisë së Kosovës e quhet - Urdhër operativ, statusi. Në këtë dokument ishin paraparë pika të zeza që mund të vinin si pasojë e shpalljes së pavarësisë dhe përmendeshin konkretisht probleme të cilat mund t'i shkaktonin strukturat kriminale serbe të mbështetura nga Qeveria serbe. Plani parashihte edhe mundësinë e djegies së dy pikave kufitare 1 dhe 31 në kufi me Serbinë, por në plan ka edhe detaje të tjera të cilat nuk janë realizuar as atëherë, as tani. Nuk di pse dështoi ky plan, pse kurrkush nuk dha përgjegjësi politike dhe juridike? Ndoshta Qeverisë nuk i kujtohet ky dokument, por si shumë dokumente tjera të rëndësisë së veçantë janë miratuar nëpër zyra dhe asnjëherë në Kuvendin e Kosovës.

Të nderuar, të qenët në pushtet është përgjegjësi për t'u përballuar me kërkesa të vendit.

Kolegë deputetë,

Tashmë së fundi Zyra Civile Ndërkombëtare, në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës, kanë miratuar një dokument për integrimin e veriut. Koha kur është hartuar tregon se deri tani vendi ynë nuk ka pasur një dokument të tillë dhe gjërat në atë drejtim janë bërë ad-hoc. Ky dokument i Zyrës Civile Ndërkombëtare dhe Qeverisë së Kosovës, që qarkullon sot nëpër media dhe këtë përmbledhje që kemi marrë ne sot, jo vetëm që nuk do ta integrojë veriun e Kosovës, por do të krijojë premisa për vazhdimin e status kuos në atë pjesë të Kosovës. Si mund të zbatohet një plan në veri të Kosovës në të cilin plan nuk janë pjesë, KFOR-i dhe EULEX-i, dy organizma që në një mënyrë janë pranuar nga qytetarët lokalë? Mendoj se Kosova Veriore është problem politik, por edhe juridik, pra i sundimit të rendit të ligjit, pra edhe qasja duhet të bëhet në këtë drejtim. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Teuta Hadri, le të përgatitet Driton Tali.

TEUTA HADRI: Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti kryetar dhe ministra,

Unë për këtë pikë të rendit të ditës nuk kam dashur të flas, pasi se kjo pikë e rendit të ditës siç diskutohet, sipas mendimit tim, Qeveria e Kosovës e ka dhënë maksimumin e vet me gjithë institucionet e saj dhe vetë Kryeministrin Hashim Thaçi. Vazhdimisht dhe posaçërisht, pas këtyre dy vjetëve kryeministri Thaçi, të gjithë e dimë, ka qenë në media për çështjen e Mitrovicës. Ajo çka mua më obligoi sot dhe më nxiti të flas, më vjen keq që zoti Daci nuk është këtu, janë dy çështje në diskutimin e tij i kam dëgjuar. Tha dua t'i detyroj deputetët e rinj të Parlamentit dhe fjala e dytë ka qenë se deputetët duhet ta japin fjalën e vet. Te e para, unë them se zoti Daci ka krijuar njëloj përçarje në mes të deputetëve të ri dhe deputetëve të vjetër duke e bërë një fushatë të mekur, sikur të jetë një lider i ndonjë partie dhe aty nuk do të distancohem dhe të ndalem më shumë, ndërsa te fjala e dytë, më nxiti kur tha se deputetët duhet ta thonë fjalën e vet. Unë zotit Thaçi dhe shumë deputetëve të opozitës që sot u bënë patriotë, unë do t'u them se deputetët e Parlamentit të Kosovës e kanë dhënë fjalën vendimtare dhe historike, nuk kanë bërë histori gojore, siç bëhet sot, por kanë dhënë këtu më 17 Shkurt dhe disa me lot në sy që kanë pasur dhimbje më të madhe, ndoshta ata pak me dhimbje më të vogël, ata e kanë përjetuar me emocione dhe sot 17 Shkurti dhe nënshkrimi i pavarësisë së Kosovës është

kudo në shtëpitë e qytetarëve tanë. Por, të lutem, lë lutem, unë kurrë s'të kam kundërshtuar. Mbylle! Mbylle! Është mendimi im i lirë që e flas. Unë do të ndalem te rezoluta e zotit Daci, zotit akademik. Vërtet është, unë kur e dëgjova dhe shumë deputetë, besoj kur e keni dëgjuar fjalën rezolute, jeni kthyer prapa historisë në rezolutat e 96-ës deri në rezolutat e 99-ës, kur dihen se çfarë efekti kanë pasur rezolutat tona te ndërkombëtarët. Dhe, unë e them, ajo rezolute sot shumë deputetë i ka shqetësuar që mos të kthehen te e kaluara. Unë kam pritur prej akademikut dhe shumë deputetëve te çështjet e mëdha politike, të jenë një balancim politik, balancim që do t'i ndihmojë edhe Qeverisë së Kosovës, zotërinj, dhe ky balancim politik duhet të tregohet këtu në Parlament dhe të vihet me projekte. Zoti akademik ka qenë kryetar i një Parlamenti dhe i ka pasur të gjitha të drejtat edhe ai edhe deputetët, të gjithë ne të japim projekte për veriun e Mitrovicës. Kujtoni 2004-shin, ndoshta ju kujtohet kur Mitrovica ishte në zjarr, PDK-ja me përfaqësuesit e vet që edhe vetë kam qenë në atë shkuarje, kemi shkua në Mitrovicë, për ta qetësuar gjendjen nën tymin dhe barotin që u bë në atë kohë dhe askush nuk ka ardhur prej Qeverisë apo prej liderëve partiakë, çka edhe vetë partia e LDK-së kujtoj e komunës së Mitrovicës, i ka lypur përfaqësuesit e vet, kështu që, çdo herë deputeti ka pasur fjalën e vet për të folur dhe të bërë. Unë kisha dashur, edhe zotin Daci edhe të gjithë deputetët patriotë të bëjmë një deklaratë, jo me rezoluta, dhe kisha dashur zoti kryetar i Parlamentit, në deklaratë të futet një pikë e imja dhe aty të mos flasim kështu gojarisht për Mitrovicën, ta bëjmë një aksion, zoti Daci me deputetët dhe unë pas tyre, të shkojmë në Mitrovicë dhe të futemi se s' na ndalon kurrkush dhe të bëjmë ndryshime dhe ta integrojmë minoritetin serb me të gjithë liderët tuaj që kanë projekte dhe që kanë para të partive tjera që mund të bëjnë projekte për Mitrovicën të ecim, unë jam prapa juve. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Driton Tali, le të përgatitet Bujar Dugolli.

DRITON TALI: Faleminderit!

Unë i përshëndes nismëtarët e kësaj seance, sa shumë të nevojshme për ardhmërinë e shtetit të Kosovës, po aq edhe të vonuar. Them të vonuar, sepse ua rikujtoj sidomos disa deputetëve shumë të zëshëm këtu se kjo iniciativë është marrë disa herë nga unë personalisht dhe disa bashkëmendimtarë të mi, kolegë të mi dhe ata që ishin më të zëshmit këtu e tërheqshin nënshkrimin në momentin e fundit, domethënë në qershor të vitit 2008, kur u krijuan këto struktura ilegale në bazë të zgjedhjeve ilegale të 11 majit të cilat i organizuan, po ashtu strukturat ilegale të Serbisë në Kosovë. Unë këtu e kam mocionin, të cilin është protokolluar më 4 qershor 2008, pra atëherë kur Qeveria e Serbisë deklaroi se do t'i krijojë strukturat në Kosovë dhe arsyetimi ka qenë kjo, duke u nisur nga ajo, po e lexoj, nga fakti se deri më tani e kanë deklaruar qeveritarët serbë në lidhje me Kosovën dhe e kanë ndërmarrë në praktikë. Pra, përkundër asaj që kjo qeveri çka deklaroi nuk e realizon dhe po ashtu kam pas tentuar, më 19 qershor, me disa bashkë kolegë s'po ua përmend emrat të gjithëve se kanë qenë të spektrit të gjerë, po ashtu disa që shumë të zëshëm ishin këtu, në momentin e fundit e tërheqshin nënshkrimin. Arsyetimi ka qenë kështu, për shkak se tashmë strukturat paralele janë krijuar, po flas më 19 qershor të vitit 2008, që doni, po ua lexoj edhe mocionin – deklaratën, që është pak e ngjashme me këtë, po them për ata që e tërheqshin nënshkrimin, nuk e kam për Ali Lajçin, i cili e ka mbajtur deri në fund, është Zafir Berisha, është Shkumbin Demaliaj e kush është tjetër këtu që e kanë përkrahur këtë mocionin deri në fund, Rita Hajzeraj, Zafir Berishën e përmenda, Arsim Rexhepi e tjerë, e tjerë, tash shumë kanë qenë këtu, veç t'i lexoj nga 3-4 pika se janë interesant për, po them, për këta më të zëshmit sot.

Domethënë, është kërkuar që të shpallet e pavlefshme ilegale dhe të anulohet çfarëdo zgjedhje brenda territorit të Kosovës, që nuk janë të organizuara nga institucionet e vendit dhe që janë jashtë ligjit dhe sistemit politik të Kosovës, rrjedhimisht t'i anulojnë të gjitha rezultatet e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë dhe strukturat që dalin nga to, pra null and void.

Të shpall të jashtëligjshëm dhe të dënueshëm aktivitetin politik të secilit individ apo të secilës organizatë politike që cenon sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës, pika 2.2 e Kushtetutës së Kosovës.

Nën 3. T'ua thotë haptas dhe në mënyrë të qartë misionëve ndërkombëtare të pranishme në Kosovë që mos të pranojnë bashkëpunimin dhe negocimin me strukturat që dalin nga këto zgjedhje.

Pika 4, të pezullojë deri në një kohë të pacaktuar zbatimin e decentralizimit në rastin më të mirë, Kuvendi të përdorë decentralizimin si kushtëzim.

Dhe 5, prioritet qeveritar dhe institucional i Kosovës duhet të jetë integrimi i pjesës veriore të Kosovës e jo decentralizimi i pjesës tjetër të Kosovës.

Tash konform të pikës 4 dhe 5, të të cilat do të ndalem që kanë të bëjnë me integrimin e Kosovës, pjesës veriore të Kosovës dhe decentralizimin e Kosovës së brendshme që disa po i referohen, sepse qëllimi i Serbisë në të kështu është, po them në të shohim gjërat shtruar dhe shihet ashikare se përveç disa shkurtpamësve që nuk e shohin dhe disa të inkriminuar në krime ekonomike, pra të atyre që janë më shumë të interesuar si ta rrisin pasurinë e vet personale më shumë, është që 3 apo 4 këto komuna të, Mitrovicën e veriut, Leposaviqin, Zveçanin, Zubin Potokun, t'i shkëpusin nga Kosova, kurse dokumentin e Ahtisarit, ta implemnetojnë në viset tjera në Kosovë, ku ka serbë. Pra, Graçanicën dhe komunat tjera, andaj në këto komuna disa serbë dolën në zgjedhje të sivjetme lokale. Për këtë arsye pata kërkuar që decentralizimi të stopohet dhe ajo të paktën të përdoret si kushtëzim, gjersa kjo strategji e stërvonuar flet për gjëra që nuk i përkasin realitetin, sepse në veri, sidomos në katër – pesë muajt e fundit, Serbia e ka konsoliduar me sukses kontrollin në të gjithë sektorët e jetës. Nën një, Kosova nuk ofron rrymë elektrike në veri....

KRYETARI: Faleminderit, Driton! Faleminderit! Ke qenë shumë konstruktiv. Vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti, Bujar Dugolli, le të përgatitet Gani Geci.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, kryetar!

Së pari, unë përshëndes iniciatorët e këtij debati, Grupin Parlamentar të LDD-së, mendoj se është në kohën e duhur, kur edhe Qeveria e Kosovës bashkë me faktorin ndërkombëtar ka ofruar para Kuvendit të Kosovës një përmbledhje të strategjisë për veriun. Çështja e veriut nuk është çështje e konstatimit tani për tani se si është dhe të merret debat i gjerë këtu në mes deputetëve, sepse të gjithë qytetarët e Kosovës e dinë se si mbet kjo çështje nga marrëveshja e Kumanovës, mandej nga tolerimi i strukturave të Serbisë nga misioni ndërkombëtar UNMIK-u, nga marrëveshja famkeqe Hakerup – Çoviq dhe kështu me radhë, erdhëm deri në këtë kohë, domethënë, që pas shpalljes së pavarësisë të degradojë edhe më shumë pjesa veriore e Kosovës. Tash shtrohet si nevojë e domosdoshme shtrirja e qeverisjes të Kosovës në tërë territorin e Kosovës, duke treguar gatishmërinë edhe zbatimit të Kushtetutës së vendit.

Këtu nuk do të flitet me inate apo me çështje që nuk i kontribuojnë gjendjes. Çdokush, ai që flet në mënyrë reale e kupton se Qeveria, tani për tani i ka kushtuar një rëndësi integritetit të pakicave në këto dy vjetët e fundit, ka pasur një rezultat në integritetin në shumë komuna dhe në krijimin e komunave të reja. Unë mendoj se kjo qasje duhet të vazhdojë edhe në pjesën veriore dhe kjo sfidë që është para Qeverisë së Kosovës dhe misionit ndërkombëtar të Kosovës, për integritetin e veriut, duhet t'i jepet një mbështetje e plotë nga Kuvendi i Kosovës, sepse vetëm në këtë mënyrë, domethënë, mund ta kryejmë të gjithë funksionin edhe të deputetit edhe të institucioneve të vendit.

Nuk është koha sepse kjo çështje është madhore e vendit dhe duhet të ketë bashkëpunim i të gjitha fushave të institucioneve dhe ta japin kontributin e vet. Këtu kemi edhe deputetë që vijnë edhe nga komuniteti serb dhe në pakica tjera që roli i tyre duhet të jetë shumë aktiv sa i përket integritetit dhe pjesëmarrjes në institucione vendore, në zgjedhjet që parashihen të mbahen, thjesht nuk duhet të jetë prezenca e tyre në institucione vetëm si dekor, por të angazhohen më tërë kapacitetin e tyre që të korrrin rezultate edhe në zgjedhjet lokale në ato pjesë dhe kontrolli të jetë në duart e atyre që ia dëshirojnë të mirën të gjithë qytetarëve në pjesën veriore. Domethënë, nuk duhet të ketë zëra vetëm nga shqiptarët që janë për një stabilitet atje, por edhe nga serbët, nga boshnjakët, romët, ashkalinjtë e të gjithë ata që jetojnë në pjesën veriore. Qeveria duhet të vazhdojë me investime në pjesën veriore edhe pse ne jemi dëshmitarë që janë bërë disa investime kohëve të fundit, por duhet të vazhdojë edhe më tutje, duhet të sigurohej edhe ndërtimi dhe kthimi i të gjithë qytetarëve që dëshirojnë të vazhdojnë atje.

Tek përmbledhja e strategjisë janë disa formulime që na bëjnë të mendojmë që a janë gabim në formulim apo qëllimisht janë lënë kështu, kur flitet për çështjen se strategjia thotë jep rekomandime në fushat kryesore, siç është sundimi i ligjit dhe centralizimit, themelimi i komunës së Mitrovicës së veriut, adresimi i qeverisjes në tri komunat e veriut dhe përmirësimi i statusit social ekonomik? Unë mendoj se në këtë çështje nuk duhet të thuhet të japë rekomandime, por strategjia i ka këto objektiva për t'i zgjidhur dhe jo të mbeten në çështjen e rekomandimeve apo kur flitet për kontrollin e plotë doganor duhet të rivendoset në një kohë të përshtatshme. Unë mendoj duhet të qiten disa afate dhe të mos i lihet kohës së përshtatshme apo vetëm në formën e rekomandimeve po të konkretizohet, sepse gjendja aktuale e mos kontrollit doganor po i shkakton dëme të mëdha vendit, ekonomisë së Kosovës dhe në këto dëme po përjetojnë të gjithë qytetarët, pa dallime etnike. Thjesht nga ky përfundim i debatit duhet të dalë një dokument, qoftë rezolutë, qoftë deklaratë e përgjithshme e Kuvendit që njëzëri të mbështesin sundimin e shtetit ligjor dhe shtetit së të drejtës në tërë territorin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Gani Geci, le të përgatitet Rustem Mustafa.

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryetar

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Mua më pëlqeu fjala e akademik Nexhat Dacit, po edhe e akademik Sabri Hamitit, që këtu, në këtë pikë të rendit të ditës kemi dy çështje – çështja e zbatimit të Kushtetutës dhe çështja e pranisë së strukturave paralele, jo struktura paralele, por struktura të Serbisë në Kosovë. Do të thotë, nëse një shtet tjetër ka struktura të veta në shtetin tonë, është një çështje tjetër. Nuk janë struktura paralele këto për shkak se nuk financohen nga vetë, por financohen nga një shtet tjetër dhe nuk kanë financa që mund ta mbajnë vetveten këto, prandaj ne duhet të luftojmë me shtetin e Serbisë, që t'ua ndalin financat atyre që ne të mos kemi probleme në zbatimin e Kushtetutës.

Unë dua të ndalem në nenin 1 të Kushtetutës së Republikës, i cili thotë se Kushtetuta - Republika e Kosovës është shtet sovran i pandashëm. Atëherë, ju lutem, a është Kosova shtet sovran i pandashëm?

Neni 2 Sovraniteti dhe integriteti territorial mbrohet me çdo mjet. A mbrohet sovraniteti me çdo mjet? Nuk mbrohet.

Mandej kemi edhe nene tjera, neni 16 pika 4 thotë – Secili person dhe organ i Republikës së Kosovës i nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës. A i nënshtrohen të gjithë dispozitave të kësaj Kushtetute?

Mandej kemi nenin 44 pika 1, ku ka të bëjë edhe me çështjen e organizatave joqeveritare dhe organizatave tjera, siç është organizata e Vetëvendosjes, e cila ka të drejtë.

Mandej kemi nenin 88, sepse në pikë të rendit të ditës zbatimin e Kushtetutës. A e zbaton Presidenti Kushtetutën?

Mandej kemi nenin 102 dhe e kemi nenin 125 dhe nenin 128.

Neni 102 pika 2 thotë - pushteti gjyqësor është unik e i pavarur. A është pushteti gjyqësor unik në Kosovë? S'është. Serbia i emëron gjyqtarët. Serbia i emëron në një pjesë të Kosovës prokurorët.

Neni 125 thotë- Republika e Kosovës ka pushtet mbi zbatimin e ligjit, sigurinë dhe drejtësinë në tërë territorin. A e zbaton? Jo.

Prandaj kemi kërkuar këtë. Nuk kemi kërkuar ndarje të deputetëve, siç pretendojnë të tjerët këtu, sepse ne nuk i ndajmë deputetët. Deputetët e Kosovës janë të gjithë deputetë dhe ata kanë ardhur me vota këtu. Nuk kemi ardhur këtu që na ka prurë dikush me lëmshë ose me vota që na i kanë falë, kemi ardhur me vota të popullit të Kosovës. Dhe kemi të drejtë të gjithë, dikush ka më shumë deputetë, dikush më pak, por kemi të drejtë të gjithë të barabartë në Kosovë.

Mos u lidhni në patriotizëm verbal, sepse patriotizmi verbal ka kaluar. Po unë dua t'ua përkujtoj se në vitin 1998 ka qenë një qeveri e përkohshme dhe kanë dhënë urdhër që ushtria çlirimtare të mos shkojë matanë ure. Prandaj edhe kjo është një problem, sepse dikush ka dhënë urdhër që të mos shkojë më tej ure dhe kur s'kanë shkuar matanë ure kemi mbetur edhe tash këtu.

Mandej, unë po ju them sinqerisht, duke pasur parasysh Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe duke i pasur parasysh të gjitha këto, i kam marrë me veti, të gjithë anëtarëve të Qeverisë t'ua jap nga një kushtetutë dhe t'i lexojnë këto nene. Dhe, këto nene kanë të bëjnë me Kushtetutën e vendit dhe unë absolutisht s'kam gjë të keqe me bashkësinë ndërkombëtare, sepse ajo na ka ndihmuar për ardhur këtu ku jemi dhe ajo na ka ndihmuar ta bëjmë këtë Kushtetutë që e kemi bërë. Dhe, këtë Kushtetutë të Republikës së Kosovës nuk e kam bërë, unë e kam miratuar këtu, faktikisht edhe s'e kam miratuar, por meqë e kanë miratuar shumica kam qenë për. Dhe, meqë e keni miratuar ju të gjithë, anëtarëve të Qeverisë ia kam bërë nja 15, a sa janë, po unë dua t'ua japë të gjithëve. Më falni, përkohësisht!

Mos u ngutni, se kemi kushtetuta boll. Jo, anëtarët e Kryesisë s'kanë nevojë. Ne jemi këtu në Kuvend, anëtarët e Kryesisë dhe Kuvendi i Kosovës nuk kanë nevojë për Kushtetutën, sepse Qeveria e zbaton Kushtetutën, është organi që duhet ta zbatojë Kushtetutën dhe ne po kërkojmë. Nuk është fjala që ne po kërkojmë një rezolutë që të zbatohet kjo Kushtetutë. Nëse nuk duhet të aprovohet rezoluta, atëherë pse po u dashka të aprovohet strategjia? Do të thotë, nëse s'po u dashka rezoluta s'na duhet as strategjia as rezoluta dhe ne ta zbatojmë Kushtetutën. S'na duhet asnjë dokument tjetër, e kemi Kushtetutën, i kemi aprovuar ligjet dhe të veprime në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të cilën e kemi aprovuar ne të gjithë. Dhe, e harrojmë rezolutën, e harrojmë edhe strategjinë, e harrojmë edhe deklaratën, do të thotë, veprime në bazë të organit më të lartë...

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Rustem Mustafa, le të përgatitet deputeti Ibrahim Selmanaj.

RRUSTEM MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Unë sot para se të filloj të flas për temën- zbatueshmëria e Kushtetutës, dua të falënderoj qytetarët e vendit tonë, që na kanë prurë në këtë pozitë sot të flasim për zbatueshmëri të ligjeve dhe të rregullave të Kushtetutës në vendin tonë për gjithë Kosovën.

Qytetarët e vendit tonë bashkë me ne e bënë Kosovën në këtë pozitë që të njihemi krenar si sukses i veçantë i vetë neve. Suksesi tonë dhe këtij modeli iu bashkëngjiti edhe Aleanca e NATO-s, me ndërhyrjen e saj në vitin 1999. Kjo ndërhyrje u quajt për shpëtim dhe u krijua për të gjithë, jo vetëm për shqiptarët, por edhe për gjithë botën si model i pastër, model i mirë, që edhe sot me këtë vlerë të krijuar krenohen dhe e përdorin suksesshëm. Ne e dimë që në gjithë vendin që dhjetë vjet ka pasur eksperiment, eksperimentet kanë qenë prej më të ndryshmeve dhe këto eksperimente kanë bërë që të mos lejojnë vullnetin e qytetarëve të vendit të kenë akses në çdo pjesë të vendit. Unë do të ndalem, posaçërisht të flas për sektorin e sigurisë në 3 komuna në veri ku deri tash s'kemi pasur akses. Deri tash atje nuk është zhvilluar arsimi në mënyrë të rregullt, nuk ka pasur drejtësi, nuk ka pasur drejtësi, nuk

ka pasur administratë të organizuar nga ne, nga shteti ynë. Këtë e dimë të gjithë dhe s'kemi çka të merremi më me konstatime. Është e pranueshme prej të gjithëve se atje ka mbretëruar një anarki dhe ajo anarki është duke u udhëhequr prej qytetarëve keqdashës, që janë të paligjshëm, që kisha për të thënë janë struktura kriminale që duhet të ndeshen me ligjin. Mua më vjen mirë që tash së fundi Qeveria jonë ka krijuar grupin punues gjithëpërfshirës apo strategjisë, siç i thoni. Shtetet me demokraci të zhvilluar e kanë pranuar si dokument të vetin dhe po e ndihmojnë për të vënë rregullin në gjithë vendin. Unë gëzohem se Qeveria e ka bërë edhe një grup punues për ta luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin dhe këto janë metoda dhe janë mënyra që mua më bindin që shumë shpejt do të shtrijmë në gjithë territorin e vendit, zbatimin e Kushtetutës së vendit tonë. Atje të gjithë e dimë që është jetë e parregullt dhe është krim i organizuar. Ne, as Qeveria e vendit, as qytetarët nuk duhet të lejojmë që të shëmtohet modeli të cilin e kemi krijuar bashkërisht me shtetet që kanë prodhuar demokracinë më moderne. Ne nuk do të lejojmë që të prishet dhe të shëmtohet ky model, por me këtë qeveri që jemi ne këtu, me vendosmërinë e qytetarëve tanë do të bëjmë rregull, rend dhe ligj, do të bëjmë arsim më të mirë për ata qytetarë atje, sepse kemi borxh si për vetveten tonë dhe do të zhvillojmë, do të bëjmë rend, ligj e drejtësi në gjithë vendin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ibrahim Selmanaj, le të përgatitet deputeti Armend Zemaj.

IBRAHIM SELMANAJ: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për ministrat prezentë,

Kolegë deputetë,

Mbi bazën e diskutimeve që i bëmë deri tash po vërehet dhe po dëshmohet fakti se një pjesë e Kosovës nuk administrohet nga Qeveria e Kosovës dhe kjo periudhë zgjat tash e dhjetë vjet. Po pajtohem, po ma merr mendja në të përgjithshmen se kjo pjesë ka nevojë për një përkrahje, një unifikim të një strategjie të përbashkët e cila ndoshta përfundimisht do ta gjejë një rrugë dhe ta kanalizojë një kahe që do të jetë në interes të qytetarëve dhe në radhë të parë të një pjese të territorit të Kosovës.

Çka më shtie të kem dyshime në zbatim të kësaj strategjie, është fakti se ne jetojmë në pjesën tjetër të cilën e monitorojmë dhe administrojmë dhe kemi pasur qeveri kohë pas kohe prej vitit 1999, që Kryeministri, pa dashje ose pa dije, po matet vetëm në zgjedhjet e fundit dhe në periudhën kur është Kryeministër tashmë dhe ka harruar se ka qenë edhe Kryeministër i Qeverisë së përkohshme të Kosovës dhe ka administruar dhe e ka pasur edhe një kryeministër të partisë së vet dhe një pjesë e madhe e juaja keni qenë që keni udhëhequr edhe në atë periudhë kohe. Si do që të jetë, në Kosovë enden makina me tabela të Mitrovicës, Gjakovës, të Pejës, të viteve të 80-ta edhe përcillen edhe me polici të Kosovës, në raste të caktuara, çka do të thotë se është një shkelje ose një standard i dyfishtë për qytetarë. Nuk ka marrë masa Qeveria e Kosovës, me një organizim kaq të fortë dhe me një mekanizëm të organizuar mirë edhe pas thyerjes së Dhomës së Hetimeve, deri sot asnjë përgjegjësi nuk është nga asnjë patriot.

Sa i përket gjyqësisë dhe zbatimit të drejtësisë dhe Kushtetutës, duke filluar nga Presidenti, ka shkelje të Kushtetutës. I emëruari për zbatim të strategjisë, Ylber Hysa, të shtyn për të hapur dyshime dhe dilema përderisa ke një mekanizëm krejt tjetër dhe ke ministra që merren edhe me pushtetin lokal dhe pse jo mos të jetë edhe Ylberi, po ka pak dyshim dhe ka skepticizëm.

Nëse në radhë të parë pastrojmë situatën që e kemi në kontroll brenda Kosovës, pa dal te veriu i Kosovës, atëherë unë mund të besoj se do të ndodhë një zhvillim shumë pozitiv dhe ndoshta në një periudhë shumë të shkurtër edhe veriu i Kosovës do të integrohet, por në radhë të parë duhet të hiqen këto dilema. Mos të bëjmë shumë analiza, psikanaliza dhe të bëhet vlerësimi se kush është patriot dhe kush nuk është patriot. Mos të folët me paragjykime dhe secili ka të drejtën e vet, qoftë pozitë, qoftë opozitë që ta japë përkrahjen e vet, që ta japë kontributin e vet dhe mbi këtë kuadër në strategjinë, që unë po besoj që të jetë e zbatueshme, të jemi të gjithë unikë dhe unë do të përpiqem maksimalisht, me mundësitë që i kam që të jem konstruktiv, por jo patriot. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj, le të përgatitet deputeti dhe zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zotëri kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zëvendëskryeministër, ministra të nderuar,

Para se ta marrë fjalën tani po mendoj nuk di a do të mund t'i kontribuoj me ato çka do t'i paraqes, apo më shumë do t'i kontribuoj marketingut politik nga ato që dëgjova deri më tani, se po më duket për një çështje shumë të rëndësishme, më shumë po kemi gjuajtje

në mes veti se kush ka qeverisur më mirë me të kaluarën e kush ka marrë vendime më të mëdha, kush tani o kah bën më shumë.

Problemi është se strukturat paralele të shtetit serb po vazhdojnë të sfidojnë institucionet tona vendore të Kosovës, në ushtrimin e funksionimit, por pa e anashkaluar edhe atë të bashkësisë kombëtare, në këtë rast të EULEX-it dhe ICO-s. Këtu po nisem nga fakti se ishte edhe zotim i kryenegociatorit Ahtisari edhe gjatë bisedimeve se 120 ditë, pas zgjidhjes së statusit të Kosovës, do të ketë shuarje të strukturave, të ashtuquajtura paralele, që edhe ne sot po dëshmojmë se nuk janë struktura paralele, po janë struktura të shtetit serb.

Tani lind pyetja edhe pse sipas rendit të ditës nuk ishte temë e debatit- strategjia, po ishte të debatohet për zbatueshmërinë e kushtetutshmërisë dhe strukturat paralele, se a do të jetë e mjaftueshme vetëm strategjia për veriu që të kemi eliminim apo shuarje të këtyre strukturave paralele? Në kohën kur institucionet tona dhe EULEX-i, tentojnë që të vënë në funksion gjykatat në veri të vendit tonë, Qeveria e Serbisë emëron gjyqtarë dhe prokurorë serbë që pretendon të shërbejë në Kosovë dhe jo vetëm në Mitrovicën Veriore, por edhe në: Graçanicë, Ranillug, Shtërpçë, sa që shkon aq larg edhe në Gorazhdec, afër Pejës.

Problemi tjetër, të nderuar kolegë deputetë, është se thuhet publikisht se në Kosovë punojnë 725 zyrtarë serbë që paguhën nga Qeveria e Serbisë dhe që po dyshohet se a janë qytetarë serbë, a janë agjentë të Shërbimit Sekret, apo kryejnë veprimtari tjetër që bie ndesh edhe me ligjet dhe me organizimin institucional të jetës sonë? Kjo mbetet sfidë së pari për Ministrinë e Punëve të Brendshme, por edhe për ne të gjithë, në përgjithësi.

E dyta, 42 milionë, prapë thuhet publikisht, është deklaratë edhe e miratuar do të thotë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ndahen për financimin e këtyre strukturave paralele, do të thotë, në territorin tonë, në Republikën e Kosovës.

Çështja tjetër është se bashkësia ndërkombëtare ndihmon shtetin serb duke mbuluar deficitin buxhetor dhe kjo dyshohet se më shumë se 200 milionë në vit nga këto para prapë shkojnë për financimin e këtyre strukturave, prandaj këtu duhet tërhequr edhe një paralele në mes atyre që dëshirojnë të ndihmojnë shtetin e Serbisë për integrim në strukturat euroatlantike, po në anën tjetër i bëjnë dëm edhe vetë veprimtarisë dhe kontributit të tyre për një Kosovë stabile dhe të integruar në Bashkësinë Evropiane.

Të gjitha këto janë sfida për zbatimin e Kushtetutës dhe institucioneve tona, prandaj së bashku që tani me strategjinë të plotësuar apo cila do të jetë, ndoshta do ta kemi edhe ne në pika edhe më të gjata, unë mendoj që duhet të kemi veprime konkrete, si dhe pa anashkaluar inkurajimin e serbëve lokalë që të largohen nga këto struktura të cilat pengojnë integrimin e tyre në jetën institucionale dhe shoqërore.

Edhe një herë them, këtu duhet që të gjithë të jemi më syçelë dhe të veprojmë bashkërisht me veprime konkrete që Kosova mos t'i ketë këto probleme nga një shtet fqinj të atakohet në sundimin e rendit dhe ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Hajredin Kuçi, le të përgatitet deputeti Mark Krasniqi.

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,
Anëtarë të Qeverisë,
Më lejoni në fillim të falënderoj zotin Geci që na e dha Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në një vend demokratik, pas librave të shenjtë, me siguri që Kushtetuta është një prej dokumenteve dhe librave që duhet të lexohet shpesh. Një lëshim e bëri zoti Geci që nuk tregoi që unë ia kam dhënë me kuti kushtetutat, ky ma dha një nga një. Unë besoj që është mirë dhe besoj se secili prej nesh do ta lexojmë.

Unë e kuptoj debatin e sotëm dhe besoj që edhe Qeveria e ka mbështetur këtë debat dhe secili prej nesh që është në Kuvend. Natyrisht, këtë debat e kemi kuptuar, unë do të jam shumë i hapur me ju, besoj se kjo hapje e mendimit me ju do të jetë një pjesë e asaj strategjie që duhet ta kemi të gjithë si shoqëri. Unë debatin sot e kuptoj si presion ndaj Qeverisë dhe institucioneve dhe bashkërisht si presion ndaj bashkësisë ndërkombëtare dhe të tjerëve që janë përgjegjës për rendin dhe ligjin në Kosovë dhe për këtë qëllim dikush e quan presion të menaxhueshëm, unë e quaj presion të durueshëm. Këta në mjekësi thonë kurrizin duhet ta drejtoni për aq sa nuk e thyeni. Dhe, në këtë presion e kuptojmë për aq sa nuk i thyejmë proceset që kanë të bëjnë me ne, me bashkësinë ndërkombëtare. Nuk dëshirojmë të hyjmë më shumë a më pak kush ka kontribuar dhe kush nuk ka kontribuar në atë drejtim, as kush është përgjegjës. Me siguri që në vende ku nuk shkojnë punët mirë, Qeveria e ka përgjegjësinë kryesore, po natyrisht edhe kur shkojnë punët mirë, ne kemi dëshirë me na thënë një gjë të tillë. Por ajo çka duhet të themi të gjithë ne në këtë vend edhe vendorët edhe ndërkombëtarët jemi të sfiduar me pjesën veriore të Kosovës. Kur e them jemi të sfiduar nuk e kuptoj kuptimin e sfidës personale, por si vend. Jemi të sfiduar me mungesën e rendit dhe ligjit, me mungesën e zhvillimit ekonomik, por mbi të gjitha me mungesën e zhvillimeve demokratike. Ne në Kosovë, apo përmes Kosovës, sfidohen edhe marrëdhëniet shqiptare-serbe, ndërsa në rastin konkret, marrëdhëniet e Kosovës, dikush kishte pasur për të thënë mosmarrëveshjet e Kosovës me Serbinë, reflektohen në veçanti në veri.

Fatkeqësisht për një kohë kanë reflektuar edhe në disa pjesë të territorit tonë që e kemi quajtur enklava, por duket që kohëve të fundit kemi zhvillime pozitive, ndërsa sa më të tensionuara janë këto raporte, aq më shumë do të kemi lëvizje të tilla, të cilat shpeshherë ne i quajmë sfida edhe në kuptimin politik edhe ekonomik pse jo, kemi pësuar humbje, po edhe sfida të cilat kanë të bëjnë me legjitimitetin demokratik.

Unë e them shpeshherë që janë disa akterë në këtë drejtim, një akter patjetër këtu e ka vështirë patjetër që të japë rezultate. Nuk dëshirojmë ta krijojmë logjikën apo iluzionin që do ta përdorim dhunën, por atje ka njerëz që në emër të "patriotizmit serbë" apo diku mund të jetë edhe shqiptar, merret me kontrabandë. Atje ka njerëz që përdoren apo kanë misionin në emër të një shteti tjetër, dhe ndaj tyre do të përdoret mjeti ligjor. Ne nuk e përdorim dhunën ndaj njerëzve të cilët janë qytetarë të Kosovës dhe kanë apo i kryejnë obligimet e tyre, ndërsa ata që bëjnë veprime të kundërligjshme, me siguri një ditë ligji do të ballafaqohet me ata.

Një akter i veçantë është, unë do të thosha akteri i Qeverisë në institucionet tjera, dikush kishte me thënë akteri shqiptar në Kosovë. Në këtë drejtim nuk e ndaj shumë Qeverinë, opozitën, shoqërinë civile dhe të tjerët, por në prioritet dhe të përgjegjësitë dhe të punës. Unë e marr shumë për të mirë që në fushatën e fundit elektorale, me ndonjë përjashtim nuk kemi bërë gara për veriun e Kosovës, po secili kemi bërë gara për vendin, për komunën, por s'kemi thënë kush po bën ma shumë a më pak. Në këtë drejtim mendoj që rolin e veçantë e ka bashkësia ndërkombëtare. Roli i EULEX-it dhe KFOR-it nuk

parasheh më shumë me këtë strategji se sa kompetencat që i kanë me mandatin që e kanë në Kosovë. Le ta përfundojnë atë, por neutraliteti i tyre, jam shumë i hapur, krijon dilema. Në radhë të parë krijon dilema te vetë qytetarët serbë atje, a duhet të bashkohen apo jo se thotë dikush po i mbështetja dikush jo dhe krijon pak iluzione te Qeveria e Serbisë që ende është një hendek që mund të ndërhyjnë ata në punë të brendshme të Kosovës. Ne i ftojmë ata të japin një mbështetje të plotë politike, por edhe të kryejnë mandatin e tyre edhe si EULEX edhe si KFOR në Kosovë.

Një akter tjetër që duhet ta pranojmë është popullata lokale serbe. Popullata lokale serbe atje për dhjetë vjet nuk e ka legjitimitetin demokratik. Atje janë disa njerëz që udhëheqin, por shumica janë që kanë probleme me rendin dhe ligjin, shumica është që kanë anarki dhe dikush i mundon ata dhe popullata lokale serbe sa më shumë që bashkëpunon me ne, aq më pozitive do të jetë besoj edhe për ata në radhë të parë, po edhe për ne dhe bashkësinë ndërkombëtare që t'u ndihmojmë atyre. Në këtë drejtim unë jam i bindur se komuna e Shtërpçës, Kllkotit, Ranillugut, është një shembull i mirë dhe besoj se në të ardhmen do ta vazhdojmë një gjë të tillë. I kemi bërë disa angazhime dhe nuk duhet të them se kanë qenë të mjaftueshme, por angazhimet tona duhet të jenë në drejtime të asaj që janë 3 kategori njerëzish, nëse më lejohet t'i them në këtë drejtim.

E para është kategoria shumicë që do të thosha, që dëshiron një dinamikë më të përshtetshme të veprimeve atje.

Kategoria e dytë është bashkësia ndërkombëtare apo një akter që dëshiron pak më kujdes.

Dhe, ne jemi Qeveria, që jemi në mes, duke dashur për ta respektuar edhe vullnetin shumicë...

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Mark Krasniqi, le të përgatitet deputeti Bajram Kosumi.

MARK KRASNIQI: Faleminderit për fjalën!

Përsëritje për të gjithë,

Sikur të kishim pasur rastin të diskutojmë për problemet jetike të Republikës së Kosovës sot, do të kishim më pak fjalë këtu, por meqenëse asnjëherë deri tash, për sa më kujtohet mua, nuk kemi biseduar për këto gjëra që janë vitale për vendin tonë...

Shteti pa Kushtetutë, e cila përmban rregullat kryesore: pavarësinë, integritetin, sovranitetin e tjera, nuk mund të jetë shtet i mirëfilltë. Ne jemi këtu që sa kohë në provim të faktorit ndërkombëtar, po më duket se ky afat ka kaluar, që dhjetë vjet jemi në provim dhe kemi mësuar çka duhet të mësojmë dhe kemi ditur diçka edhe ne për shtetin.

Nuk dua t'i përsëris gjërat që u përsëritën disa herë këtu, se sovraniteti, integriteti e këto të tjerat, janë cenuar në Kosovë dhe Serbia jo vetëm që i ka institucionet e veta të instaluar, por Serbia e ka okupuar veriun e Kosovës. Kjo duhet të thuhet haptas, ta dimë se ku jemi. Dhe, kjo gjendje nuk mund të durohet. Integriteti dhe sovraniteti shkruan në Kushtetutë se buron nga populli. Qeveria, Parlamenti dhe institucionet tjera duhet të përpiqemi që kjo mundësi të mos vijë në dorën e popullit, sepse populli kur ta marrë në dorë, atëherë nuk dihet se çka bëhet, por ata që i ka zgjedhur populli, ata janë përgjegjës për zbatimin e Kushtetutës dhe për mirëqenien e të gjithë qytetarëve të këtij shteti.

Ka disa analistë që propozojnë edhe projektojnë ndarjen e Kosovës për t'u marrë vesh me Serbinë. Serbia, për sa kam dëgjuar, disa herë është deklaruar se është kundër ndarjes së Kosovës, sepse ajo nuk e donë një copë të Kosovës, por e do krejt Kosovën. Aty është halli, siç i ka dashur gjatë gjithë historisë trojet tona etnike dhe historike për t'i zgjeruar kufijtë e shtetit të vet që nga viti 1878 deri më sot. Kufiri në Ibër nuk është kufi në mes të Kosovës dhe Serbisë. Serbia i ka planet e veta qysh më 1844 në projektin e Grashaninit dhe ai projekt është gjithmonë diku në fiokat ose në zarfet sekrete të politikës serbe. Prandaj, faktori ndërkombëtar duhet të bindet dhe duhet ta dijë se ne mbrojmë të drejtat tona, mbrojmë tokën tonë, mbrojmë shtëpinë tonë. Serbia do të na i marrë neve këto, siç na i ka marrë 2/3 e territorit etnik shqiptar, Serbia bashkë me fqinjët tanë tjerë. Unë them se ne duhet të gjithë të përpiqemi që Kushtetuta e cila nuk është e shkëlqyeshme, me thënë drejt, sepse ne nuk kemi pasur mundësi as ta diskutojmë, por e tillë siç është, përkohësisht të paktën le të zbatohet në të gjitha vendet. Në qoftë se prishet puna e kufijve, atëherë edhe neve na hapet dera në katër anët që të prishen kufijtë dhe të bashkohemi aty ku duhet të jemi të bashkuar. Prandaj, ne nuk e paraqesim, nuk e parashtrojmë këtë problem tash, por parashtrojmë problemin e Kosovës që të funksionojë si shtet i pavarur demokratik, me të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët e tij. Kurrkush nuk mundet më tepër t'i japë të drejtën vetes se sa vetvetja, vetvetja, domethënë, sjelljet e tyre, prandaj edhe komuniteti serb, i cili këtu apostrofohet më tepër se çdokush tjetër, varet nga ai në qoftë se donë për t'u mbyllur në enklava, enklavat- ato komunat etnikisht serbe, ata vetveten e dënojnë që të jenë të kufizuar si në një kamp të përqendrimit. Më mirë do të ishte që Serbia të kërkojë falje për gjenocidin që ia ka bërë shqiptarëve dhe serbët e Kosovës gjithashtu së bashku me Qeverinë e Serbisë dhe ne të kemi marrëdhënie fqinjësore dhe njerëzore njëri me tjetrin. Askush nuk i ka ruajtur as nuk mund t'i ruajë kishat ortodokse sa mund t'i ruajë populli shqiptar që i ka ruajtur gjithmonë. Kot i kanë ato rojet para kishës së Deçanit e disa të tjera sepse...

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi, le të përgatitet deputetja Qamile Morina.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht dua të pajtohem me të gjithë ata folës që potencuan një fakt sot, që sot në diskutim në seancë, janë futur dy dokumente, njëri është një dokument është që është futur në mënyrë procedurale, është Projektrezoluta e Grupit Parlamentar të LDD-së, por njëkohësisht një dokument tjetër është Strategjia për veriun, e cila nuk është futur në mënyrë procedurale në debat, ndërsa gjatë tërë kohës është diskutuar fillimisht nga Kryeministri, pastaj edhe nga shumë diskutues tjerë për këtë çështje.

Ajo që dua të theksoj unë sot është të ofroj tri qasje të mundshme ndaj problemeve në veriun e Kosovës, që këto qasje të kihen parasysh edhe në Projektrezolutë të hyjnë, por edhe në strategjitë eventuale që bëhen për veriun.

Qasja e parë do të quaj qasje ligjore dhe duhet shumë të bëjmë të qartë dhe të diferencojmë qartë që vendosja e ligjit në pjesën veriore të Kosovës nuk ka të bëjë thjesht me qytetarët e asaj pjese, nuk ka të bëjë me qytetarët e tri komunave veriore. Ne nuk mund as nuk duhet të merremi me mendimet politike të qytetarëve serbë të Leposaviqit, Zubin Potokut e tjera. Vendosja e ligjit ka të bëjë me struktura të organizuara që financohen prej Qeverisë së Serbisë dhe vendosja e ligjit ka të bëjë me strukturat tjera të organizuara që kanë interes ekonomik dhe që e shfrytëzojnë mosfunksionimin e ligjit për

t'u pasuruar në kurriz të ligjit, për t'u pasuruar në kurriz të qytetarëve edhe serbë edhe shqiptarë të asaj pjese dhe të pjesës tjetër të Kosovës. Dhe, kërkojmë fuqimisht që Qeveria, bashkë me EULEX-in, të ballafaqohen me këto struktura, të organizuara dhe të financuara prej Serbisë, të ballafaqohen dhe jo vetëm me fjalë të ballafaqohen. Unë nuk kam dëgjuar kurrë në histori se grupet e organizuara kriminale kanë trokitur ndonjëherë në dyert e burgut dhe të thonë që erdhëm në të hyjmë në burg këtu. Çështja e vendosjes së ligjit është, dihet si është dhe dihet si vendoset ligji në një vend.

Qasja e dytë, do ta quaj qasje politike, që nuk ka të bëjë më me strukturat e organizuara, qofshin ato të paguara prej Qeverisë së Serbisë apo struktura të mafies, të kontrabandës e tjera, e tjera. Ne ende nuk kemi arritur që në atë pjesë të Kosovës të hapim një dialog të përhershëm, një dialog të përhershëm politik, një dialog të përhershëm ekonomik dhe një dialog të përhershëm social e ndoshta edhe etnik, të bëhen tryeza të përhershme të dialogut, të bisedimeve me njerëz, me struktura të ndryshme të shoqërisë tonë, të shoqërisë së Kosovës në atë vend, në atë pjesë të Kosovës dhe sidomos në tri komunat dhe duke përfshirë edhe Mitrovicën aty. Duhet të hapen këto debate, duhet të krijohen këto tryeza të bisedimeve që njerëzit të arrijnë, qofshin ata serbë apo shqiptarë t'i artikulojnë idetë e tyre, konceptet e tyre, kërkesat e tyre në mënyrë që politika pastaj të dijë si t'i trajtojë ato. Dhe, fuqimisht në këtë pikë tek qasja politike duhet të krijohet një strategji për investimet ekonomike në atë pjesë. Nuk besoj se mund të zgjidhet problemi ashtu qysh shihet nganjëherë sot me vendosjen e një familje, me ndërtimin e shtëpisë për një familje, sepse çështja është shumë më e gjerë. Nuk mund ta ndiej një familje shqiptare në veri veten të qetë, ose një familje serbe në pjesën jugore të qetë, nëse nuk krijohet mjedisi i mirë, mjedisi stabil dhe i qetë.

Dhe, çështja e fundit, do ta quaj qasje në krijimin e standardeve unike, çështja e serbëve në veriun e Kosovës është çështje e Kosovës, por njëkohësisht është edhe çështje e Serbisë, sepse serbët e Kosovës e kanë shtetin e tyre amë Serbinë, ashtu sikur që çështja e shqiptarëve në Kosovën Lindore, është çështje e Serbisë, por njëkohësisht është çështje e Kosovës. Mendoj se politika e Kosovës, në radhë të parë Qeveria, është koha kur duhet të ngrejë temën e krijimit të standardeve...

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Qamile Morina, le të përgatitet Zef Morina.

QAMILE MORINA: Faleminderit zoti kryetar,

Ministra,

Deputetë të nderuar,

Sot edhe dy vjet pas shpalljes së pavarësisë, ecuria e procesit të shtet ndërtimit të Kosovës, pa asnjë mëdyshje deri më tani është përshkruar dhe karakterizuar me shumë vështirësi, me ngecje, me probleme, me pengesa dhe shumë e shumë sfida. Mungesa e sundimit të ligjit, mos zbatueshmëria e Kushtetutës ka krijuar një gjendje të përgjithshme dehumanizuese në Kosovë, të një stabiliteti të brishtë, të shkallës kulminante të papunësisë, rritje të varfërisë, me një fjalë në një gjendje dhe situatë të një stabiliteti të dozuar, të dirigjuar dhe të mbikëqyrur në mënyrë rigoroze të një gjendje stagnante dhe rigjide në Kosovë. Realiteti dëshmon se në Kosovë kemi dy të këqija, shkelja dhe mosfunksionimi i Kushtetutës. Veriu i Kosovës mbetet pika më neuralgjike e mos zbatueshmërisë së Kushtetutës. Kështu, decentralizimi etnik që paraqet ri rregullimin territorial dhe jo sovranitet të tërësisë territoriale, mos kontrollimi i pikave doganore 1 dhe 31, funksionimi i taks-fri zonës në veri, me rentabilitet tejet të lartë ekonomik për Serbinë, i diferencave të gjertanishme të qeverisjes sonë, mungesa e vullnetit të

ballafaqimit të institucioneve tona me realitetin e ri që po e krijon Serbia në Kosovë dhe faktori ndërkombëtar, që është vetëm duke u përkujdesur që Kosova të jetë e qetë, të gjitha këto në fakt kontribuojnë që Kosova dalëngadalë po sigurt po krijon një realitet të ri e që fatkeqësisht po i ngjason Bosnjës.

Jam e lindur në Mitrovicë andej lumit Ibër dhe, natyrisht, duke u përvjedhur vizitohet vendlindjen time dhe ajo që është, që unë shoh atje, është më se zhgënjyese dhe e dhimbshme, dinjiteti dhe integriteti i qytetarëve të mitrovicas në veri, është i shkelur rëndë, me një jetë nën ankth, presion, pasiguri, si të burgosur në shtëpi, kurse neni 23 dhe 24 i Kushtetutës ju garanton dinjitetin dhe integritetin personal të qytetarëve.

Mitrovicën andej lumit Ibër, deputetë të nderuar, nëse vendosni ta vizitoni, do të duhet të përgatiteni për shumë befasi, ngase atje, në shtetin e Kosovës, do të gjeni përfaqësitë e ministrive të Serbisë që funksionojnë pa kurrfarë pengesash dhe këto nuk janë struktura paralele, por janë struktura të Serbisë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 46 garanton mbajtjen e pronës. Kjo nuk realizohet në veri, atje nuk mund të mbrohet pronë, ngase pronën tonë e kanë tjetërsuar dhe në pronën e shqiptarëve janë ndërtuar mbi dhjetëra banesa shumëkatëshe kolektive. Në veri, Qeveria e Beogradit pa pengesë blen pronat e shqiptarëve. Gjëja më e vogël që do të duhej të ishte bërë nga Qeveria jonë për qytetarët e Mitrovicës, për t'iu mbrojtur interesat e tyre, do të ishte duke zgjedhur dy anëtarët e Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë Kosovare të Pronave, që është dashur para dy viteve të emërohen. Kjo ka pasur reperkusione tek qytetarët e Mitrovicës, ngase nga viti 2007, Agjencia nuk ka mundur të bëjë asnjë lirim të pronës në pjesën veriore të Mitrovicës, ku kryesisht janë të uzurpuara pronat tona. Aso kohe kanë qenë të evidentuara 512 pronat të shqiptarëve në veri, dhe zoti e di sa pak janë mbetur tani pa u shitur.

Prandaj, me shumë të drejtë këta qytetarë ndihen të tradhtuar, të braktisur nga institucionet tona. Neni 54, qytetarëve të Republikës së Kosovës u garanton mbrojtje gjyqësore dhe të drejta njerëzore, por realiteti është se në veri nuk ka gjykata për shqiptarët, ata shtrëngohen të bredhin poshtë e lartë për mbrojtjen e të drejtave më elementare nga fusha e drejtësisë, gjyqësisë. Pengesë për funksionimin e kësaj gjykate është se Ministria e Drejtësisë së Serbisë i ka ngritur tri çështje për të cilat do të vazhdojnë negociatat me EULEX-in. Territorin mbi të cilin shtrihen kompetencat e Gjykatës së Mitrovicës, së dyti, çështja e Gjykatës së shkallës së dytë dhe e gjykatësve në të dhe, së fundi, çështja se cili ligj do të zbatohet dhe kjo nuk do koment. Është shumë evidente ...

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Zef Morina, le të përgatitet Adem Salihaj.

ZEF MORINA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Sot është një debat mjaft i rëndësishëm dhe për këtë arsye mendoj që vëmendja jonë ka qenë dashur të jetë pak më e përqendruar, por sido që të jetë, për 5 minuta është vështirë të elaborohen të gjitha ato që duhet thënë, andaj unë do të mundohem të jem shumë i shkurtër, ndërsa materialin do t'ia dorëzoj Administratës për ta arkivuar.

Problemi i veriut të Kosovës dhe i disa pjesëve të saj, ku janë të banuara me minoritarë serbë, është një problem i trashëguar që nga viti '99. Të gjithë e dimë që nga korriku '99

deri me 17 shkurt 2008, Kosova ka qenë e administruar dhe është administruar nga UNMIK-u, pra UNMIK-u ka qenë administratori kryesor, ndërsa institucionet e Kosovës, natyrisht që i kanë dhënë sugjerimet e veta, i kanë dhënë kërkesat dhe vërejtjet e saja, të cilat herë pas here edhe nuk janë marrë parasysh. Më kujtohet nga parlamenti i kaluar dhe i legjislaturës së parë, kur janë nxjerrë dy rezoluta, të cilat UNMIK-u në atë kohë i ka anuluar brenda 30 minutave. Pas shpalljes së pavarësisë, Kosova është shtet, ka Kushtetutën, ka ligjet, të cilat duhet të respektohen në mbarë territorin e Kosovës. Këtë të gjithë e dimë dhe nuk kemi nevojë ta themi ashtu, siç po flitet këtu, vetëm për ta deklaruar. Ajo që është me rëndësi, ne duhet të jemi unik, të mos mundohemi që për interesa qoftë partiake, qoftë të interesave të ngushta, ta fajësojmë opozitën apo dikë tjetër për punën që nuk ka mund të kryhet deri tani. Tani ne, mendoj që jemi në një rrugë të mirë. Qeveria e Kosovës, institucionet e Kosovës bashkë me ICO dhe EULEX-in e kanë përgatitur një draft, një strategji, e cila mendoj që është në rrugë të mirë për t'u zbatuar dhe duhet mbështetur, sepse në këtë mënyrë jam shumë i sigurt që gradualisht edhe pjesa e cila tani për tani është nën, të themi, administrimin e strukturave serbe, ajo është pjesë e Kosovës dhe nuk mund të tjetërsohet dhe nuk mund të ndahet.

Me këtë rast dëshiroj që të paraqes disa kërkesa të cilat rrjedhin nga Demokristianët e Kosovës, pra nga populli i Kosovës.

1. Në tërë territorin e Kosovës të zbatohet Kushtetuta dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Kjo duhet të bëhet me dije edhe të jetë në strategjinë të cilën ne duhet ta kemi, për ta miratuar.

2. Nuk ka dhe nuk do të ketë ndarje të territorit të Republikës së Kosovës.

Nën 3. Nuk mund të ketë biseda për statusin, as konferencat që po flitet, të stilit të Dejtonit.

4. Nuk duhet të lejohet më ndërhyrja e Beogradit në punët e brendshme të Republikës së Kosovës.

5. Të kërkohej nga Bashkësia ndërkombëtare që ta detyrojë Serbinë të ndërpres agresionin politik ndaj Kosovës, duke ia kushtëzuar me hyrjen në Bashkimin Evropian.

6. Që të ulet Prishtina dhe Beogradi, si dy shtete fqinje dhe të barabarta, për të zgjidhur çështjet që kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve të dy shteteve, dhe e fundit.

7. Kërkojmë nga qytetarët serbë të Kosovës të mos bien nën ndikimin e politikës së Beogradit, por t'i kthehen realitetit, sepse janë shtetas të Republikës së Kosovës dhe të drejtat dhe obligimet i kanë ndaj shtetit të Kosovës.

Unë me këtë po e përfundoj, meqenëse materiali është shumë më i gjatë dhe nuk të dëshiroj të mbetet fjalimi në gjysmë. Materialin do t'ia dorëzoj Sekretarisë. Ju faleminderit!

Pjesë e bashkangjitur e diskutimit të deputetit Zef Morina

Të nderuar zonja e zotërinj,

Kaluan më shumë se 10 vjet që Kosova është e lirë, e cila u lirua nga robëria shekullore serbo-sllave. Populli i Kosovës me shumë se një shekull kishte luftuar për një Kosovë të lirë dhe të pavarur.

Në korrik të vitit 1999, në Kosovën e lirë u vendos administrata ndërkombëtare, e cila kishte për detyrë të administrojë Kosovën në tërë territorin e saj dhe të përgatisë institucionet vendore për të udhëhequr vet me shtetin e Kosovës. Përgjegjësia e UNMIK-ut ishte për të vënë rend dhe ligj në tërë territorin e Kosovës.

Ne i jemi mirënjohës faktorit ndërkombëtar, UNMIK-ut, KFOR-it, OSBE-së etj., për të gjitha që ka bërë për të mirën e Kosovës, sepse pa ndihmën e tyre ne nuk do të arrinim deri këtu, por edhe suksesin edhe dështimet tani po i përjeton populli i Kosovës. Fatkeqësisht, UNMIK-u nuk kishte vullnet të plotë të vepronte në pjesën veriore dhe në disa pjesë të Kosovës të banuara me minoritarë serbë, ashtu si e kishte mandatin dhe për çka populli e kishte pritur duar hapur. UNMIK-u nuk arriti të shtrijë administrimin ligjor në këto pjesë të Kosovës, duke ju lënë hapësirë strukturave ilegale të dirigjuara nga Beogradi për të vepruar kundër interesave të Kosovës dhe popullit të saj.

Këto grupe ilegale ushtruan dhunë dhe terror ndaj popullatës shqiptare në ato anë, duke i detyruar të braktisin vatrën e tyre dhe që nga ajo kohë strukturat ilegale serbe kishin për qëllim dëbimin e shqiptarëve për të krijuar zona etnikisht të pastra serbe, duke krijuar terren për shpëputjen e kësaj pjese nga Kosova dhe për t'ia bashkuar Serbisë, që do të rezultonte me ndarjen e Kosovës.

Disa herë institucionet e Kosovës kërkuan nga UNMIK-u që të merren masa të nevojshme për të normalizuar situatën në ato pjesë, por kjo nuk ndodhi sepse vet UNMIK-u nuk kishte vullnet për ta bërë një gjë të tillë, bile kemi rastin kur i arsyetonin veprimet e tyre.

Rasti i cili i trimëroi më së shumti bandat serbe ishte e ashtuquajtura marrëveshja Hakerup – Qoviq, e cila u hodh poshtë nga të gjitha partitë politike dhe populli i Kosovës.

Kemi shembull tjetër, ku ish administratori i Mitrovicës z. Galluqi, haptas përkrahte strukturat paralele dhe nuk i bënte përshtypje reagimi i institucioneve qendrore dhe komunale të Kosovës, bile nuk pranonte këshilla as nga shefi i tij nga PSSP-ja. UNMIK-u e kishte të qartë se Beogradi ishte organizatori i të gjitha këtyre veprimeve, por nuk arriti të bind Beogradin se Kosova tashmë ishte përfundimisht e shpëputur nga robëria e saj.

Pas shpalljes së pavarësisë, më 17 shkurt 2008, gjërat kanë ndryshuar. Tash Kosova është shtet i pavarur dhe sovran, i njohur nga 65 shtete të botës, ka Kushtetutën dhe ligjet e saja, andaj institucionet kanë përgjegjësi të plotë për të zbatuar Kushtetutën dhe ligjet në mbarë territorin e saj.

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Adem Salihaj, le të përgatitet Ahmet Isufi.

ADEM SALIHAI: Zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Zoti ministër, i vetëm që ka mbetur këtu,

Do ta kemi vështirë për 5 minuta të themi atë që kemi dëshiruar dhe është interesant që sa herë kemi një debat interesant, që është interesant për opinionin dhe për qytetarët, kufizohet shumë koha e debatit.

Unë do të filloj me çështjen e terminologjisë që e përdorim. Së pari, përdorimi i termit “Veriu i Kosovës”, me “V” të madhe, që tregon se është një nocion që paraqet një tërësi gjeografike, një provincë, edhe në kuptimin gjeografik dhe politik është i gabueshëm dhe do të ishte mirë që të mos përdoret.

Së dyti, çështja e strukturave të Serbisë në Kosovë, shpesh e përdorim termin: “strukturat paralele”. Në disa pjesë të Kosovës ato janë struktura paralele në Shtërpcë, në Graçanicë, në disa tjera, ku i kemi edhe institucionet tona lokale dhe qendrore, por në pjesën veriore të Kosovës, matanë Ibrit nuk janë struktura paralele, por janë institucione e shtetit të Serbisë të vendosura aty dhe janë të vetmet që ekzistojnë aty. Pra, Kosova nuk është aty prezente si shtet me asnjë institucion, as të nivelit lokal, as të nivelit qendror, as me gjykata, as me polici, as me dogana, bile as edhe me shërbime publike të ndërmarrjeve publike të ndryshme. Prandaj, mund të themi që atje Serbia i ka të gjitha institucionet e saja shtetërore sikur të ishte një territor i mirëfilltë i Serbisë, i ka komunat, i ka ministritë, i ka gjykatat, prokuroritë, shërbimet publike, bile, bile ndoshta i ka edhe policinë, sado që nuk e ka me uniforma. Një aspekt tjetër që është shumë shqetësues në atë pjesë, është mungesa e pushtetit dhe është shndërruar kjo pjesë në një parajsë për krimin e organizuar, e cila kontrabandon mallra edhe për Serbi, edhe nga Serbia në Kosovë. Madje janë edhe disa informata interesante se një person që është apostrofuar shumë si person i krimit të organizuar, e që është në krye të Trepçës, për çdo ditë ose ia falë ose ia shet, ne nuk e dimë saktë, por kam një informatë se diku rreth 50 kamionë të mëdhenj me xehe plumbi dhe ari të Trepçës shkojnë për Serbi. Kur e dimë qëndrimin e Serbisë se nuk lejon import të mallit nga Kosova, është e çuditshme se si ndodhë kjo. A shiten, a shitet ajo xehe, a falet apo Serbia vjen e merr sikur në territorin e vet dhe ndoshta e trajton këtë pjesë si territor të saj.

Janë këto çështje që duhet ta shqetësojnë jo vetëm këtë Kuvend, por edhe Qeverinë e Kosovës dhe qytetarët dhe unë mendoj se është një qasje shumë e gabueshme e shumë kolegëve të pozitës dhe të vetë Kryeministrit që në njëfarë mënyre ua mohon të drejtën deputetëve të opozitës që të jenë patriotë. Është një qasje shumë e gabueshme dhe shumë fyese, të mos them që është një qëndrim i ulët që nuk duhet të shfaqet këtu në Kuvend. Patriotizmi nuk është monopol i askujt dhe secili e ka të drejtën që ta dojë aq sa mundet vendin e tij dhe shtetin e tij. Dhe një çështje tjetër. Ne e kemi marrë një material, nuk e di prej Qeverisë, ndoshta, që quhet – Përmbledhje e Strategjisë për veriuin e Kosovës, pra edhe këtu termi “veriu” shkruhet me të madhe si nocion gjeografik dhe politik dhe unë habitem me formulimet e atij materiali, të cilat janë lënë në atë formë që as nuk obligojnë askënd, as nuk përcaktojnë asgjë, nuk ka asnjë afat, asnjë mekanizëm, nuk ka asgjë konkrete që do të duhej të zbatohet atje. Po i marrë disa fjali: Në faqen 2, thotë: “Kontrolli i plotë doganor në veri, duhet të vendoset në kohë të përshtatshme”. Kur është kjo kohë e përshtatshme? Kur të fillojë mbledhja e të hyrave, ato do të duhej të dredhen tek institucionet vendore, kur të fillojë, do të thotë, krejt e papërcaktuar. “Data e zgjedhjeve në Mitrovicën e Veriut, duhet të caktohet në bazë të situatës në terren”, krejt e papërcaktuar. “Zgjedhjet e reja duhet të mbahen kur një gjë e tillë të jetë praktike”, asgjë konkrete, asnjë afat, asnjë mekanizëm, asnjë obligim i Qeverisë së Kosovës që do të bëjë diçka serioze në këtë drejtim.

Ju do të kërkonte kot në këtë material çfarëdo strategjie për pjesën veriore të Kosovës. Nuk është thënë asgjë, është thjeshtë një përpjekje për mashtrim dhe manipulim të opinionit, një përpjekje për ta hartuar një dokument për të mos bërë asgjë. Madje

formulimet janë të atilla, që në asnjë mënyrë të mos përfshijnë diçka konkrete, diçka që do të duhej zbatuar në praktikë.

Në fund të këtij, ta quajmë, dokumenti, është një pasus i cili në vend që të na qetësojë, na shqetëson. Këtu parashihet formimi i një forumi të ndërkombëtarëve, i quajtur Bordi i Politikave për Veriun e Kosovës. Problemi qëndron te fakti se pjesa veriore e Kosovës trajtohet si një tërësi e veçantë në kuptimin politik, ku duhet aplikuar politika të veçanta, e jo zbatimin e ligjit dhe të Kushtetutës së Kosovës. Si nocion, në vazhdimësi përdoret termi “Veriu i Kosovës”, në kuptimin gjeografik, por edhe politik. Ndoshta ky edhe është qëllimi kryesor i kësaj, ta themi, strategjie.

Në fund, dëshiroj të them se Kosovës i duhet një strategji vërtet e zbërthyer në plan veprimi, me masa konkrete, me bartës të përgjegjësive, me masa konkrete, me bartës të përgjegjësive, me mekanizma dhe afate konkrete dhe me një qëllim final – vendosjen e pushtetit shtetëror, të ligjit dhe të Kushtetutës në këtë pjesë të Kosovës.

Përndryshe, rekapitullimi në fund se qëllimi kryesor i kësaj strategjie është “promovimi i bashkëpunimit ndërmjet veriut e jugut për shërbimet publike, siç janë furnizimi me ujë, energjia elektrike dhe ngrohja qendrore...”, është një rekapitullim qesharak, që e banalizon deri në skajshmëri këtë të ashtuquajtur strategji, për ta përfunduar duke mos thënë asgjë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi, le të përgatitet deputeti Jakup Krasniqi.

AHMET ISUFI: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sa ndjehet si serioze kjo temë me këtë prezencë të Qeverisë, veç po vërehet. Vetëm një ministër e kemi këtu prezent dhe po ashtu u theksua edhe më herët që kjo mbledhje është thirr për zbatueshmërinë e Kushtetutës në pjesën veriore të Kosovës.

Dhjetë vite kanë kaluar dhe gjendja nuk ka ndryshuar, përkundrazi është keqësuar në raport me vitet kur ka administruar UNMIK-u në Kosovë, e ka pasur jo Qeveri të Kosovës, të quajtur, por institucione vetëqeverisëse, prandaj dallimi është se nuk duhet bërë krahasimet prej 17 shkurtit e këndeje me qeveritë të cilat, në fakt, kanë qenë shumë të kufizuara në veprimin, në zbatimin e politikave të tyre institucionale. Do të ishte e njëjta sikur ato qeveri nën administrimin e UNMIK-ut ta krahasonin me gjendjen e paraluftës, nuk është mirë kështu.

Prej 17 shkurtit në Kosovë gjendja ka ndryshuar, prandaj të gjitha përgjegjësitë për funksionimin e Kushtetutës së Kosovës në territorin e Kosovës janë të Qeverisë, janë të institucioneve të cilat ndihmojnë në nivelin ndërkombëtar, prandaj nuk mund t'i iket përgjegjësisë. Ne e kemi një përmbledhje të një strategjie që është ofruar sot e që nuk është strategjia ajo e cila është prodhim i ICO-s në dhjetor, e që në fakt i është ofruar si obligim Qeverisë që të jetë pjesëmarrëse e zbatimit të saj.

Prandaj, konsideroj që jo një pjesë e ministrive, siç thuhet në dokument, disa ministri duhet të involvohen, por duhet të involvohet Qeveria komplet, sepse ka të bëjë me territorin e vet, me qytetarët e vet në këtë territor dhe me gjithë ekzistencën që është brenda këtij territori.

Konsideroj se në terminologji ekzistojnë sinonime, por në këtë rast do të thosha se nuk ka struktura paralele në veri, sepse nuk kanë me kë të jenë paralele. Aty ka instalim të mekanizmave institucionale të Serbisë, që me një fjalë mund të quhen agresion nga një shtet në shtetin tjetër. Është më mirë të definohen qartë edhe termat që përdoren në kontekstin e tashëm.

Po e dëgjojmë shpeshherë fjalën këtu, sidomos nga një pjesë e Qeverisë, për përdorimin e dhunës. Ju lutem, nuk ka nevojë të përdoret ky term, sepse ne edhe në Kuvendin e Kosovës, edhe qytetarët e Kosovës, edhe Kushtetuta na obligon ta zbatojmë ligjin në gjithë territorin e Kosovës, të zbatohet Kushtetuta dhe si bëhet kjo, janë mekanizma të cilët e bëjnë këtë veprim, sepse po del sikur po bëhet edhe një diskriminim ndaj qytetarëve të Kosovës. Çfarë sinjali është ky për kriminelët në veri, nëse thuhet nuk do të përdoret dhuna. Është, bëni çka të doni atje, se ne nuk e kemi ndërmend të ndërmarrim kurrëgjë. Nuk është sinjal i mirë. Nuk është mesazh që duhet të dërgohet nga Qeveria e Kosovës dhe nga institucionet e vendit. Duhet të thuhet konkret – zbatohet ligji, zbatohet Kushtetuta me gjithë mekanizmat përcjellës. Po ashtu, konsideroj se bëhet një diskriminim ndaj qytetarëve tjerë. Ju e dini se është përdorë dhunë në Kosovë, është përdorë ndaj Lëvizjes “Vetëvendosje”, është përdorë ndaj njerëzve që në mënyrë paqësore kanë protestuar, e pse atëherë bëhet ky krahasim? Në cilëndo kohë, po e them, 10 vite janë të ekzistimit tonë këtu. Prandaj, konsideroj se duhet të kihet kujdes, e sidomos kur flasim për pjesën veriore të Kosovës, që është interes i të gjithë neve, pavarësisht pozitë – opozitë. Nuk është mirë të fyhen deputetët – a janë patriotë a nuk janë, sepse nuk është mënyrë e sjelljes së mirë kjo. Në fund të fundit, të gjithë e duam Kosovën dhe kemi nevojë që ta kemi të tërën, ashtu siç na e përcakton Kushtetuta e jonë. Nëse i ka mbetur dikujt merak ta masë patriotizmin, le ta formojë në departament qysh janë formuar departamente tjera, edhe Departamenti Antikorrupsion, që e keni parë në raportet, vazhdues e kemi që Qeveria është në shkallën e parë të korrupsionit....

KRYETARI: Ju faleminderit! Edhe unë do t’i them disa fjalë.

Më lejoni që edhe unë t’i them pak fjalë si deputet. Fillimisht, vërtet, edhe për mua është e pakuptimit pse Qeveria nuk ua ka sjellë në Kuvend deputetëve dokumentin e strategjisë, megjithatë e kemi një ekstrakt dhe i kemi qëllimet se çka do të arrijë Qeveria.

Më lejoni që t’i them dy gjëra, para se ta them atë për të cilën jam përgatitur të flas sot. Nën një, mendoj që Serbia mund të emërojë gjyqtarë edhe në Mars, nëse mund t’i çojë, le t’i çojë. Mendoj që efekti i atyre gjyqtarëve dhe i atij sistemi në Kosovë nuk do të ketë efekte, nuk do të prodhoj efekte, mund të prodhoj efekte që janë në dëm të qytetarëve serbë të Kosovës në tri komunat e pjesës veriore. Dhe, çështje tjetër, nëse vërtet në Kosovë edhe tani kjo pjesë me tri komuna, një numër i kufizuar të qytetarëve paska qenë dhe qenka mbetur vrima kryesore e zezë e krimit dhe e kontrabandës, unë mendoj që është sukses edhe për Kuvendin, edhe për Qeverinë. Është tepër pak dhe nuk do të prodhoj përsëri efekte të mëdha as në buxhetin e Kosovës, por dua të them që nëse vërtet kemi arritur ta shtrijmë sundimin e rendit dhe të ligjit në gjithë Kosovën, në pjesën tjetër të Kosovës, mendoj se është një sukses i madh për institucionet tona.

Është një e vërtetë e madhe se sot po debatojmë për dy dokumente, ta them kështu, për kërkesën e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë dhe dokumentin për strategjinë. Është një e vërtetë e madhe se kur është bërë kërkesa e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, ndërkohë ka dal ky dokument – Strategjia për integritet të komunitetit serb në jetën institucionale, publike dhe shoqërore në Kosovë.

Megjithatë, mendoj se duhet t'i bëjmë bashkë se, në fund të fundit, konsideroj që edhe kërkesa e Lidhjes Demokratike të Dardanisë ka pasur për qëllim fillimin e vendosjes së një rendi, një sundimi të rendit dhe të ligjit edhe në një pjesë të Kosovës, ku Kosova nuk e ka të shtrirë pushtetin e vet. Ne askush këtu nuk e kemi iluzionin se në atë pjesë sundon rendi dhe ligji, se në atë pjesë Kosova e ka të shtrirë pushtetin e vet dhe ndikimin e vet. Por, unë kisha kërkuar nga deputetët, nga Kuvendi, si institucion më i lartë ligjvënës në Kosovë, mos ta paragjykojmë përpjekjen e Qeverisë së Kosovës, përpjekjen që është e bashkuar me përfaqësuesit civilë ndërkombëtarë dhe, natyrisht, që ka gjetur mbështetje nga Komiteti drejtues ndërkombëtar për Kosovën. Mendoj që ky dokument ka hasur në mbështetje edhe nga një pjesë e faktorit ndërkombëtar. Ky dokument paragjykohet nga Serbia, por nëse ky dokument paragjykohet nga Serbia, mendoj se nuk duhet të paragjykohet as nga deputetët, as nga pozita, as nga opozita, as nga qytetarët e Kosovës. Mendoj që mesazhi më i mirë që ne ia japim qytetarëve tanë, faktorit ndërkombëtar në Kosovë, është që përpjekja jonë institucionale është për të integruar që të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës në jetën institucionale, politike dhe publike në Kosovë, se institucionet e Kosovës dhe qytetarët e Kosovës janë dhe do të mbesin fuqishëm në mbrojtje të tërësisë territoriale të Kosovës, se Kosova është shtet i pavarur, sovran dhe demokratik. Unë në këtë nuk dua të dyshoj. E di që kemi vështirësi për të vendosur rend dhe ligj në atë pjesë, por objektiv dhe qëllim i yni, edhe i Kuvendit, edhe i Qeverisë, edhe i partive politike, edhe opozitës dhe çdo qytetari është për të integruar dhe për t'i trajtuar të gjithë qytetarët e Kosovës si qytetar të Republikës së Kosovës. Jemi të bindur që me funksionimin e strukturave të pushtetit të Serbisë në Kosovë, deri më tani më së shumti kanë humbur dhe do të humbin qytetarët serbë të Kosovës, të asaj pjese të Kosovës.

E kemi një nismë pas zgjedhjeve të 15 nëntorit, e kemi një nismë të mirë, ka filluar një integrim i ri i qytetarëve serbë të Kosovës në jetën institucionale në Kosovë. Nga ne e ka mbështetjen, nga ne do ta kenë mbështetjen dhe të gjitha angazhimet tjera edhe të Qeverisë, edhe të qytetarëve serbë të pjesës verore të Kosovës për t'u integruar dhe për të krijuar institucione dhe, në fund të fundit, qytetarëve serbë të Kosovës ne nuk duhet t'ua imponojmë zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre, le t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre për të qeverisë në komunat që ata e përbëjnë shumicën dhe kjo neve nuk na pengon. Ne nuk dëshirojmë që Republikën e Kosovës ta bëjmë siç në të kaluarën Serbia ka vepruar me të drejtën tonë, të vendos një kufi të hekurt mes shqiptarëve të Shqipërisë dhe shqiptarëve të Kosovës. Nuk e kemi atë synim që të vendosim kufi të hekurt në mes të serbëve të Kosovës dhe serbëve të Serbisë, por serbët e Kosovës duhet të binden se e kanë mbështetjen tonë për të qenë qytetarë të barabartë me çdo qytetarë tjetër të Kosovës, në Republikën e Kosovës. Mendoj, këto duhet të jenë mesazhet që i japim ne edhe për të treguar se ne e kemi vendosmërinë për ta ruajtur çdo pjesë, çdo pëllëmbë të hapësirës territoriale të Kosovës. Po, në fund të fundit, nëse dikush mendon të grabisë pjesë të Kosovës, duhet ta dijë që edhe shqiptarët në Kosovë edhe jashtë Kosovës kanë kërkesa tjera. Megjithatë, ne jemi pajtuar si Republikë e Kosovës, në koordinim me faktorin ndërkombëtar, që t'i pranojmë kufijtë ekzistues që i ka Kosova dhe se këta kufij janë të paprekshëm. Ne nuk duam të krijojmë konflikte, por edhe të tjerët duhet ta dinë se nuk mund t'i prekin kufijtë e Republikës së Kosovës. Për ata jemi ne këtu dhe ky mesazh duhet t'u shkojë të gjithëve, edhe atyre që jetojnë brenda Kosovës, edhe atyre që jetojnë jashtë Republikës së Kosovës. Ky është obligimi ynë. Oferta jonë është serioze, ne presim dhe duhet ta presim një vit, qoftë nevoja edhe dy vite, që kjo Qeveri me përfaqësuesit civilë ndërkombëtarë, me EULEX-in dhe me faktorë të tjerë që janë në shërbim të vendosjes të paqes, të rendit dhe të sundimit të ligjit në Kosovë, t'i presim dhe kemi vendosmërinë për të pritur, kemi pritur bukur gjatë, do të presim që të vendoset

rendi dhe ligji edhe në një pjesë të Kosovës, që nuk pajtohem që janë 20%-shi, se na jetë shume e vogël pjesa tjetër e Kosovës. Ajo mund të jetë diku 12-13%, por jo mëshomë, as mos ta zvogëlojmë problemin, as mos ta zmadhojmë. Ne jemi këtu për të bërë një ofertë serioze para qytetarëve tanë. Deri më tani kemi treguar seriozitet se ne jemi për një shtet demokratik me qytetarë të barabartë dhe se qytetarët nuk i ndajmë mbi baza etnike. Mendoj që thirrja jonë, përpjekja e Qeverisë dhe ne si institucion duhet ta mbështesim këtë dokument dhe pastaj duhet t'i shikojmë hapat tjerë dhe t'i përcjellim hapat tjerë që i bë Qeveria në realizim të këtij dokumenti ose të këtij plani të veprimit, që unë ndoshta nuk do ta kisha quajtur strategji. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Shkumbin Demaliaj, le të përgatitet Rita Hajzeraj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues! Ministër, dua të ta jap dorën. Po e bëj këtë, se i kam thënë javën e kaluar se duhet të japë dorëheqje, se është kah punon me njerëz të papërgjegjshëm, për respektin që e kam profesor, e mos ta lë këtu, se një profesor doktor të rrijë këtu gjatë gjithë kohës e të tjerët me vandalizma të dalin jashtë, duke e lënë sot Kuvendin në mëshirën e fatit. Ne jemi çoroditur, sepse jemi në qorrsoak, qorrsoaku dihet.

Të gjitha, këto segmente duam t'i lëmë se kush është patriot e jo, se kam gabuar javën e kaluar, e kam bërë kryetar të komisionit kryeministrin e Kosovës, po duam ta shkarkojmë sot për vlerësimin e patriotëve. Në emër të patriotizmit, të gjitha këto vlera që i ka ky Kuvend dhe i kanë këto institucione, por edhe historikisht, po vijë nganjëherë në vetëdijen time, them se mbas Luftës së Dytë Botërore nuk ekziston më patriot. Sikur t'ia heqësh baterinë telefonit, është bërë kjo Qeveri, a funksionon ajo – jo. Më vjen shumë keq për koalicionin qeverisës, se edhe sot po e qesin në lajthim Kuvendin. Ne nuk dimë se për cilën pikë jemi kah debatojmë, a për pikën me kërkesën e LDD-së, apo për strategjinë për veriun, që nuk kemi strategji.

U tha nga të gjithë se na nuk posedojmë një dokument të strategjisë për veriun edhe pse në kuadër të këtij dokumenti, që u tha më herët, ekziston Veri – Jug, që ne ende me ligj nuk kemi ndarë diçka të tillë. Ndërkaq, lidhur me koalicionin e thashë me qëllim, se e tha kryeministri më herët se përgjegjës kanë qenë edhe qeveritë e mëhershme.

Në vitin 1999, me vendosjen e Qeverisë së përkohshme, a dini cili ka qenë vendimi i parë i Qeverisë Thaçi, në Qeverinë e përkohshme – i ndalohej kthimi në Kosovë presidentit Ibrahim Rugova, i cili ia la një parti sot. Ai është vendimi kryesor, nuk ka pasur të merret me veriun, a sot LDK-ja është shndërruar në marionetë të këtij kryeministri që ia ka ndaluar presidentit, kryetarit të tyre të ndalohej në Kosovë dhe sot këta janë dal eksperiment në tavolinë. Na duam të flasim kështu, në qoftë se e kemi zgjedhur, pse nuk duam të dalim në lajthim, nuk duam ta qesim popullin në lajthim, sepse ne nuk e kemi asnjë analizë, as pasqyrë se si është gjendja në veri të Kosovës...

KRYESUESI: Shkumbin, rri në rend dite, të lutem!

SHKUMBIN DEMALIAJ: ... i nevojitet, se ne nuk kemi asnjë pasqyrë e asnjë analizë se çka mbretëron në veri të Kosovës, çfarë gjendje është atje, duam të bisedojmë për një strategji që e ka shpikur Qeveria Thaçi. Ku është ajo strategji? Çka dimë na për veriun, çka dimë kush jeton atje, a jetojnë strukturat paralele, që kryeministri vet ka thënë se nuk ka, ka punë me disa individë, atëherë kjo Qeveri le të deklarohet a është për biznes,

apo është për t'i drejtuar institucionet edhe qytetarët e vendit. Le të deklarohet me kohë, a është Qeveri e biznesit, apo është Qeveri për ta udhëhequr këtë vend. Në qoftë se detyrimisht duhet të deklarohet, ne e dimë se bashkësia ndërkombëtare është këtu, pavarësia jonë është e monitoruar, është e monitoruar, mos të sillemi si Ismail Qemala e Skenderbega, por është e monitoruar pavarësia jonë, ata janë këtu dhe kanë për ta monitoruar derisa ne të vetëdijesohemi, e kam thënë, se kur përdoret fjala ligj, duhet t'i rrëqethen flokët njëherë e pastaj për ta futur sundimin e ligjit.

Tjetra, duhet ditur shumë mirë, po e di se jeni bërë nervoz, neve na ka thënë kryeministri, por ne nuk jemi bërë nervoz. Neurozën akumuloheni, ruajeni, nuk ka dert, këto i dinë krejt qytetarët e Kosovës. Tjetra është se kjo Qeveri duhet të shkojë në shtëpi se nuk është kah mund t'i kryej punët e veta. Edhe me këtë formë, pa e pru analizën dhe gjendjen që mbizotëron në veri, unë kërkoj prej të gjithë deputetëve që mos të mos debatojnë këtu. Atëherë, nuk jemi kah bisedojmë për qytetarë të Serbisë, jemi kah bisedojmë për territorin e Kosovës, edhe qytetarët, edhe serbët e Kosovës. Krimi është i dënueshëm në krejt botën. Në këtë rast, unë jam anëtar i Komisionit për Siguri dhe Punë të Brendshme. Si komision kemi kërkuar herë pas herë të bisedojmë për strukturat kriminale, strukturat paralele e tjera, por kjo Kryesi e Kuvendit, në këtë rast e akuzoj edhe Kryesinë, por edhe Qeveria e kësaj Kosove gjithmonë që ia ka përgatitur agjendën këtij Kuvendi, nuk ka lejuar që të diskutohen ato probleme këtu, tani janë akumuluar, ta shohim se si do të jetë gjendja më vonë. Kërkoj falje, zoti kryesues, ndoshta pak..., por temperamentit dhe neuroza e deputetëve të pozitës më detyroi pak të jem edhe më i nxehtë. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Ju lutem, mirë është që të mos ofendohemi njëri me tjetrin. Ato që i thatë, konsideroj që janë shumica të pavërteta. Prandaj, me qenë se ke prekur në dy çështje për të cilat kanë të drejtë replike, ia jap fjalën anëtarit të Kabinetit të Qeverisë, zotit Arsim Bajrami dhe pastaj zotit Sabri Hamiti, edhe ai kërkon replikë.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Po më duket është mandati i parë për Shkumbinin, nuk e di a i pari, a i dyti. Unë e kisha sugjeruar, e kam pasur student dhe kam respekt si student, por e kisha sugjeruar që le ta lexojë mirë Rregulloren e Punës së Kuvendit, le ti shoh praktikën e debatit parlamentar, ekziston liria e debatit parlamentar, por kjo foltore nuk mund të merret, nuk mund të shfrytëzohet për fyerje, për fyerje personale, për zbrazje të inateve. Unë e kuptoj se mund të jeni të pakënaqur me punën e Qeverisë, apo do të donim sa më shpejtë ta ndërrojmë Qeverinë, por demokracia parlamentare e do që proceset të zhvillohen në rrugë demokratike. Do të keni zgjedhje në vitin ardhshëm, përgatituni dhe ejani në pushtet në mënyrë demokratike, jo duke linçuar, jo duke fyer, jo duke treguar nganjëherë edhe ligësi, sepse është një rregull parlamentare, nuk flitet për presonin që nuk është prezent. Është një rregull që kur të keni për të folur për dikë, është mirë të flisni në prezencë, jo kur ai nuk është prezent, kështu që i nderuari Shkumbin, të kisha sugjeruar që foltoren mos ta shfrytëzosh për zbrazje të mllefeve apo të inateve personale dhe t'i respektosh rregullat e lirisë së debatit parlamentar. Është përdor në fjalimin tënd edhe gjuhë jo parlamentare dhe gjuhë që nuk është për këtë parlament. Kështu që ju kisha lutur...

(ndërhyrje nga salla)

... nuk jam profesor, mirëpo u thirra si profesor të flas, u thirra si profesor të flas dhe kam të drejtë që në emër të Qeverisë që të kërkoj nga kryesuesi i Parlamentit që të

distancohet nga ky fjalim dhe t'i ndalojë fjalimet e tilla që shkelin gjuhën parlamentare dhe lirinë e debatit në parlament.

KRYESUESI: Zoti Hamiti e ka fjalën.

Zoti kryesues Haliti, mua më është përmendur emri nga dy herë, unë nuk kam dashur të bëj replikë, kam menduar se sot na duhet substanca, jo retorika e raporteve. Megjithatë, edhe ajo që thashë unë, në një mënyrë është parafrazuar nga dy diskutues dhe unë dola këtu më së pari zotit Demaliaj t'i them, në rregull është ajo, është e drejta e tij që të provokojë eventualisht reagime. Është e drejta e tij dhe unë nuk dua të hyjë atje, por meqë po dua të koncentrohem vetëm në atë për çka po bisedojmë sot, nëse ai ka dëgjuar mirë edhe shefin grupit dhe mua, vogëlsinë time, nëse më ke dëgjuar mirë, do të duhej ta respektojë, jo sepse janë unë që kam insistuar në diskutimin e saktë të materies, nën një. Në dy, për ta vazhduar tutje idenë time, meqë m'u dha rasti, sepse më replikat në temë, unë po ju them që Grupi ndërkombëtar drejtues për Kosovën, që është mbajtur më 8 shkurt 2010, në Vjenë, në Austri, në pikën 3 ka mendim për problemet që po shtrohen këtu, ku thuhet saktë: "Ky grup mbështet plotësisht domosdoshmërinë e përforcimit të përpjekjeve për Veriun e Kosovës, duke marrë parasysh rekomandimet e ICO-s, duke marrë parasysh të gjitha palët e interesuara", do me thënë ekzistojnë disa palë, jo një, thotë grupi ndërkombëtar në pikën e vet të 3-të të dokumentit dhe tutje vazhdon: "ky grup e mirëpret synimin e Qeverisë së Kosovës për të ofruar financime për projektet e përmendura". Çfarë dua të them unë? Që...

KRYESUESI: Edhe një minutë, zotit Hamiti!

SABRI HAMITI: Nuk po replikoj, por po e plotësoj diskutimin tim, sepse i kisha krejt 5 minuta, po e plotësoj. Pra, ajo që ne po diskutojmë sot, është materie që nuk i takon vetëm Kuvendit, sepse nuk ka fuqi ekzekutive Kuvendi as Qeveria ta kryejnë. Këtu u tha, më duket Lajçi e tha, nuk duhet të themi - përdorim dhunë ose jo dhunë, nuk duhet të themi, pajtohem plotësisht, sepse edhe sundimi i ligjit i ka instrumentet e detyrimit. A i ka ky Kuvend, a i ka Qeveria instrumentet e detyrimit të sundimit të ligjit në X territor, tash nuk po e përkufizoj hiq.

Prandaj, unë thashë në fillim dhe mbetem edhe në fund, një plan që nuk është i parë në detaje kështu, ndoshta edhe nuk duhet të jetë i parë në detaje, i ka dy prodhues, nëse ka ICO...

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Ramë Buja e ka fjalën, për replikë.

RAMË BUJA: Sinqerisht, po më vjen keq prej kolegëve të nderuar deputetë, që po e marrë fjalën për herë të dytë, por kur shpifet, nuk kam qare pa reaguari sepse, në fakt, edhe shpreh keqardhje ndaj zotit Shkumbin Demaliaj,, sepse po shpif në mënyrë më të vrazhdë të mundshme, sepse asnjëherë nuk ka asnjë letër, as dokument që ia ka ndaluar dikush dikujt ndonjëherë hyrjen në Republikën e Kosovës, ose nuk ishte Republikë atëherë ende e shpallur. Andaj, për këto gjëra, njeriu shkon në gjyq dhe mua më vjen tepër keq, sinqerisht tepër keq për ju, zoti Shkumbin Demaliaj, që shpreheni kështu pa asnjë argument dhe me temperament shumë të çuditshëm dhe tepër të veçantë. Është e vërtetë që ju do të duhej t'i mblidhni forcat, të fitoni votën dhe pastaj ne jemi të bindurit e votës dhe gjithsesi reagojmë me racionalitet, qysh duhet reaguari. Mua më vjen keq edhe për një reagim të para ditës, kur u fye institucioni i quajtur Kryeministri i Kosovës, por thonë - i fyeri të fyer, andaj kjo thënie, nuk ka çka t'i shtohet kësaj. Ju faleminderit shumë.

KRYESUESI: Ju faleminderit, një minutë zoti Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Zoti kryesues, më vjen keq që duhet të replikoj, por për ngjarjet që fola unë, e dinë jo vetëm mbarë qytetarët e Kosovës, por e dinë ndoshta edhe armiqtë tanë se si kemi vepruar, se të ishte një unifikim i tillë me probleme që sot neve na preokupojnë pas dhjetë vjetëve, ne ishim më mirë në këtë gjendje, sepse nuk e kemi pranuar njëri tjetrin. Ndërkaq, për problemin e votave, ajo është shenjë e demokracisë, ndërkaq te gjyqësia, ne e dimë çfarë gjyqësie kemi sot dhe çfarë gjyqësori, sepse është reformuar gjyqësia, pikërisht edhe prej kësaj qeverisje edhe unë, nuk ka nevojë, se nuk i frikohem askujt, sepse deliktet verbale janë delikte verbale edhe atë mund ta them kështu, se i gjithë Grupi Parlamentar i juaji veç që s'më hipi në foltore, por nuk mbërrini. Në qoftë se ka nevojë për qerim hesapësh, është rruga, nuk është Parlamenti. Edhe ajo mund të vijë, se jeni mësuar, por të më frikoni, mos t'ju hyjë mendja se mund të më frikoni, më së paku mua si deputet, por edhe si qytetar. Kalofshi mirë!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sot vërtet po flasim për dy çështje që është cenimi i integritetit dhe sovranitetit të Republikës së Kosovës, po ashtu si nevojë apo si pasojë e cenimit dhe e integritetit dhe të sovranitetit të Kosovës, ka lindur nevoja edhe për strategjinë të cilën tani po e debatojmë.

Mua nuk më habit fakti sepse edhe Grupi ndërkombëtar ka kërkuar rekomandime nga ICO, po ashtu ka kërkuar rekomandime dhe nga palët tjera dhe pikërisht këtu dua të lidhem, se palët tjera nënkuptojmë që janë edhe Qeveria e Kosovës, organizatat joqeveritare dhe institucionet tjera, po ashtu edhe Kuvendi i Kosovës.

I bëjmë thirrje edhe presidentit të Republikës së Kosovës, po ashtu edhe kryeministrit të Republikës së Kosovës, sepse është një prej çështjeve më relevante në vendin tonë dhe po ashtu do të duhej që të konsultohesh jo vetëm me partitë opozitare dhe pozitare, por gjithashtu edhe me shoqërinë civile dhe me të gjitha organizatat tjera. Duke pasur parasysh që është një strategji e cila duhet t'i përmbajë të gjitha direktivat e saja dhe nuk dua t'i përsërisë edhe kolegët tjerë, mirëpo nuk mundem tash pa e shprehur shqetësimin tim sepse në këtë strategji përcaktohet një koordinator, i cili nuk ka legjitimitet qeveritar. Do të duhej që në këtë strategji, koordinatori i kësaj strategjie të jetë zëvendëskryeministri apo vetë kryeministri, sepse është strategji madhore dhe është shumë relevante.

Më vjen keq që ky debat për veriun e Kosovës dhe cenimin e integritetit dhe të sovranitetit vjen pikërisht nga opozita, duke e pasur parasysh se jo zakonisht kërkesat për debate në Parlament shkojnë në favor të opozitës, sepse ashtu është edhe probabiliteti i votave edhe në Kryesinë e Parlamentit dhe në Parlament vetë, por gjithsesi dua të theksoj se, përveç kësaj, opozita mund ta japë kontributin e saj edhe po e jep vazhdimisht. Përveç kësaj, dua të di se vazhdimisht u theksua se ne jemi shteti i pavarur sovran, me integritet të pacenuar e tjera, e tjera, por dua të di, e di se është de jure kjo gjendje e vërtetë, mirëpo de facto qëndron krejt ndryshe dhe jemi dëshmitarë të gjithë. Unë

mendoj se janë të interesuar jo vetëm pozita, Qeveria e Kosovës, Presidenca, por janë të interesuara të gjitha palët dhe pikërisht edhe populli i Kosovës, bile, bile jam shumë e bindur se edhe komunitetet tjera, edhe komuniteti serb është i interesuar që të integrohet prej veriut, bashkë me jugun e Mitrovicës.

Dua ta pyes kryeministrin e Kosovës - çfarë ka bërë për jugun e Mitrovicës, që pak të bëhet pjesë lakmuese edhe për veriun e Mitrovicës, që ajo pjesë e veriut të lakmojë apo të sheh diçka më mirë në jugun e Mitrovicës që të integrohet shumë më lehtë. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Danush Ademi, le te përgatitet deputeti Hydajet Hyseni.

DANUSH ADEMI: Të nderuar të pranishëm, i nderuar kryetar i Parlamentit, anëtarë të Kryesisë,

E nderuar Qeveri e Kosovës,

Në këtë seancës, para veti kemi një diskutim, një rezolutë e cila është propozuar nga kolegët deputetë të LDD-së, rezolutë e cila jepet qartë për respektimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës në territorin e saj.

Dihet që dy vite jemi tanimë në pushtet dhe në mendjen time mendoj akoma me çfarë Kushtetute deri me tani paskemi funksionuar. Kushtetuta, çelësi i një shteti, duhet që për çdo problem që na paraqitet, ne duhet të nxjerrim edhe rezoluta tjera për të rikujtuar organet e shtetit tonë se ne punojmë dhe kemi një Kushtetutë, të cilën në këtë vend e kemi miratuar dhe duhet ta zbatojmë. Nuk jemi kundër kësaj rezolute, por jemi për atë që në cilindo vend të Kosovës, të zbatohet Kushtetuta dhe ligjet e shtetit tonë. Këtë rezolutë të cilën sot jemi duke e shqyrtuar, është dashur ta kemi në diskutim ndoshta disa javë më parë apo muaj më parë.

Në kuadër të kësaj rezolute, do të kisha obliguar apo kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të bëhet e mundur që Kushtetuta e Republikës së Kosovës të jetë e zbatueshme në tërë territorin e saj, ato që nuk janë zbatuar deri më tani, të fillojnë së paku të zbatohen. Po jua rikujtoj vetëm nenin 61- përfaqësimin në punësim në institucione publike. Ky nen nuk është i zbatueshëm për komunistin tonë ashkali, komunitetin romë edhe egjiptas. Nga Qeveria e Kosovës pothuaj se asnjë i punësuar në këto institucione: PTK, KEK, Aeroport e të tjera. Njësoj, neni 96, ministritë dhe përfaqësimi i komuniteteve, por edhe te ky nen, ne e dimë që janë disa të drejta të komuniteteve që na veç duhet t'i gëzojmë, por këtë të drejtë e gëzoi vetëm komuniteti serb, boshnjak, goran dhe turq, kurse për komunitetet tona ashkali, romë dhe egjiptas nuk ekziston ky nen. Bile së paku, ne e dimë që zëvendësministrat të cilët kanë qenë vite me radhë, kanë qenë nga komuniteti boshnjak, goran dhe turq, bile së paku është dashur zëvendësministrat, këshilltarët apo asistentë të jenë nga radhët e këtyre tri komuniteteve.

Njësoj edhe në nenin 141, mendoj se ka shkelje në mediumet publike të RTK-së, zënë vend edhe komunitetet tjera sepse, pothuaj të gjitha komunitetet, përpos atij ashkali, kanë emisionet e veta dhe këtu mendoj se shkelet e drejta e një komuniteti.

Të nderuar kolegë,

E nderuar Qeveri e Kosovës,

Rezolutën që e kemi përpara duhet ta përkrahim, por që duhet edhe një herë t'ua rikujtojë që të mos i biem vetes, për çdo problem të sjellim rezoluta dhe më pas të

fillohet të respektohet Kushtetuta. Në fund, në këtë rezolutë le të përfshihet edhe ajo që Qeveria e Kosovës, gjatë raportit të sjellë fakte dhe argumente që Kushtetuta dhe ligjet dhe të gjitha ato që aprovohen nga Kuvendi i Kosovës, janë duke u zbatuar dhe janë ndërmarrë hapa konkrete aty ku nuk është zbatuar Kushtetuta e Kosovës. Të mos harrojmë të theksojmë që sa më parë duhet të hiqen të gjitha strukturat paralele dhe që shteti dhe Kushtetuta të funksionojë në çdo vend të Kosovës. Unë kërkoj që edhe komunitetet tjera që janë në veri të Kosovës, ashkalitë, egjiptasit dhe romët të jenë edhe më të mbrojtur, sepse edhe ata kanë një presion dhe që janë për të dhe të mendohet edhe për ta sikur mendohet për shqiptarët për një jetë më të mirë, me një sigurim më të plotë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Hydajet Hyseni, le të përgatitet deputeti Naim Maloku.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Zonja e zotërinj deputetë,

Të nderuar ministra,

I nderuari kryeministër,

Duke ju përshëndetur ju, unë i përshëndes edhe këtë debat dhe nismën për këtë debat. E konsideroj të rëndësishme dhe të qëlluar, pa çka pse mund të reflektohet si kanë folur, ta zëmë, bartësit ndonjë vit më parë kur nuk kanë qenë opozitë, por është e kuptueshme, le ta shfrytëzojë edhe opozita mundësinë e vet. Pa çka pse ndonjëherë vërehen edhe tendenca përfitimi të poenëve politikë, nga pak edhe hile, nga pak edhe goditje nën brez, por janë pjesë e lojës dhe ne besoj që do të jemi gjithmonë të hapur për debate të tilla.

Unë do t'i inkurajoja madje të gjithë që vetëm të qëndrojnë në këto pozicione shumë të avancuara dhe, për mua, trimëruese. Do të dëshiroja që edhe qytetarët, si thonë, të na kapin për gjuhe dhe t'i mbajmë pastaj para sysh diskutimet tona, fjalët tona dhe të kërkojmë pastaj edhe në situata kur vijmë në sprovë, të shohim pastaj sa kanë qenë në përputhje fjalët me veprat e kështu me radhë.

Tema është formuluar në faqen e parë – zbatimi i Kushtetutës, në faqen e dytë – moszbatimi i Kushtetutës dhe prania e strukturave, siç është thënë, paralele. Pati shumë vërejtje me vetë temën siç është formuluar. Është temë e gjerë zbatimi i Kushtetutës ose moszbatimi i Kushtetutës, sepse do të hynim në një mal çështjesh. Për shembull, a bie në këtë pjesë edhe ajo, ta zëmë, që ndodhë me atë vendbanimin, qysh po e quajmë – kamp të romëve atje, për të cilin vërtet me të drejtë turpërohemi dhe ende nuk e dimë se kush është përgjegjës dhe pse mbahet ajo ashtu, pse duhet t'i ndajmë çështjet edhe ndonjëherë me një thikë etnike që gjithmonë kuptohet keq, por mund edhe këtë ta tejkalojmë. Edhe fakti që po quhen padrejtësisht struktura paralele u theksua, por unë do të dëshiroja të shtoj vetëm se nuk duhet të quhen paralele, sepse nuk janë të tilla, nuk është natyra e atyre strukturave, siç janë strukturat paralele në lëvizje të ndryshme politike e tjera. Janë struktura të ish regjimit, që është dënuar si regjim pushtues dhe gjenocidal, janë relikte dhe vazhdimësi i atij regjimi dhe, si të tilla, mendoj se duhet cilësuar ashtu siç janë. Për mua ka rëndësi edhe një fakt që po harrohet se realiteti i krijuar në veri, në masë të madhe na bën fajtor dhe përgjegjës edhe ne si Kuvend.

Në Kushtetutën në të cilën po thirrmi dhe po kërkojmë zbatimin, ne kemi miratuar edhe nene të saj që po i referohen dokumentit të Ahtisarit, kurse në dokumentin e Ahtisarit kemi miratuar edhe formula të cilat na kanë imponuar në një mënyrë ose tjetër edhe këtë

fenomenin e pranisë së Serbisë në Kosovë. Lexoni, ju lutem, kapitullin 5 të Kushtetutës, lexoni kapitullin 3 dhe nenin 10, 9 e tutje të dokumentit të Ahtisarit dhe do të shihni. Ndonjë përpjekje që me kohë këto të theksohen dhe të vihet gishti, si të thuash, mbi plagë, atëherë kanë qenë pamundësuar madje edhe kanë qenë keqkuptuar dhe keqinterpretuar. Tani jemi këtu ku jemi dhe unë nuk jam për t'u kthyer prapa, por megjithatë duhet ta shohim faktin se ne e kemi lidhur nga pak vetveten dhe nëse nuk e diagnostifikojmë gjendjen siç duhet, zor edhe të gjejmë ilaçin e duhur.

Për mua po ashtu është një ngatërrim – lidhja e gjendjes në veri me strategjinë. Strategjinë nuk e kemi marrë dhe unë besoj se përfaqësuesit e Qeverisë do ta krijojnë një mundësi që pasi ta marrim ne strategjinë, ta bisedojmë posaçërisht, ka nevojë që ajo çështje të diskutohet. Për mua është shqetësuese po ashtu që, siç u tha edhe këtu në dokumentin, që si duket është përkthim prej anglishtes, thuhet tekstualisht Northern Kosovo, jo veriu i Kosovës, por Kosova Veriore, me të madhe.

Zonja e zotërinj, nga na erdhi ky emërtim Kosova Veriore, çka do të thotë? Asocioni i parë është – Irlanda Veriore, asociacioni i dytë mund të jetë Bosnja e kështu me radhë. Nuk beson që dikush ia dëshiron Kosovës, nuk besoj që dikush ia dëshiron edhe serbëve të Kosovës, as shqiptarëve të Kosovës, as të tjerëve. Mendoj që na duhet të ndalemi në këto çështje. Unë nuk dua të lëshohem në atë që është përmbajtje e strategjisë, se besoj se do të kemi, unë e mbështes frymën e strategjisë, e mbështesë qëllimin e saj dhe ata që kanë kontribuar...

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që të jap një kontribut në debatin që është shtruar sot, të cilin e mbështes plotësisht. Më lejoni që të mbështes çdo synim të Qeverisë së Kosovës për zbatueshmërinë e ligjeve dhe të Kushtetutës në tërë territorin e Kosovës, pra çdo veprim pozitiv që e ndërmerr Qeveria e Kosovës, që e ndërmerr në zbatimin e ligjit dhe të Kushtetutës në tërë territorin e Kosovës, e ka mbështetjen time të plotë dhe mendoj që duhet ta ketë mbështetjen edhe mbështetjen e Kuvendit të Kosovës.

Më lejoni, zoti kryeministër, t'ju them se është e pafalshme që ju nuk e sillni strategjinë e përfolur në Kuvend të Kosovës, tekstin në tërësi, në mënyrë që ne të debatojmë dhe t'ju japim mbështetjen si Kuvend i Kosovës, e cila mbështetje juve ju duhet si Qeveri e Kosovës për të vepruar dhe për të punuar në të mirën e integritetit të të gjitha pjesëve të Kosovës në institucionet e Kosovës. Ajo strategji duhet të ketë edhe dinamikën e implementimit me veprime dhe me kohë të përcaktuara. Nuk dua t'i përsëris fjalët që i tha deputeti Sabri Hamiti, në fillim, për emërtime të strukturave në veri, nuk kemi të bëjmë me struktura paralele, por struktura kriminale të cilat kanë ardhur ndesh me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi në Kosovë, të cilat praktikisht janë, veprimtaria e tyre është e jashtë ligjshme dhe unë mendoj që edhe Ministria e Drejtësisë duhet të ngritë padi penale për njerëzit e përfshirë në ato struktura. Dua të përqendrohem, ndoshta, në një segment pak a shumë specifik në këtë debat.

I nderuar zoti kryeministër!

Qeveri e nderuar, ato struktura financimin tyre e kanë kryesisht nga kontrabanda me mallra që prej djegies së pikave kufitare 1 dhe 31, me të madhe po ndodhin në atë pjesë të territorit të Kosovës. Por, unë e pyes - ku shiten ato mallra? Ato mallra shiten në territorin e Kosovës, nën lumin Ibër, pra në jug të lumit Ibër, pra në krejt pjesët e Kosovës, ku i ka ingerencat e plota dhe kontrollin e plotë duhet ta ketë Qeveria e Kosovës.

Pyes kryeministrin – a ka pasur ndonjë pengesë Qeveria e Kosovës që Ministria për Ekonomi dhe Financa, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ta shtojë numrin e inspektorëve dhe të kontrollojë 24 orë tregun në Kosovë dhe mos të lejon, pra, ta zvogëlojë hapësirën në minimum të mundshëm të shitjes së atyre mallrave të kontrabanduara në këtë pjesë të Kosovës, me shitjen e të cilave praktikisht po dëmtohet buxheti i Kosovës, po dëmtohet konkurrenca në Kosovë, pra po ju bëhet konkurrencë jo e mirë dhe e paligjshme afaristëve të cilët janë të ndershëm dhe paguajnë tatimet dhe doganat dhe financohen, pra, strukturat kriminale në veriun e Kosovës.

Më lejoni që në mbështetje të kësaj mospune të Qeverisë, sipas mendimit tim, në këto dy vite, të jap vetëm tri argumente të nxjerra nga doganat e Kosovës, janë fakte zyrtare, pra, që i kam marrë. Për shembull, benzina në vitin 2007, 124 milionë litra, në vitin 2008 – 116.9 milionë litra, për 7.600.000 litra më pak janë zhdoganuar në vitin 2008. Kafja, për shembull, nga 4167 tonë në vitin 2007, në 3275 tonë, për 892 tonë më pak. Bitumeni nga 1.276.730 kilogram në vitin 2007, kur Ministria e Transportit ka pasur 60 milionë euro buxhet, në 338.252 kilogram në vitin 2008, kur e njëjta ministri ka pasur 160.000.000 euro në buxhet dhe i ka shtruar 600 km rrugë. Pra, këto janë tri fakte të cilat argumentojnë, zoti kryeministër, që Qeveria e juaj nuk ka punuar sa duhet në ngushtimin e hapësirës së kontrabandimit të mallrave që vijnë nga veriu i Kosovës, në pjesën ku ju duhet ta keni ...

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti kryeministër e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Mendoj se rreth çështjes për çka është thirrur seanca, ka pasur një debat korrekt, konstruktiv, por shpeshherë edhe devijim nga rendi i ditës që kjo çështje në fjalë të kalojë një debat polimizus apo konfrontus të pa nevojshëm, në vend të logjikës së mentalitetit dhe të angazhimeve tona të përbashkëta për fillimin e implementimit të agjendës sonë për integrimin e gjithë territorit dhe qytetarëve tanë. Madje, madje mund të them se kishte edhe zëra që pretenduan ta degjenerojnë debatin dhe në kuadër të kësaj dëshiroj t'ju ftoj përsëri të gjithëve, pa asnjë dallim politik dhe etnik, që si Kuvend i Kosovës për hir të së ardhmes, të stabilitetit dhe të rendit e të ligjit, të angazhimeve socio – ekonomike, të zhvillimit të demokracisë, të zgjedhjeve të lira atje, të formimit të komunës së re, të respektimit të plotë të Kushtetutës së Kosovës, të ligjeve të Kosovës, të dokumentit të presidentit Ahtisari, të mbështetjet në mënyrë unike strategjia e Qeverisë së Kosovës dhe Bashkësisë Ndërkombëtare me një deklaratë, në fund.

Por, gjithashtu, në të njëjtën kohë dua të jem edhe shumë i drejtpërdrejtë edhe sa u përket çështjeve dhe të akuzave, shpifje që u dëgjuan këtu shumë të ulëta. Dëshiroj të theksoj se edhe për zotëri mister patriotin deputet, unë nuk dëshiroj që askush deficitet e tij personale, morale, patriotike, qytetare, të padijes dhe të jo edukimit t'i mbulojë me emra të mëdhenj apo duke u thirr në mera të mëdhenj. Prandaj, dëshiroj të theksoj se ka ikur koha kur njerëzit kanë bërë gjëra të liga dhe të këqija dhe kanë shkuar dhe janë përlulur

tek varri i presidentit, Ibrahim Rugova, për t'i mbuluar të këqijat apo tek varri i komandantit legjendar, Adem Jashari. Prandaj, dëshiroj të theksoj se askush nuk ka nevojë të bëhet nervoz as agresiv, do të ndalet kontrabanda, e kuptoj nervozën tuaj. Gjithashtu, dua të theksoj se politika definitivisht nuk bëhet me mentalitet as të lotarive, as të kazinove, edhe pse ndonjëherë ju ka rënë loto në politikë, por ka ikur ajo kohë. Ndërsa, dëshiroj të theksoj se sa i përket Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, për funksionimin e saj më mirë do të ishte të pyesni anëtarët e Kryesisë së juaj, është e vërtetë se ne kemi pasur koncepte të ndryshme demokratike të zhvillimit të demokracisë dhe kemi edhe sot, unë vazhdimisht do të jem në këto angazhime të zhvillimit të koncepteve dalluese, që për mua janë vlerë, janë strategji, është e ardhmja e jonë demokratike, por në të njëjtën kohë dallimet dhe vlerat e ndryshme që paraqiten është mirë të shikohen në të kaluarën. Mund të them që ju pretenduat dhe kësaj radhe përsëri po ju them, po ju kursej, singërisht, i nderuari deputet patrioti, jam duke ju kursyer. Ju e dini që mund të flas shumë gjëra, e di që ke pasur dëshirë të vishë në PDK dhe ju e dini se e kemi refuzuar atë kërkesë, e kuptoj zhgënjimin tuaj, ja pafsh hairin, ju e dini se s'keni pasur vend aty. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputetja Njomza Emini.

(Reagime nga salla)

S'ia ka përmendur emrin askujt. Tani nuk është mirë për t'u përgjigjur në thirrje që i drejtohet sallës, askush. Deputetja Njomza Emini e ka fjalën.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Organizimi i një debati të tillë nga Kuvendi i Kosovës për zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe për praninë e strukturave të pushtetit të Serbisë në territorin e vendit tonë, dy vite pas shpalljes së pavarësisë dhe gati dy vite pas hyrjes në fuqi të kushtetutës, mendoj se është shumë i vonuar, por njëkohësisht edhe është shumë i qëlluar. Është i vonuar sepse problemi i strukturave paralele serbe nuk është një fakt i kohëve të fundit, por ai ekziston prej më shumë se një dekade. Ndërsa, zbatimi i kushtetutës, sidomos në veri të vendit, nuk ka filluar ende.

Problemi i veriut dhe strukturat paralele serbe nga ku dhe kanë burimin e tyre, për më shumë se një dekadë janë lënë në mëshirën e bashkësisë ndërkombëtare, sepse institucionet e Kosovës e as ato të Republikës së Kosovës pas 17 shkurtit të vitit 2008, nuk kanë paraqitur ndonjë nismë serioze për zgjidhjen e problemit të veriut, përveç një tendence për ta menaxhuar atë. Institucionet e Kosovës sikur janë ndier komodë me arsyetimin e tyre se ky është një problem shumë i ndërlikuar dhe tendenca për ta zgjedhur atë mund ta destabilizojë vendin. Andaj, gjithë ajo që kanë bërë, ka qenë kërkesa e tyre drejtuar institucioneve ndërkombëtare për ta zgjidhur atë. Por, politikat e gabuara karshi kësaj pjese, veçanërisht ato të UNMIK-ut, i cili po thuaj se plotësisht merret me ruajtjen e statusit kohës, e pak ose aspak me zgjidhjen e tij, bën që në këtë pjesë të mos ketë sundim të ligjit.

Të nderuar deputetë,

Edhe dy vite pas shpalljes së pavarësisë, Qeveria e Kosovës nuk ka treguar se ka një vizion të qartë dhe nuk hartoi një strategji konkrete për këtë çështje. Deri tani, siç duket, tek tash Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me Zyrën Civile Ndërkombëtare e kanë

hartuar një dokument të quajtur Strategjia për veriun e Kosovës. Uroj që të ketë sukses dhe të jetë i implementueshëm.

E këto dy vite veriu i Kosovës i kaloi në mungesë të plotë të ligjshmërisë dhe të zbatimit të Kushtetutës, ndërsa në kundërshtim me këtë, atje vetëm pak ditë pas shpalljes së pavarësisë radikalët serbë i dogjën dy pika doganore: pikën 1 dhe 31, me të cilin akt erdhi edhe deri te mungesa e funksionimit të shërbimit doganor në veri. Mungesa e një regjimi të mirëfilltë kufitar çoi në humbje të mëdha për buxhetin e varfër të Republikës së Kosovës. Nga mungesa e regjimit kufitar erdhi edhe deri te lulëzimi i kontrabandës, të krimit të organizuar dhe aktivitetet tjera ilegale, të cilat e dëmtuan dhe po e dëmtojnë jashtëzakonisht shumë të ardhmen e Kosovës.

Kolegë deputetë,

Realizimi i aspiratave të vendit tonë për integrimin në strukturat euroatlantike çdo ditë e më shumë po bëhen më të largëta. Ne madje kemi mbetur jashtë procesit të liberalizimit të vizave dhe në përfshirjen e listës së bardhë të Shengenit, meqë shumë nga kriteret që kërkojnë për të hyrë në këtë proces janë të lidhura me zhvillimet në këtë pjesë të territorit të vendit tonë. Kosova nuk po mund të mposhtë korrupsionin, kontrabandën, krimin e organizuar, sikurse që nuk po mund të sigurojë kontrollin e kufijve në të gjitha pjesët e vendit apo menaxhimin e integruar të kufijve.

Kosova nuk po arrin ta ushtrojë sovranitetin e saj në tërë territorin e vetë, sikurse që edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila së shpejti i bën dy vite që ka hy në fuqi, nuk po gjen zbatim në të gjitha pjesët e territorit të saj, derisa në të njëjtën kohë po vazhdon ekzistimi i strukturave paralele serbe.

Të vetëdijshëm se të gjitha këto ndikojnë negativisht në të ardhmen e vendit tonë dhe në synimet e strukturave drejtë strukturave euroatlantike, vlerësoj se është momenti i fundit për të vepruar të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare, që strukturat paralele serbe dhe moszbatimi i Kushtetutës t'i takojnë të kaluarës, ndërsa tani të hapim faqen e re, atë të integriteteve euroatlantike. Faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Thaçi e ka fjalën edhe një herë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete dhe deputetë që kërkuat për çështjen e strategjisë, sqarim.

Ju e dini, pikë e rendit të ditës nuk ka qenë strategjia. Nuk është kërkuar zyrtarisht strategjia nga Qeveria. Çdo moment që ju mendoni se është e nevojshme, strategjia mund të dorëzohet edhe nëpër kutit tuaja postare, edhe personalisht këtu. Strategjia edhe në medime është publikuar dhe aty nuk ka asgjë sekrete, përkundrazi është shumë, shumë transparente. Për këtë arsye, në momentin që ju mendoni që është e nevojshme, strategjia për dy minuta vjen në sallë dhe i shpërndahet secilit prej juve, qoftë nevoja edhe publikisht, por nuk ka qenë në rend të ditës. Për këtë arsye, natyrisht se kam kërkuar një mbështetje pasi të gjithë jeni të informuar dhe keni lexuar.

Ndërsa, pyetjet që u ngritën edhe më herët dhe tendenca për të hedhur gurin në mes të partnerëve të koalicionit, dëshiroj të potencoj edhe një herë, e kuptoj shqetësimin tuaj edhe porositë që i kemi marrë, por dëshiroj të potencoj se kam shumë, shumë pyetje

pikërisht për formacionin tuaj politik aktual, po flas aktual, se ju e dini që e ndërroni shpesh, në raport edhe partnerin e koalicionit, edhe para lufte, edhe gjatë luftës.

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Deputeti Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje Kabinetit qeverisës,

Vërtet sot është ngritur një çështje e cila nuk është e panjohur për asnjë qytetar të Kosovës. Problemi i Mitrovicës nuk daton që dy vjet, por problemi i Mitrovicës është, jo më pakë se 10 vjet problem i pazgjedhur, sepse problemet e tjera të këtij vendi janë zgjidhur dhe e dimë se si janë zgjidhur dhe kush i ka zgjidhur, kush kanë qenë ata kontribuues të cilët kanë ndikuar që ne sot flasim këtu lirshëm.

Unë e përgëzoj Qeverinë aktuale së pari me hapat konkret që ka ndërmarrë pikërisht në Mitrovicë. Asnjë qytetari, personalisht nuk do t'i kisha lejuar vetvetes që t'i bëjë thirrje-ktheu ti në Mitrovicë, atje ku nuk janë të siguar as kushtet minimale për të ekzistuar, atje ku nuk ka as vendstrehim, nuk ka as rrugë, as ujë, as dritë. Ndërsa, Qeveria aktuale, gjatë këtyre dy vjetëve është një e vërtetë e pamohueshme se ka rritur prezencën e vet me veprime konkrete. Asnjë dokument, cili do që të nxjerrim ne si Parlament, nuk do të ketë fuqinë obligative më të madhe se sa ajo që na obligon vetë Kushtetuta për ruajtjen e tërësisë territoriale të vendit.

Prandaj, jam ithtar i asaj më tepër të veprojnë konkretisht, të rrisin prezencën tonë sa më të madhe në Mitrovicë, të krijojmë kushte për qytetarët që duhen të kthehen atje, pa dallim përkatësisë etnike, po për të gjithë qytetarët dhe kjo Qeveri prapë po i rikthehem, ka trashëguar një gjendje të mjerë, jo vetëm në Mitrovicë, por në të gjitha fushat e gjithmbarshme të vendit, një degradim total. Sikur Qeveria paraprake gjatë tri vjetëve të qeverisjes të kishte vepruar sikur Qeveria aktuale, 8 milionë investime që janë bërë për dy vjet, të ishin bërë edhe 8 milionë investime për tri vjetët e kaluar, sot gjendja në Mitrovicë do të ishte krejtësisht tjetër. Është një realitet shumë i madh se atje ka grupe që bëjnë kontrabandë dhe kjo vërtet institucionet përkatëse duhet t'i luftojnë këto grupe dhe duhet zinxhirin e tyre se nuk e di se ku do të dalë ai zinxhir i tyre dhe këto duhet të merren në përgjegjësi dhe vërtet të veprojnë ligji.

Qeveria, është e vërtetë që ka dhënë një propozim, një ide, ka hartuar një strategji, sado e dobët qoftë ajo, ka pasur guximin të ndërmarrë një hap konkret, po u bën thirrje të gjithë njerëzve, të gjithë qytetarëve të vendit që ta japin kontributin e vet që kjo strategji të begatohet, por edhe të realizohet. Këtu sot në Kuvend, në vend që të debatohej të dëgjonim ndonjë ide, ndonjë propozim që do të ndihmonte vërtet në rritjen e prezencës në Mitrovicë, përkundrazi këtu shihet vetëm një pjesë është e dedikuar, e përcaktuar vetëm për të sharë dhe i frikësohet çdo ndryshimi pozitiv që ndodh në këtë vend. Në këtë përfundim na bien pikërisht se një pjesë verbërimi për të ardhur me çdo duksh dhe me çdo mjet në pushtet, i verbëron dhe nuk shohin, nuk janë në gjendje ta shohin realitetin dhe t'i përgëzojnë, t'i përshëndesin ndryshimet pozitive që çdo ditë po ndodhin në vendin tonë. Po e them i lutem Zotit që këta njerëz t'i ndihmojë të orientohen, të shohin dhe të mendojnë më mirë, më drejt për interesin e tyre personal, për familjet e tyre dhe së fundi për vendin e tyre dhe nëse duan ndonjëherë për të ardhur në pushtet, vërtet duhet të ndalen të mendojnë dhe të reflektojnë. Kështu si janë duke shkuar kurrë, me shpifje, me rrena, me mashtrime, me keqpërdorime, nuk do të kenë shans ta mashtrojnë qytetarin e

Kosovës dhe të vijnë në pushtet. Por, ne do të vazhdojmë punën dhe Mitrovica është një problem që duhet dhe do të kryhet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pasi jemi gati në përfundim të debatit, s'besoj që diskutimet e ardhshme do të sjellin kush e di çka të re. Unë kisha kërkuar, shefat e grupeve parlamentare të dalin dhe të na përgatisin një dokument dhe ne vazhdojmë me debatin. Fjalën e ka deputetja Edita Tahiri, le të përgatitet Heset Cakolli.

EDITA TAHIRI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, dua të them që problemet në veri të Kosovës kanë një histori të gjatë, pra, që nga përfundimi i luftës këtu edhe gjendja atje vazhdimisht ka qenë gjendje e rëndë për shkak të ndërhyrjes ilegale të ish- okupatorit të këtij vendi, pra, të Serbisë, me strukturat e qeverisjes ilegale, të cilat e kanë pamundësuar veprimin e Kosovës dhe të institucioneve të saj. Mirëpo, me pavarësinë e Kosovës, natyrisht që krijohen obligimet e shtrirjes së sovranitetit në pjesën veriore të Kosovës dhe ne si një shtet i ri, me koncepte moderne, natyrisht që edhe sovranitetin e kuptojmë në kuadër të definimit modern të sovranitetit, që praktikisht është sovraniteti si pushtet dhe sovraniteti si përgjegjësi. Në kuadër të punës sonë, pra për të zbatuar sovranitetin si përgjegjësi, është detyrë jona në kuadër të saj edhe strategjia e Qeverisë së Kosovës dhe ICO-s shkon në këtë frymë, pra, që t'i ndërmarrim të gjitha masat konstruktive për të bërë që edhe pjesa e serbëve të veriut të fillojnë integrimin në institucionet e Kosovës, ashtu siç e bënë edhe serbët nga pjesët tjera të Kosovës, që ishte një hap i mirë, hap pozitiv, forcoi imazhin e Kosovës. Pavarësisht se Serbia me të gjitha masat po ndërhyr, pra, në mendjen politike të serbëve të veriut, mendoj se ka hapësirë edhe për ata t'i rimendojnë qëndrimet e tyre dhe ta shohin se ardhmëria e tyre është në Kosovë dhe se institucionet e Kosovës janë ato që për të gjithë do të ofrojnë mundësi dhe liri të barabarta.

Për sa i takon sovranitetit si pushtet, mendoj se për të zbatuar planet tona për integrimin e veriut dhe integrimin e pjesës së mbetur atje të minoritetit serb, natyrisht që duhet të zbatohen të gjitha masat që i lejon Kushtetuta demokratike e Kosovës. Dhe, natyrisht që duhet të japim edhe porosi të qarta Serbisë se planet e saja, pra eventualisht përdorimin e pjesës veriore të Kosovës për këmbime të ndryshme, janë plane të papranueshme dhe ato do të kundërshtohen dhe unë, për mendimin tim, nuk e shoh problem integrimin e veriut, sepse kur e marr parasysh historinë që mbas 100 vjetësh ne e gjetëm forcën të pavarësohemi, veriu është një çështje më e vogël, besoj se këtë çështje e mbërrimë pa problem, por kjo kërkon disa parakushte.

E para, mendoj se ne duhet të kemi një konsensus kombëtar në këtë çështje. Sot nga diskutimet e pashë që nuk e shfrytëzuam këtë çështje që ka karakter të interesit nacional, pra nuk e shfrytëzuam si të tillë dhe mendoj se të gjitha mendimet dhe dinamikat duhet të zhvillohen në kuadër të një pajtimi tonë nacional për këtë çështje dhe të mos kemi dallime partiake në këtë drejtim.

E dyta, kam një çështje që dua të theksoj si të rëndësishme se në kuadër të përpjekjeve tona për integrimin e veriut duhet të kemi kujdes që mos të cenohet unitariteti i shtetit tonë, pra të mos lejohet që plani 6 pikësh i Ban Ki Munit në një mënyrë apo tjetër të futet si pjesë e kësaj strategjie, kjo është shumë e rëndësishme.

E treta, mendoj se diplomacia e Kosovës duhet të jetë shumë më aktive në këtë kohë kur ne do të duam ta zbatojmë strategjinë, sepse është me rëndësi edhe ajo pjesë e botës që

ende po lëkundet për njohjen e pavarësisë, t'i shohë përpjekjet tona konstruktive që ta integrojmë këtë pjesë të serbëve në institucionet tona. Dhe, po ashtu desha të them...

KRYETARI: Vazhdoja, një minutë!

EDITA TAHIRI: Faleminderit, e kryej shpejt. Është po ashtu me rëndësi, u tha edhe këtu para folësit e mi, që qëndrimi i bashkësisë ndërkombëtare është mjaft i qartë për pavarësinë e Kosovës, mirëpo në këtë kohë disa elemente po i shohim si me qëndrime neutrale. Mendoj se është mirë që të gjithë aktorët ndërkombëtarë në Kosovë, pra, t'i vihen në përkrahje, por para së gjithash ne deputetët duhet të vejmë në përkrahje të strategjisë për integrimin e veriut dhe të shfrytëzojmë këto debate për të dhënë ide, sepse marketingu politik mbase ka hapësirë edhe në debate tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë deputete!

Fjalën e ka deputeti Haset Cakolli, le të përgatitet deputeti Berat Luzha.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër, të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Edhe pse kanë kaluar 10 vjet pas përfundimit të luftës dhe më tepër se dy vjet pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, në pjesën veriore të vendit nuk janë zbatuar Kushtetuta dhe ligjet e aprovuara në këtë Kuvend të respektuar, sepse një gjë të tillë e kanë penguar strukturat ilegale që veprojnë atje dhe të mbështetura nga Serbia. Prandaj, unë mendoj se tani ka ardhur koha që institucionet vendore të mbështetura edhe nga faktori ndërkombëtarë të bëjnë hapa konkretë për krijimin e kushteve të përshtatshme për zbatim të ligjeve dhe në këtë pjesë të vendit tonë.

Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Zyrën Civile Ndërkombëtare, kanë hartuar një dokument me rëndësi të veçantë për vendin e Kosovës dhe mbështeten në katër shtylla kryesore.

Pika e parë apo shtylla e parë, kontrollimi i plotë i pikave doganore dhe mbledhja e të hyrave që mblidhen duhet të derdhen në institucionet legjitime shtetërore të Kosovës.

Pika e dytë, është paraparë të organizohen dhe të mbahen zgjedhjet lokale në komunat: Zveçan, Zubinpotok dhe Leposaviq.

Pika e tretë apo shtylla e tretë e kësaj strategjie, është themelimi i komunës së Mitrovicës në pjesën veriore dhe,

Pika e katërt, përmirësimi i situatës sociale dhe ekonomike.

Por këtyre shtyllave sipas mendimit tim u mungojnë planet e veprimit konkrete edhe pse kryeministri në fjalën e tij tha se është e punuar në detale strategjia, besoj që janë paraparë të gjitha masat dhe hapat konkretë që duhet të merren gjatë implementimit të kësaj strategjie.

Suksesi i strategjisë nuk është vetëm hartimi i mirë i saj, por është zbatimi i plotë i saj në terren. Dhe, unë mendoj se qëllimi kryesor i zbatimit të kësaj strategjie është të përmirësohet dhe të normalizohet jeta e qytetarëve atje, do të thotë, është strategji për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, krijimin e vendeve të reja të punës, zbatimin e

Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës edhe në pjesën veriore të vendit, ku pastaj do të krijohen kushte të favorshme për shtetin tonë, për proceset integruese rajonale dhe evropiane.

Në fund unë mendoj se të gjithë ata që cilët mund të kontribuojnë për krijimin e kushteve për zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve në pjesën veriore të vendit, të japin kontributin e tyre, sepse zbatimi i kësaj strategjie në këtë pjesë të vendit tonë është me interes të veçantë dhe është interes shtetëror, prandaj duhet ta kemi përkrahjen e gjithë faktorëve që mund të kontribuojnë në këtë drejtim. Ju faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Berat Luzha, le të përgatitet deputeti Riza Smaka.

BERAT LUZHA: Unë, zoti kryetar, dua të shpreh shqetësimin tim që mbledhjet e Kuvendit, sidomos debatet po shfrytëzohen për akuza të pabazuara dhe sidomos për fyerje dhe shpifje të shpeshta.

Dua t'ua kujtoj kolegëve deputetë se ne kemi një dokument bazë që quhet – Etika e gjuhës parlamentare, që është pjesë apo aneks i Rregullores së Kuvendit. Kuvendit nuk i duhet një gjuhë e tensionuar me shpifje e fyerje, por një gjuhë parlamentare e arsyeshme dhe e bazuar në fakte.

Kryetari nuk duhet të tolerojë një gjuhë jo parlamentare në Kuvend, për shkak se me këtë gjuhë që po përdoret herë pas here, Kuvendi po merr një imazh të keq në opinion.

Në shenjë të protestës, për dalje të shpeshta nga rendi i punës, për shkak të fyerjeve e shpifjeve dhe për shkak të akuzave të pabazuara, unë heq dorë nga diskutimi.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetët kanë imunitet të flasin ndonjëherë edhe atë që s'është. Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet deputetja Synavere Rysha.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryetar!

Të nderuar zotëri zëvendëskryeministër, ministra dhe deputetë,
I kam tri vërejtje parimore në propozimin e rezolutës edhe më shumë në tekstin që është quajtur...

KRYETARI: Deputet, nuk është në diskutim rezoluta...

RIZA SMAKA: Propozimi.

KRYETARI: Jo, jo, nuk është absolutisht rezoluta, përmbaju rendit të ditës.

RIZA SMAKA: Në rregull, megjithatë, sipas asaj shkrese e kemi këtë debat.

KRYETARI: Nuk është duke u bërë mbi bazën e rezolutës, po mbi bazën e pikës së rendit të ditës.

RIZA SMAKA: Ju lutem, pse Qeveria deputetëve nuk ua ka dhënë strategjinë, dokumentin ose një përmbledhje të saj? A thua Qeveria paska rezerva për deputetët, a paska sekrete? Domethënë, nuk duhet të jetë kjo. Kjo është, një.

Dy, në këtë dokument posaçërisht apostrofohet insistimi qeveritar për (mbi) investimet në pjesën veriore të Kosovës, gjë që zgjon dilema, referuar krijimit të precedentit diskriminator, tok me oportunitetin pragmatik të efekteve të tyre.

Ndër tjera, kur theksohet se aktiviteti i Qeverisë së Kosovës në veri përfshin disa ministri të cilat madje, pse jo, ky është objektiv primar imediat i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Më pastaj, po theksohet se përpjekjet e Qeverisë duhet, duhet, dëshirohen apo jo, të mbështeten në Zyrën, në ZCN, së andejmi rezulton si formulim dubioz, aq më parë kur në fillim të këtij dokumenti apostrofohet se kjo strategji është e përbashkët, e po atyre institucioneve, e rrjedhimisht thuhet se ZCN-ja, duhet, që është premisë dëshirore, me asnjë postulat obligativ dhe për aq problemor.

Ani pse në këtë dokument nuk është theksuar se koordinator do të jetë Y.H. po e zëmë, me respekt për gatishmërinë e tij, gjykoj se koordinator për realizimin e këtij dokumenti e të këtij misioni do të duhej të ishte personalisht kryeministri, zotëri Thaçi vetë, përkatësisht së paku njëri nga zëvendëskryeministrat. Kjo është një punë serioze, një dokument serioz që unë nuk besoj që do të mund të bënte koordinimin një përfaqësues i cili nuk ka premisa, as funksionale, as instrumentale, as mekanizma, as legjitimitet.

Dhe, përfundimisht, me disa dilema, në përgjithësi gjykoj se Qeveria e Republikës së Kosovës, referuar Kosovës Veriore, e bën kryesisht atë që mund ta bëjë dhe së pakut, dukshëm më tepër dyshoj se do të mund të bënte cilado strukturë qeveritare me proveniencë nga koalicioni, eventualisht, edhe me nga, respektivisht nga subjekte politike tjera.

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka Synavere Rysha, le të përgatitet deputetja Myrvete Pantina.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Do të përshëndetësja këtë fillim të debatit parlamentarë, ndoshta nga diskutuesit e fundit, nga fakti se po thyhet ajo tabuja e krijuar në Kuvendin e Kosovës, po lejohet një debat për të cilin kaherë ka pasur kërkesë dhe nevojë ky Kuvend të debatojë, por në një farë mënyre apo në një farë forme është penguar apo nuk është lejuar. Por, si duket, ballafaqimi me të vërtetën dhe pranimi real i së vërtetës, më në fund është kuptuar se është qasja më e mirë për Qeverinë dhe është më produktive.

Çështja, të cilën po e trajtojmë sot, moszbatimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe prania e strukturave paralele serbe në territorin e Republikës së Kosovës, jo se duhet debatuar, por nga një gjendje e krijuar e tillë, kërkon marrjen e hapave konkretë për ndryshimin e situatës në mënyrë emergjente, në të kundërtën, rreziku nga situatat e padëshirueshme është i pashmangshëm për Kosovën.

Kosova ka më tepër se një vit që ka miratuar Kushtetutën e saj, por sa në fakt po gjen zbatim kjo në praktikë, apo sa po respektohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nga vetë institucionet e shtetit të Kosovës, duke i filluar nga i pari?

Integriteti territorial i Kosovës është i panegociushëm kjo tashmë është qartë e ditur dhe duhet të respektohet në mënyrë absolute. Kjo është e lidhur ngushtë me stabilitetin e

rajonit. Kjo mbase duhet të jetë prioriteti i parë i shtetit të Kosovës, mbrojtja e integritetit territorial.

Mungesa e pikave doganore 1 dhe 31, po e dëmton interesin ekonomik të Kosovës, i kontribuon zhvillimit të kontrabandës, po mundëson krimin e organizuar dhe po favorizon grupet terroriste.

Vizioni ynë për Kosovën është shumë i qartë, Kosova shtet demokratik, shumë etnik, e integruar në rajon me marrëdhënie të mira fqinjësore, por a po na trajtojnë fqinjët tanë njësoj sikurse ne po i trajtojmë ata? Po vazhdojnë me bllokada, bllokada dhe vetëm bllokada.

Popullsia më e re në Evropë, 52% nën moshën 27 vjeçare, kjo na detyron edhe më shumë të punojmë për të ardhmen e tyre, për më shumë zhvillim ekonomik, hapje të vendeve të reja të punës. Por çka në fakt po ndodh, zbrazje, ikje, largim dhe atë duke e rrezikuar edhe jetën e tyre madje po përfundojnë në fatalitet?

Së fundi ideja e ndërkombëtarëve për bisedime shtesë Prishtinë – Beograd këtyre ditëve, e lansuar në media sikur ka hapur dilema të ndryshme se çka do të bisedohet dhe mos vallë do të krijohet një Dejton i ri, do të na përsëritet edhe një Dejton. Kjo mbase duhet të jetë ajo që Qeveria është dashur gjatë gjithë kësaj dite të na përgjigjet dhe të japë kontributin maksimal në këtë drejtim, po si duket kjo nuk ndodhi.

Përfundimisht e mbështesim fuqishëm miratimin e rezolutës nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, të propozuar nga Lidhja Demokratike e Dardanisë, sepse është më se e domosdoshme, karshi situatës së krijuar në vend, në të kundërtën përgjegjësia është e domosdoshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Sigurisht Dejton nuk do të ketë. Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina, le të përgatitet deputeti Hajdin Abazi.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zbatimi i Kushtetutës në tërë territorin e Kosovës është më se i domosdoshëm, për arsye se moszbatimi i tij po na sjell probleme edhe dëme të mëdha, jo vetëm Mitrovicës Veriore, por tërë ekonomisë së vendit.

Pikat kufitare në veriun e Kosovës, të njohura si pika 1 dhe 31, mbi të cilat nuk ekziston kontrolli i institucioneve kosovare, por që nga shkurti i vitit 2009 kontrollohen nga doganierët e EULEK-sit, kanë ndikuar që pjesa veriore e Kosovës të vazhdojë të mbetet vendi më kritik sa i përket kontrabandës. Edhe pse sipas të dhënave të Doganave të Kosovës, ka pasur përmirësim të grumbullimit të të hyrave në këto pika kufitare dhe atë nga 38 milionë euro, sa kanë qenë në vitin 2008, në 54 milionë euro në vitin 2009, por sipas disa të dhënave, si pasojë e kontrabandës, buxheti i Kosovës dëmtohet çdo ditë dhe atë për rreth një milion euro.

Përveç kësaj mallrat e kontrabanduara për shkak se nuk i nënshtrohen ndonjë kontrolli të cilësisë, ato mallra mund të rrezikojnë edhe shëndetin e tërë qytetarëve të Kosovës, sepse ato shiten në tërë territorin e Kosovës.

Përmbledhjen e strategjisë për veriun e Kosovës, që na është ofruar, mendoj se duhet ta mbështesim, por Qeveria duhet që këtë strategji ta konkretizojë përmes një plani të veprimit me aktivitete, instrumente dhe afate kohore konkrete për të ndryshuar gjendjen pozitivisht në këtë pjesë të Kosovës, dhe besoj se ky plan i veprimit do të silltet edhe në Kuvend për diskutim.

Për të ndryshuar gjendjen në Mitrovicën Veriore, mendoj se mbi të gjitha duhet të ketë angazhim më të madh për sundimin e ligjit në këtë pjesë të Kosovës, por edhe për përmirësimin e situatës sociale dhe ekonomike të popullatës që jeton në veriun e Mitrovicës, përmes investimeve më të mëdha, si nga institucionet vendore, ashtu edhe ndërkombëtare, në mënyrë që të krijohen kushte më të mira të jetës për të gjithë qytetarët e Mitrovicës Veriore, por edhe të tërë Mitrovicës, pa asnjë dallim.

Dhe, në fund mendoj se kontributi i debatit të sotëm për këtë çështje do të ishte dhënia e ideve se si të dilet nga situata në të cilën gjendet veriu i Mitrovicës, sepse me gjendjen jemi të njoftuar pothuajse të gjithë, dikush më shumë e dikush më pak dhe nuk mjafton që të merremi vetëm me përshkrimin e gjendjes. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Deputeti i fundit i lajmëruar për debat është Hajdin Abazi.

HAJDIN ABAZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar prezentë,

Me të vërtetë nuk e kisha ndërmend të inkuadrohem në debat duke qenë i bindur se kërkesa për këtë debat është me strategji jetike për vendin dhe kam pritur që kolegët deputetë këtu do të jemi në nivel të përgjegjësisë dhe nuk kam se si të mos dëshpërohem kur herë, herë vërehet një degradim i debatit, vërehen edhe shenja të destruktivitetit të diskursit edhe pse flasim për një çështje që më së paku ka të bëjë me aspekte partiake, madje, madje kishte momente edhe kur shprehej edhe një lloj devalvimi edhe minimal i moralit të përgjegjësisë së deputetit.

Sidoqoftë, unë nuk do ta ndjek shembullin e kolegut Luzha, që të heqë dorë nga debati, por do të vazhdoj duke shpresuar që do të jap një kontribut në diskutimin tim.

Ne të gjithë e dimë besoj, jemi të vetëdijsëm për rëndësinë dhe sidomos për kompleksivitetin e gjendjes në veri të Kosovës. Ne, thjesht vetëm si Kosovë nuk mundem të japim zgjidhje pa pasur me vete edhe faktorin ndërkombëtar. Dhe, strategjia që ka filluar, që na ka afruar, që e ka hartuar Qeveria, bashkë me ICO, është një strategji e përbashkët e ndërkombëtarëve dhe e neve. Ne gjithë po thirrmi këtu në sundimin e ligjit dhe parimisht kemi të drejtë, mirëpo nga përvoja jonë të gjithë ne e dimë se sundimi i ligjit rrallëherë, vetëm në situata ekstreme mund të imponohet, duhet të krijohet predispozita kur ligji të bëhet i zbatueshëm. Dhe, ne si Kuvend, si Qeveri sidomos si shqiptarë, që jemi shumicë në Kosovë, duhet të bëjmë çmos nga vetja jonë që ne ta integrojmë edhe këtë pjesë të vendit. Po, si do ta integrojmë kur ne e dimë se ata qytetarë serbë të cilët vërtet janë paqedashës dhe liridashës dhe janë të gatshëm të jetojnë këtu qysh kanë jetuar edhe me shekuj, janë në presionin e vazhdueshëm të regjimit të Beogradit në shantazhe, destruktivitet edhe kërcënime të hapura, pa folur për investime financiare dhe të tjera.

Unë me përkatësi jam shqiptar dhe si i tillë unë nuk mund të ndihem më i lirë në Kosovë se sa çdo qytetar tjetër e në këtë rast edhe se çdo qytetar serb, i cili nuk është i involvuar në krim dhe në kontrabandë që vërtet e kanë vendin në burg. Po flas për qytetarët të cilët i konsideroj të ndershëm, jo në kuptimin negativ, por qysh e konsideroj çdo qytetar të Kosovës, pavarësisht përkatësisë etnike ose kombëtare.

Strategjia e afruar shpreh një maturi dhe shpreh krijimin e parakushteve që të ketë mundësi që të bëhet, jo vetëm zbatimi i ligjit, por njëherit qytetarëve serbë t'u sigurohet një gjendje e tillë ku ata shpirtërisht do të ndihen të sigurt dhe do të krijohen për një liri të mirëfilltë që ata ta ndjejnë veten tamam të lirë. Dhe, ne nuk duhet të kemi iluzione, derisa të mos i krijojmë këto kushte që çdo qytetar i cili është i gatshëm dhe dëshiron të jetojë me të vërtetë i lirë dhe të ketë siguri shpirtërore, ne nuk mund ta imponojmë integrimin. Për integrimin duhet të krijojmë kushte natyrale që ai të vijë me masa tona duke krijuar kushte, qoftë ekonomike, qoftë sociale, qoftë përmes mekanizmave funksional. Dhuna në këtë moment duhet të përjashtohet me çdo kusht. Ne për fat e kemi mbështetjen edhe të ndërkombëtarëve, sepse me Kushtetutë dhe me gjithë veprimtarinë tonë të deritashme kemi shprehur gatishmërinë dhe kemi zgjatur dorën që një herë e përgjithmonë të pajtohemi, të jetojmë, të krijojmë kushte të mirëfillta për jetesë, për mirëqenie dhe të shohim drejt së ardhmes, drejt asaj që është njerëzore, humane dhe vërtet paqësore.

Prandaj, shpresoj se ne, me këtë qëllim të mirë, do t'ia dalim dhe do të kemi sukses me ritmin që kërkohet, me ritmin që e kërkon gjendja jonë reale. Faleminderit!

Diskutim i bashkangjitur

MIMOZA AHMETAJ: I nderuar zoti kryetar,
Përfaqësues të Qeverisë,
Të nderuar deputetë,
E përshëndes iniciativën e tillë që të debatohet për çështjen e kushtetutshmërisë në vendin tonë.

Që pas viteve 1999, disa herë është tentuar të krijohet një program – strategji e cila do të merrej seriozisht me zgjidhjen e problemit në veri të Kosovës, por asnjëherë ajo nuk ka hasur në involvim serioz të të gjithë mekanizmave vendorë dhe ndërkombëtarë.

Me këtë strategji, Qeveria e Kosovës e trajton çështjen nga aspekti politik, një trajtim më serioz se deri tani. Me këtë dokument adresohen problemet kryesore, si dhe do të bëhet artikulimi i qëllimeve dhe qëndrimeve tona karshi kësaj çështjeje.

Ajo që mendoj se është sfidë deri tani është përfshirja ose jo e Beogradit në këtë strategji, mos ekzistenca e konsensusit në mesin e shteteve të BE, si dhe mungesa e planit shtesë për siguri.

Ngjarjet e fundit në Kosovë, zgjedhjet e fundit lokale janë treguesi më i mirë se Kosova është duke lëvizur drejt integritetit të tërësishëm të territorit në një tërësi. Sigurisht, që neve na ngutet, sepse një situatë e tillë nuk është krijuar brenda natës e as për dy vjet, por për vitet të tëra, prandaj, mendoj se zgjidhja e një situatë të krijuar kërkon maturi dhe kohë për t'u zgjidhur.

Konsideroj që ndihma kryesore në vënien në jetë të kësaj strategjie do të jetë puna dhe vendosmëria e Qeverisë dhe mekanizmave tanë institucional e po ashtu edhe ndihma e madhe nga BE dhe institucionet ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Debat i ka përfunduar. Është e drejta e propozuesit 45 minuta.

Kush po e merr fjalën prej juve?

Fjalën e ka deputeti Lulzim Zeneli, kryetari i Grupit të LDD-së.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Duke vlerësuar përmbajtjen e debatit në funksion të temës dhe në funksion të implementimit të Kushtetutës dhe zbatimit të ligjshmërisë në territorin e Republikës së Kosovës, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, në pajtim me procedurat që obligon Rregullorja e Punës së Kuvendit, ka adresuar me kohë mocionin, i cili është në funksion të çështjes të cilën sot e debatuar.

Prandaj, Kuvendi i Republikës së Kosovës duke theksuar rolin e vet në zbatimin e plotë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sundimin e shtetit ligjor, luftimin e kriminalitetit dhe kontrabandës, garantimin e pronës, lirisë së lëvizjes, paqes, demokracisë dhe perspektivës të zhvillimit ekonomik, pas debatit parlamentar sot më datën 4 mars, miraton këtë:

REZOLUTË

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, rikonfirmon domosdoshmërinë e respektimit dhe të zbatimit të plotë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në tërë territorin e Kosovës, duke garantuar ruajtjen e tërësisë territoriale dhe pacenueshmërinë e kufijve të pranuar ndërkombëtarisht në Republikën e Kosovës.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që në tërë territorin e vendit të vendoset rendi dhe ligji, duke garantuar kështu funksionimin e sistemit juridik dhe politik të Republikës së Kosovës.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës obligohet t'i rihapë pikat doganore 1 dhe 31 në përputhje me legjislacionin dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
4. Qeveria e Republikës së Kosovës obligohet të ndalojë dhe të pamundësojë çdo aktivitet i cili zhvillohet në territorin e Republikës së Kosovës jashtë sistemit juridik dhe kushtetues të Republikës së Kosovës, duke përfshirë:
 - a) Marrjen e të gjitha masave për parandalimin e ushtrimit të veprimtarive rrënuese të Republikës së Serbisë, të cilat bien në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe përfundimin e suksesshëm të mandatit të bashkësisë ndërkombëtare civile në Kosovë, dhe
 - b) Hartimin e planit aksionar në koordinim me faktorët tjerë relevantë për zhbërjen e strukturave paralele të sigurisë në veri të Republikës së Kosovës.

5. Qeveria e Republikës së Kosovës, obligohet, pas periudhës gjashtëmujore t'i raportojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për implementimin e Kushtetutës dhe zbatimin e ligjshmërisë në territorin e Republikës së Kosovës.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Kërkoj nga shefat e grupeve parlamentare që ta prezantojnë dokumentin që e kanë përgatitur. Ramë Buja, në emër të kryetarëve të grupeve parlamentare.

RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në takimin e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, që patëm pak më parë, sipas porosisë tuaj, ne u dakorduar që të hartojmë një deklaratë dhe hartuam atë. Mendimin e ndau vetëm Lulzim Zeneli, që është propozues i rezolutës, ndërsa tjerët u pajtuam që të hartojmë një deklaratë dhe deklarata është kjo:

Kuvendi i Republikës së Kosovës, duke theksuar rolin e vet në zbatimin e plotë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sundimin e shtetit ligjor, luftimin e kriminalitetit dhe të kontrabandës, garantimin e pronës, lirisë së lëvizjes dhe paqes, demokracisë dhe perspektivës së zhvillimit ekonomik për gjithë popullin e Republikës së Kosovës, në seancën e mbajtur më 4 mars 2010, pas debatit parlamentar, miratoi këtë

DEKLARATË

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës rikonfirmon domosdoshmërinë e respektimit dhe të zbatimit të plotë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në tërë territorin e Kosovës, duke garantuar ruajtjen e tërësisë territoriale dhe pacenueshmërinë e kufijve të pranuar ndërkombëtarisht të Republikës së Kosovës.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës mirëpret Deklaratën e Grupit Ndërkombëtar Drejtues për Kosovën, të datës 8 shkurt 2010, në të cilën shprehet mbështetja e plotë për domosdoshmërinë e forcimit të përpjekjeve të institucioneve të Republikës së Kosovës për veriun e Kosovës.
3. Kuvendi i Republikës së shpreh përkushtimin e tij për të siguruar që të gjithë shtetasit e Kosovës të gëzojnë mbrojtjen e shtetit ligjor. Kuvendi mirëpret përkrahjen e Bashkimit Evropian e të bashkësisë ndërkombëtare për të bërë të mundur që të gjithë qytetarët të kenë përfaqësim demokratik në pushtetin qendror dhe lokal, të përfitojnë nga shërbimet e investimet dhe të kenë qasje në drejtësi.
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës rithekson përkushtimin e tij ndaj vetëqeverisjes lokale dhe decentralizimit sipas Propozimit gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës, Kushtetutës dhe legjislacionit të miratuar prej tij.

Prishtinë, më 4 mars 2010.

KRYETARI: Faleminderit! Tani është radha e votimit të Deklaratës së lexuar nga deputeti Ramë Buja. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatoj se me 52 vota “për”, 2 “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi Deklaratën e përgatitur nga kryetarët e grupeve parlamentare për zbatimin e Kushtetutës në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë, me kaq konstatoj përfundimin e punimeve të kësaj seance plenare.

Përgatiti: Njësia e Transkripteve